



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Trajtimit të Pronave” Tiranë.**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR**  
**MBI**

**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE TË**  
**VEPRIMTARISË SË AGJENCISË E TRAJTIMIT TË**  
**PRONAVE”**

**Tiranë, Maj 2023**

	Përmbajtja	2
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3
	1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3
	2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-7
	3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-10
<b>II</b>	<b>II. HYRJA</b>	10
	1. Objekti i auditimit	10
	2. Qëllimi i auditimit	10
	3. Identifikimi i çështje	10-11
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
	5. Përgjegjësitë e audituesve	11
	6. Kriteret e vlerësimit	11-12
	7. Standardet e auditimit	12-13
	8. Metodot e auditimit	13
	9. Dokumentimi i auditimit	13-14
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	14-15
	1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15
	2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	15
<b>A.</b>	<b>1. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.</b>	15
	<b>2. Auditim mbi Zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës me pagat.</b>	15-17
	<b>3. Auditim mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.</b>	17-54
	<b>4. Auditim mbi përcaktimin e procedurave për trajtimin e pronës, numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara, numrin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim, numrin e kompensimeve të ekzekutuara për sipërfaqen e kompensuar dhe çështjet e ndjekura në gjykatë.</b>	54-61
	<b>5. Zbatimi i legjislacionit në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.</b>	61-63
	<b>6. Auditim mbi informacionin hartografik të dixhitalizuar, lidhur me vendimet përfundimtare për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe metodologjinë e vlerësimit për kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur, apo kompensimin nga fondi i tokës, kompensimin financiar të pasurisë nëpërmjet fondit të kompensimit dhe të drejtave të tjera reale, sipas afateve të përcaktuara.</b>	63-110
	<b>7. Auditim mbi vendimet e kompensimit të përcaktuara në vlerë, të ekzekutuara dhe të pa-ekzekutuara, nga periudha e njohjes së të drejtës për kompensim, deri në marrjen e shpërblimit, zbatimi i indeksimit për subjektet e shpronësuara që kanë përfituar shpërblim sipas radhës apo me marrëveshje, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesit bankar. Respektimi i afateve të kompensimit, planveprimet dhe strategjitë e hartuara e të zbatuara në këtë drejtim.</b>	
	<b>8. Auditim mbi procedurat për krijimin dhe administrimin e Fondit për Kompensim, në referencë të vendimeve të marra për kompensimin me pronë tjetër të paluajtshme, apo forma të tjera të njohura sipas ligjit.</b>	

	<p>9. Auditim mbi trajtimin e pronës së zënë me ndërtime informale dhe mbi të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, që transferohen në llogari të ATP-së, dhe mbi mënyrën e masën e shpërndarjes së tyre. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me institucione të tjera, lidhur me ndryshimet që pëson statusi i pasurive që janë objekt i fondit të kompensimit.</p> <p>10. Hartimi i regjistrit të aplikimeve dhe përgjigjeve nga sektori i Marrëdhënieve me Publikun. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indiciet nga ankesat e administruara në KLSH.</p>	
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	123-131

## I-PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin e përputhshmërisë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave ( në vijimësi ATP), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me kompensimin financiar dhe kompensimin fizik nga fondi i tokës, nga periudha e njohjes së të drejtës për kompensimit deri në marrjen e shpërblimit, zbatimi i indeksimit për subjektet e shpronësuara, si dhe bashkëpunimi institucional midis ATP-së dhe institucioneve përkatëse.

### 2. Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimi

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandi
1	Në 3 raste, nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me “Kërkesë të Veçantë” edhe pse kërkesi legjitimohet në kërkesën e tij për kompensimin financiar të pronës, por ka kaluar për trajtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit <i>një vleftë prej 60,388,502 lekë</i> , nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuara.	Faqet 93-115	I lartë	Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, duke i dhënë prioritet pranimit e kërkesave për trajtim në Sektorin e Kërkesave të Veçanta.
	Në 3 raste nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit			Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, duke

2	kërkues në cilësinë e blerësit të të drejtave që burojnë nga ish-vendimeve të KKKP, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar, pika 1.	Faqet 63-93	I mesëm	pranuar kërkesa për aplikim vetëm nga subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, depoziton në ATP, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm.
3	Në 7 vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015 deri në 31 dhjetor 2022, nga ATP janë ekzekutuar në total vetëm 794 vendime ekzekutimi për kompensim financiar, nga 18734 vendime përfundimtare të vlerësuara nga Sektori i Kompensimit i ATP-së, e përkthyer në përqindje vetëm 4,5 %, të vendime janë ekzekutuar, që do të thotë se me këto ritme Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtar për Kompensim që do të vlerësohen financiarisht sipas mënyrës dhe formave të përcaktuara në VKM-në 223/2016, të ndryshuar, është një proces pothuajse e pa realizueshëm, për zbatimin e nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015.	Faqet 57-61	I mesëm	Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa në të ardhmen ekzekutimin e aplikimeve të administruara si dhe aplikimet e reja që do të vijnë sipas akteve nënligjore për vitet në vijim.
	Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 13 raste, nuk ka bashkërenduar veprimtarinë me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për			ATP të marrë masa për të ardhmen, dhe të bashkërendojë veprimtarinë e saj me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për

4	<p>Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.</p> <p>Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 36.</p>	Faqet 93-115	I mesëm	<p>Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi në procesit e kompensimit të subjekteve të shpronësuar.</p>
5	<p>Fondi i tokës i miratuar me VKM për kompensimin fizik, nuk rezulton të jetë e regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme në emër të ATP, mos regjistrimi i këtyre pasurive të miratuar si fond për ATP-në ka bërë që në disa raste të krijohet mbivendosje me pasuri të regjistruar në të tretë, çfarë ka bërë që ATK-ja, është e detyruar që me një vendim tjetër të bej korrigjimin e vendimit në lidhje me pasuritë që kanë krijuar mbivendosje me pasuri të regjistruara në përsona të tretë.</p>	Faqet 63-94	I mesëm	<p>ATP-ja të marr masa në lidhje me regjistrimin në kartelen e pasurive të paluajtshme të gjithë pasuritë të miratuar si fond fizik i tokës, që do të shërbejë për kompensimin fizik të ish-pronarëve, që disponojnë një vendim përfundimtar për njohje, me të drejtë për kompensimin e pronës dhe për të cilin ka një vlerësim financiar pozitiv të kryer nga ATP.</p>
6	<p>Edhe pse janë miratuar ndryshimet e ligjit 133/2015 me ligjin nr.77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligji nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” nga ana ATK-ja nuk janë të publikuara në Buletinin Zyrtar të ATP-së, rivlerësimi financiar me 10% të zërit kadastral aktual ku rezulton që preken rreth 3843 vendime dhe që do të</p>	Faqet 57-61	I ulet	<p>ATP-ja të marr masa për të publikuar në Buletinin Zyrtar të ATP-së, rivlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual dhe ku rezultoi që preken rreth 3843 vendime ku do të përfitojnë një vlerë financiare rreth 17 Mld lekë.</p>

	përfitojnë një vlerë financiare afërsisht 17 Mld lekë.			
7	Në shqyrtimin e dosjeve për kompensim rezultojn vonesa në kompensimin deri në 3 vjet, në 6 raste rezulton se dosjet kanë filluar të shqyrtohen në vitin 2017 dhe janë kompensuar në vitin 2020 pra me vonësa të pa justifikuara dhe pa pasur dokument justifikues mbi shkaqet e vonesës si dhe selektimi dhe zgjedhja e subjektit për tu marrë në shqyrtim, dosja si psh:	Faqet 93-115	I lartë	Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në kohë sipas kërkesave të ligjit, duke nxjerrë përgjegjësinë për situatën e krijuar.
8	ATP (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) ka kryer kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogaritë e klasës 6, shpenzime të shfrytëzimit, në një kohë që duhej marrë në fund të vitit 2020 në llogarinë e provizioneve, meqenëse vendimet kanë marrë formë të prerë, bile është angazhuar edhe përmbaruesi., në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 34.	Faqet 15-23	I ulët	Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogarinë e provizioneve, në rastet kur vendimet kanë marrë formë të prerë edhe pse mund të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.
9	ATP, në 3 raste urdhërshpenzime, për shumën <b>1,495,663 lekë</b> , për të njëjtin specialist të larguar, si rezultat i dhënies së masës ekstreme disiplinore, zgjidhje e kundërligjshme e kontratave së punonjësit të pabazuar në ligj dhe në Kodin e Punës, ka sjellë kundërpërgjigje nga punonjësi i institucionit i cili ka bërë padi në gjykatë,	Faqet 8-17	I lartë	DV ASHK Tiranë Jug në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për dosjet e objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të

	<p>kundër masës të dhënë nga ish-AKKP, ku ka fituar të drejtën e tij në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë të gjyqimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar <b>1,495,663 lekë</b>, ku përfshihet edhe pagesa e përmbaruesit gjyqësor për kompensimin e punonjësit të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar një efekt ekonomik negativ në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune</p>			<p>objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës përkatëse të parcelave ndërtimore.</p>
--	---	--	--	---

### III. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### *Opinion i kualifikuar*

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve dhe rregulloret që lidhen me procedurat e vlerësimit financiar si dhe kompensimin financiar nga fondi i kompensimit për subjektet e shpronësuar.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Agjencia e Trajtimit të Pronave rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materialepor jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e njëopinioni të kualifikuar.*

#### **Baza për opinion të kualifikuar:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga ATP, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Nga auditimi i aktivitetit të institucionit, për periudhën 3 vjeçare, për vitet 2020-2022, deviacionet e evidentuara janë në nivelin e materialitetit llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, si më poshtë:

-Në 7 vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015 deri në 31 dhjetor 2022, nga ATP janë ekzekutuar në total vetem 794 vendime ekzekutimi për kompensim financiar, nga 18734 vendime përfundimtare të vlerësuara nga Sektori i Kompensimit i ATP-së, e përkthyer në përqindje vetëm

4,5 %, të vendime janë ekzekutuar, që do të thotë se me këto ritme Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtar për Kompensim që do të vlerësohen financiarisht sipas mënyrës dhe formave të përcaktuara në VKM-në 223/2016, të ndryshuar, është një proces pothuajse e pa realizueshmë, për zbatimin e nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015.

-Në 3 raste nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me “Kërkesë të Veçantë” edhe pse kërkuesi legjitimohet në kërkesën e tij për kompensimin financiar të pronës, por ka kaluar për shqyrtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit *një vleftë prej 60,388,502 lekë*, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuara.

-Në 3 raste nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit kërkuar në cilësinë e blerësit të të drejtave që burojnë nga ish-vendimeve të KKKP, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar, pika 1.

-Në 5 raste është marrë vendim nga ATP-ja për kompensimin fizik me fondin e tokës duke mos zbatuar kriterin e përzgjedhjes së pronës gjeografisht më pranë pronës të njohur për kompensim fizik, por është i kompensuar në një qarkë tjetër më largë se prona e njohur për kompensim, konkretisht në 4 pasuri të përzgjedhura zë rrugës nacionale Tiranë-Pogradec.

-Në 17 raste nga ana e ATP-së është punuar me dy standarte, ku për disa subjekte edhe pse kanë aplikuar ndër vite për kompensimin financiar të pronës, janë marrë vendime mbas 2-3 vitesh ndërsa për disa subjekte janë shqyrtuar dhe janë marrë vendime nga ATP brenda muajt nga momenti i aplikimit nga subjektit i shpronësuar.

-Në 3 raste kërkesa për aplikim është bërë nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, i paraqitur në cilësinë e blerësit të të drejtave reale që rojnë nga vendimi ish-ZRKKP.

-Në 4 raste mungon e administruar në dosje, deklarata e subjektit kërkuar për vazhdimin e procedurave për kompensim financiar nga fondi i kompensimit deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës.

-Në 3 raste mungon njoftimi nga ATP drejtuar subjektit kërkuar, për fillimin e procedurave për kompensim financiar dhe fizik me fondin e tokës, në kushtet kur VKM 223 datë 23.03.2016, ka ndryshuar mënyren dhe formën e kompensimit, ku subjekti kërkuar duhet të deklaroj se është dakort për vazhdimin e procedurave sipas kushteve të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.

-Në 2 raste nga ATP-ja është marrë vendim në kushtet kur relacioni drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm nuk është konfirmuar nga ish-Përgjegjësi i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta.

-Në 4 raste ATP, në dosjet e arkivuara nuk ndodhen praktikat për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit të publikuara në Buletinet sipas viteve.

-Fondi i tokës i miratuar me VKM për kompensimin fizik nuk rezulton të jetë e regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme në emer të ATP, mos regjistrimi i këtyre pasurive të miratuar si fond për ATP-në ka bërë që në disa raste të krijohet mbivendosje me pasuri të regjistruar në të tretë, çfarë ka bërë që ATK-ja, është e detyruar që me një vendim tjetër të bej korrigjimin e vendimit në lidhje me pasuritë që kanë krijuar mbivendosje me pasuri të regjistruara në persona të tretë.

-Në 3 raste përgjigjet e kërkesave dhe ankesat e bëra nga qytetarët janë kthyer me vonesë, në përgjigjet në shume raste janë të të njëjtit format dhe nuk janë të detajuara sipas specifikës së tyre dhe nuk kanë saktësuar dhe përfunduar vazhdimsinë e kërkesave por me frazën “do të merret në shqyrtim”.

-Në 3 raste Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), ka bërë vlerësimin financiar për vendimet e ish-KKKP-ve, ku në dosjet e arkivuara, rezultoi se nuk plotësonin kushtet për të



bërë vlerësimin financiar, sepse nuk kanë vulën e institucionit, si dhe planvendosjet ishin të pakonfirmuara nga ish-KKK Pronave.

-Nga Rivlerësimi financiar i zërit kadastral aktual me 10 %, preken rreth 3843 vendime që do të përfitojn një vlerë financiare rreth 17 mld lekë, në zbatim të ndryshimet që pësoj ligji dhe VKM-ja, këto vendime rezultojn të pa publikuara në faqen zyrtare të institucionit, në letinin e Njftimmeve Zyrtare, në zbatim të nenit 11, pika 2 të ligjit nr. 133/2015.

#### ***Baza për opinionin e përputhshmërisë.***

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*”, pjesë e Projekt Raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 66, datë 23.06.2020 edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

#### ***Përgjegjësitë e Drejtuesve të ATP-së:***

Strukturat drejtuese të ATP-së, janë përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës, mbështetur në parimet e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### ***Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë:***

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **I - HYRJE**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1172/1, datë 09.01.2023, nga data 09.01.2023 deri në datën 17.03.2023, në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë “Mbi procedurën e pranimit, administrimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të praktikave për shpërblimin e çështjeve të pronësisë, nëpërmjet vendimmarrjes për krijimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit, si dhe aktiviteti ekonomik e financiar i njësisë, evidentimin dhe trajtimin ligjor të ankesave dhe praktikave të adresuara nga qytetarë dhe institucione të ndryshme”.

Auditimi tematik u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. S., Përgjegjës grupi
2. H.M, Auditues
3. R.F, Auditues
4. A.P, Auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet ATK-së dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

### **1. Objekti:**

Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pranimin dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe shqyrtimi i procedurave të legalizimit.

### **2. Qëllimi:**

Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e auditimit.

### **3. Identifikimi i çështjes:**

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ushtron aktivitetin e saj dhe ka për objekt të veprimtarisë përfundimin brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës, për të cilat nuk është marrë vendim, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar, tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në ligj, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me ligjin, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti. Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së shprehet me vendim brenda afatit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, për rrëzimin e kërkesës, njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimin nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar,**

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit ATP për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, mbajnë përgjegjësi në lidhje me përfundimin brenda afatit ligjor të shqyrtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës si dhe vlerësimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kompensimin financiar të pronës.

## 5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

## 6. Kriteret e vlerësimit.

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar; Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksonimit Administrativ të KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr.85, datë 30.06.2015, e ndryshuar; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; -ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, ligji nr. 10099, datë 19.03.2009, ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009 ligjin nr. 10219, datë 04.02.2010, ligjin nr. 141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjin nr. 50/2014, datë. 15.05.2014, ligjin 133/2015, datë 05.12.2015 “Për Agjensinë e Trajtimit të Pronave”, i ndryshuar; VKM nr. 222 dt. 23.03.2016, ndryshuar me VKM 765, datë 20.12.2017, Vendimi nr. 223, dt. 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar me VKM nr. 766, datë 20.12.2017 dhe VKM nr. 1114, datë 24.12.2020, Vendimi nr. 221, dt. 23.03.2016, VKM nr. 770, datë 12.11.2014, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre, si dhe ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin standardeve dhe rregullave kontabël”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” etj.

## 7. Standardet e auditimit.

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

## 8. Metodat e auditimit

Përraritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

**a. Metoda "Testim hap pas hapi":** Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

**b. Metoda e ekzaminimit:** Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

**c. Metoda e ekzaminimit kryq:** Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

**d. Metoda e inspektimit fizik:** Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

e. *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshmetë përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi itakimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë afruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

f. *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMI**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit Nr. 133/2015 “Për Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të Kompensimit të pronave” si dhe akteve nënligjore VKM nr. 221/2016; VKM nr. 222/2016 e ndryshuar me VKM nr. 765/2017; VKM nr. 223/2016 të ndryshuar me VKM nr. 766/2017 me VKM nr. 1114/2020 dhe ka për objekt të veprimtarisë përfundimin brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës, për të cilat nuk është marrë vendim, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar, tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në këtë ligj, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2, të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së shprehet me vendim brenda afatit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, për rrëzimin e kërkesës, njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimin nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi, verifikon dhe llogarit detyrimet financiare, që i lindin shtetit për subjektet e shpronësuara ose për të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, depoziton për regjistrim në regjistrat e pasurisë së paluajtshme të gjitha vendimet që trajtojnë pronën.

Agjencia e Trajtimit të Pronave drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, që emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë dhe nga dy Zëvendës Drejtor të Përgjithshëm. Veprimtaria e ATP-së në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës, mbështetet në parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike, ekskluzivitetit dhe transparencës.

Niveli i menaxhimit të veprimtarisë së subjektit nga strukturat drejtuese konstatohet në nivele mesatare, që ka ardhur si rezultat i moszbatimit të plotë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe që ka vend për përmirësim.

Projektraporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të ATP-së dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi.

## **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit**

1. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

2. Auditim mbi Zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës me pagat.

3. Auditim mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

4. Auditim mbi përcaktimin e procedurave për trajtimin e pronës, numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara, numrin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim, numrin e kompensimeve të ekzekutuara për sipërfaqen e kompensuar dhe çështjet e ndjekura në gjykatë.

5. Zbatimi i legjislacionit në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

6. Auditim mbi informacionin hartografik të dixhitalizuar, lidhur me vendimet përfundimtare për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe metodologjinë e vlerësimit për kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur, apo kompensimin nga fondi i tokës, kompensimin financiar të pasurisë nëpërmjet fondit të kompensimit dhe të drejtave të tjera reale, sipas afateve të përcaktuara.

7. Auditim mbi vendimet e kompensimit të përcaktuara në vlerë, të ekzekutuara dhe të pa-ekzekutuara, nga periudha e njohjes së të drejtës për kompensim, deri në marrjen e shpërblimit, zbatimi i indeksimit për subjektet e shpronësuara që kanë përfituar shpërblim sipas radhës apo me marrëveshje, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesit bankar. Respektimi i afateve të kompensimit, planveprimet dhe strategjitë e hartuara e të zbatuara në këtë drejtim.

8. Auditim mbi procedurat për krijimin dhe administrimin e Fondit për Kompensim, në referencë të vendimeve të marra për kompensimin me pronë tjetër të paluajtshme, apo forma të tjera të njohura sipas ligjit.

9. Auditim mbi trajtimin e pronës së zënë me ndërtime informale dhe mbi të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, që transferohen në llogari të ATP-së, dhe mbi mënyrën e masën e shpërndarjes së tyre. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me institucione të tjera, lidhur me ndryshimet që pëson statusi i pasurive që janë objekt i fondit të kompensimit.

10. Hartimi i regjistrit të aplikimeve dhe përgjigjeve nga sektori i Marrëdhënieve me Publikun. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indiciet nga ankesat e administruara në KLSH.

### **Pika 1: Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.**

***Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), në bazë të Programit të Auditimit nr. 1172/1, datë 09/01/2023, mbajtur në datë 17/03/2023.***

Auditimi i programimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;

-Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;

-Ligji nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”

-Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”

Ligji Nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar;

- Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”;

- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”

- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”

### **VITI 2020**

Referuar Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit. Gjatë perjudhës deri në fund të vitit 2020, për ATP ka pasur transferime (shtesa/pakësime) të fondeve buxhetore të akorduara.

### **PLANI FILLESTAR**

## **TABELA E BUXHETIT - FONDET E MIRATUARA PËR VITIN 2020**

<b>Pro g.</b>	<b>Llo g  Ek.</b>	<b>Emërtimi i Projekteve</b>	<b>Plani Ne fillim 2020</b>	<b>Plani, Aktit Normativ Nr.06, dt.21.03.20 20</b>	<b>Plani, Aktit Normativ Nr.15 dt.15.04.2 020</b>	<b>Plani, Aktit Normativ Nr.28, dt.01.07.2 020</b>	<b>Plani, Aktit Normativ Nr.34, dt.16.12.20 20</b>
011 80	600	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	166,000,000	156,000,000	156,000,000	146,000,000	132,000,000
011 80	601	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	29,000,000	25,800,000	25,800,000	25,800,000	22,000,000
011 80	602	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	44,400,000	40,880,400	40,880,400	45,980,400	41,580,400
011 80	602	Vendime të ankimuara në gjykatë	15,200,000	7,000,000	7,000,000	7,000,000	3,000,000
011 80	602	Vendime nga Oborret në përdorim	7,400,000	6,615,600	6,615,600	6,615,600	6,615,600
011 80	604	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	3,500,000,000	3,500,000,000	3,500,000,000	3,000,000,000	1,900,000,000
011 80	606	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000
011 80	231	Blerje pajisje elektronike	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000

		<b>Totali</b>	<b>3,763,000,000</b>	<b>3,737,496,000</b>	<b>3,737,496,000</b>	<b>3,232,596,000</b>	<b>2,106,396,000</b>

### **VITI 2021**

Referuar Ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, janë akorduar fondet për shpenzime korrente për vitin 2021, sipas tabelës së mëposhtme:

### **PLANI FILLESTAR**

### **TABELA E BUXHETIT - FONDET E MIRATUARA PËR VITIN 2021**

<b>P r o g .</b>	<b>L l o g . E k .</b>	<b>Emërtimi i Projekteve</b>	<b>Plani Ne fillim 2021</b>	<b>Plani Akti Normat iv nr.26, dt.22.06 .2021</b>	<b>Plani Akti Norm ativ nr.34, dt.03. 12.20 21</b>
01180	600	Përfitues I fondit fizik dhe financiar të kompensuar	161,000,000	156,000,000	156,000,000
01180	601	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	29,000,000	28,000,000	25,800,000
01180	602	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	43,200,000	43,200,000	31,500,000
01180	602	Vendime të ankimuara në gjykatë	10,800,000	10,756,000	8,956,000

0 1 1 8 0	6 0 4	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	2,000,000,000	2,000,000,000	1,000,000,000
0 1 1 8 0	6 0 6	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	200,000	200,000	200,000
0 1 1 8 0	6 0 6	Vendime të ankimuar në gjykatë		44,000	44,000
0 1 1 8 0	2 3 1	Blerje pajisje elektronike	6,000,000	6,000,000	6,000,000
		<b>Totali</b>	<b>2,250,200,000</b>	<b>2,244,200,000</b>	<b>1,230,700,000</b>

### **VITI 2022**

Referuar Ligjit nr. **115/2021**, “Për buxhetin e vitit 2022”, të Udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhezimi plotësues i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, janë akorduar fondet për shpenzime korrente për vitin 2022, sipas tabelës së mëposhtme:

### **PLANI FILLESTAR**

#### **TABELA E BUXHETIT - FONDET E MIRATUARA PËR VITIN 2022**

Program i	Llog Ek.	Emertimi i Projekteve	Plani Fillim 2022	Plani Akti Normativ nr.3, dt.12.03.2022	Plani Akti Normativ nr.12,dt.29.07.2022	Plani Akti Normativ nr.19, dt. 29.12.2022
01180	600	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të	165,900,000	161,752,000	143,752,000	123,752,000



		kompensuar				
01180	601	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	27,700,000	27,008,000	25,008,000	21.,008,000
01180	602	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	30,320,000	27,320,000	19,362,923	18,451,206
01180	602	Vendime të ankimuara në gjykatë	25,028,000	22,488,000	13,445,077	8,986,794
01180	604	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	3,500,000,000	3,500,000,000	3,500,000,000	1,000,129,184
01180	606	Përfitues i fondit fizik dhe financiar të kompensuar	200,000	200,000	200,000	1,570,000
01180	606	Vendime të ankimuara në gjykatë	52,000	52,000	52,000	52,000
01180	232	Blerje pajisje elektronike	6,000,000	6,000,000	6,000,000	5,600,000
		<b>TOTALI</b>	<b>3,755,200,000</b>	<b>3,744,820,000</b>	<b>3,707,820,000</b>	<b>1,179,549.184</b>

b. Realizimi i planit të buxhetit për vitet 2020-2022

**VITI 2020**

Plani i buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, për vitin 2020, rezulton në vlerën total **2,106,396,000**  
Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave, për vitin 2020, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë, deri më datë 31.12.2020, si më poshtë:

C		PROJ	ART	PLAN VIETO	PL THESAR	SHPEN Z	Ranka Shqiperis	Xhi Bre	SIG + TATI	RANK	DIF SHPEN	NR PLA	FAK
14	01180	91405A	600	132,000,		127,526,4			26,629,	102,896,	24,629,7	167	132
14	01180	91405A	601			21,162,85			21,162,	0	21,162,8		
			<b>6009</b>	<b>154,000,000</b>	<b>154,000,000</b>	<b>148,689,321</b>			<b>45,792,505</b>	<b>102,896,726</b>	<b>45,792,505</b>	<b>167</b>	<b>132</b>
14	01180		602	41,580,4		30,957,99		7,20	0	30,950,7	7.200		
14	01180		602						0		0		
14	01180	91405	602					1,60	9,916		11,516		
			<b>6029</b>	<b>51,196,0</b>	<b>51,196,00</b>	<b>35,028,74</b>		<b>8,80</b>	<b>9,916</b>	<b>35,040,0</b>	<b>18,716</b>		
14		91405A	604	1,900,00	1,900,000,	1,900,000	1,900,000,						
			<b>6049</b>	<b>1,900,00</b>	<b>1,900,000,</b>	<b>1,900,000</b>	<b>1,900,000,</b>						
14	01180	91405A	606	200,000	200,000	30,000				30,000	0		
			<b>6069</b>	<b>200,000</b>	<b>200,000</b>	<b>30,000</b>				<b>30,000</b>	<b>0</b>		
14	01180	18AR4	231	1,000,000	1,000,000	450,240				450,240	0		
			<b>2310</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,000,000</b>	<b>450,240</b>				<b>450,240</b>	<b>0</b>		
14	01180		604		16,096,29	16,096,29	16,096,29						
			<b>604</b>		<b>16,096,29</b>	<b>16,096,29</b>	<b>16,096,29</b>						
				<b>2,106,39</b>	<b>2,122,492,</b>	<b>2,100,294</b>	<b>1,916,096,</b>	<b>8,80</b>	<b>45,802,</b>	<b>138,386,</b>	<b>45,811,3</b>	<b>167</b>	<b>132</b>

Regjistri i Realizimit te Prokurimeve për vitin 2020

Nr	Kodi ekonomik	Kodi Projekti	Objekt Prokurimi	Investimet	Shpenzime (Art. 602)	Financimi
1	602.5400	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve hidraulike,		119,172	Buxhet Shtetit
2	602.3300	91405AD	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit		57,580	Buxhet Shtetit
3	602.0200	91405AB	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim		402,000	Buxhet Shtetit
4	602.1099	91405AB	Te tjera materiale dhe sherbime speciale		420,000	Buxhet Shtetit
5	602.0200	91405 AD	Materiale Perr Pastrimin dhe Dizefektimin (Maska Dhe Doreza Covid -19)		533,640	Buxhet Shtetit
6	602.5500	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve Fotokopjeve		780,000	Buxhet Shtetit
7	602.5600	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit		648,000	Buxhet Shtetit
8	602.5400	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e kondicionereve		334,800	Buxhet Shtetit
9	602.1099	91405AB	Sherbime Dizifektimi ambjenteve te ATP		235,200	Buxhet Shtetit
10	602.5400	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve elektrike		112,320	Buxhet Shtetit
11	2310000	18AR401	Pajisje elektronike (Blerje Printera)	42,480		
12	2310000	18AR401	Pajisje elektronike (Blerje Switch & Router)	402,000		
13	2310000	18AR401	Pajisje elektronike (Blerje UPS)	5,760		
14	602.0300	91405AB	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres Tonerat		4,499,699	Buxhet Shtetit
15	602.0100	91405AB	Kancelari me baze leter		945,336	Buxhet Shtetit
16	602.0100	91405AB	Kancelari te tjera		708,246	Buxhet Shtetit
17	602.0100	91405AB	Letër të dimensioneve të ndryshme		977,352	Buxhet Shtetit
18	602.0200	91405 AC	Materiale Perr Pastrimin dhe Dizefektimin (Maska Dhe Doreza Covid -19)		1,936,200	Buxhet Shtetit
19	602.2099	91405AB	Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e pajisjeve zjarrefikse		360,000	Buxhet Shtetit
20	602.5800	91405AB	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave		324,000	Buxhet Shtetit
			<b>TOTALI</b>	<b>450,240</b>	<b>13,393,545</b>	

VITI 2021

Plani i buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, për vitin 2021, rezulton në vlerën total **1,230,700,000** Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave, për vitin 2021, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë, deri më datë 31.12.2021, si më poshtë:

C	PROJ	ART	PLAN VIETO	PL THESA	SHPENZ THESAR	Ranka Shqiperi	Fat.Pa Pagua	Xhi Bre	SIG + TATI	RANK	DIF SHPEN	NR PLA	FAK	
14	01180	91405A	600	156,000,		125,826,1			24,354,	101,471,	24,354,8	167	133	
14	01180	91405A	601			20,973,43			20,973,	0	20,973,4			
			<b>6009</b>	<b>184,000,</b>	<b>184,000,0</b>	<b>146,799,6</b>			<b>45,328,</b>	<b>101,471,</b>	<b>45,328,2</b>	<b>167</b>	<b>133</b>	
14	01180		602	31,500,0		18,111,33		1,252,50	109;080	16,749,7	109,080			
14	01180		602	8,956,00		4,991,445		263,88	1,4 0		0			
			<b>6029</b>	<b>51,196,0</b>	<b>51,196,00</b>	<b>35,028,74</b>		<b>1,516,4</b>	<b>1,4</b>	<b>109,080</b>	<b>21,475,8</b>	<b>109,080</b>		
14		91405A	604	1,000,00	1,000,000	1,000,000,	1,000,000							
			<b>6049</b>	<b>1,000,00</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,000,000,</b>	<b>1,000,000</b>							
14	01180	91405A	606	200,000	200,000	137,000			13,050	12,950	13,050			
14	01180	91405A	606	44,000	44,000	40,000				40,000				
			<b>6069</b>	<b>244,000</b>	<b>244,000</b>	<b>177,000</b>			<b>13,050</b>	<b>163,000</b>	<b>13,050</b>			
14	01180	18AR4	231	6,000,000	6,000,000	4,335,804				4,335,80	0			
			<b>2310</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,000,000</b>	<b>4,335,804</b>				<b>4,335,80</b>	<b>0</b>			
14	01180		604		1,394,069	1,394,069	1,394,069							
			<b>604</b>		<b>1,394,069</b>	<b>1,394,069</b>	<b>1,394,069</b>							
				<b>1,230,70</b>	<b>1,232,094</b>	<b>1,175,809,</b>	<b>1,001,394</b>	<b>1,516,</b>	<b>1,4</b>	<b>45,450,</b>	<b>127,446,</b>	<b>45,450,3</b>	<b>167</b>	<b>133</b>

Regjistri i Realizimit te Prokurimeve për vitin 2021

Nr	Kodi ekonomik	Kodi Projekti	Objekt Prokurimi	Investimet	Shpenzime (Art. 602)	Financimi
1	602.1099	91405AB	Te tjera materiale dhe sherbime speciale Dizfektim		313,763	Buxhet Shtetit
2	602.5500	91405AC	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes Fotokopje		690,000	Buxhet Shtetit
3	602.3300	91405AB	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit		56,990	Buxhet Shtetit
4	602.5400	91405AC	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve elektrike		119,100	Buxhet Shtetit
5	602.5400	91405AC	Shpenzime per mirembajtjen e rrjeteve hidraulike,		119,460	Buxhet Shtetit
6	602.5400	91405AC	Shpenzime per mirembajtjen e kondicionereve		225,480	Buxhet Shtetit
7	602.2010	91405AB	Sherbime te printimit dhe publikimit		86,400	Buxhet Shtetit
**Situata:** -Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), për vitet 2020-2022, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare, nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, për Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre si dhe llogaria 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar).

-Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), lidhur me shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:

Rubrika 1: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të ATP Tiranë.

Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr, e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare.

-Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim), **në 3 raste urdhër-shpenzime**, për shumën **1,495,663 lekë**, për të njëjtin specialist të larguar, si rezultat i dhënies së masës ekstreme disiplinore, zgjidhje e kundërligjshme e kontratave së punonjësit të pabazuar në ligj dhe në Kodin e Punës, ka sjellë kundërpërgjigje nga punonjësi i institucionit i cili ka bërë padi në gjykatë, kundër masës të dhënë nga ish-AKKP, ku ka fituar të drejtën e tij në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë të gjykimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar **1,495,663 lekë**, ku përfshihet edhe pagesa e përmbaruesit gjyqësor për kompensimin e punonjësit të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar një efekt ekonomik negativ në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune.

-Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) ka kryer kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogaritë e klasës 6, shpenzime të shfrytëzimit, në një kohë që duhej marrë në fund të vitit 2020 në llogarinë e provizioneve, meqenëse vendimet kanë marrë formë të prerë, bile është angazhuar edhe përmbaruesi.

*Në këtë rast, në momentin e njohjes së provizionit duhej të kryheshin këto regjistrime:*

-Debitohet llogaria 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit”

-Kreditohet llogaria 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime”

-Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim), **në 7 raste**, për urdhër-Shpenzimet nr. 169, 165, datë 21.10.2020, Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave Mirëmbajtja e Ë.G., Periudha Korrik-Gusht-shtator 2020; nr. 165, datë 14.10.2020, Shpenzime për mirëmbajtjen e Mjeteve të Transportit TR 8016 U; nr. 170, datë 28.10.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e Mjeteve të Transportit TR 3225 L, 254,028 lekë; likuiduar A.M.S. shpk; nr. 186, datë 17.11.2020, Shpenzime –Sigurim Roje 2020, likuiduar Shoqëria “Il.G.” sha; nr. 187, datë 17.11.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e Kondicionerëve, likuiduar D.Xh.“P.K” shpk; nr. 212, datë 17.11.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës “Riparim fotokopje, likuiduar E. shpk, nuk ka bashkëlidhur kontratat (fotokopje ose pjesë të tyre) edhe në vazhdim në shpenzimet e kryera gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 (përveç shpenzimit të parë).

**Kriteri:** Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 3.7, 34, 31.

-Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenet 34,35,36.

**Efekti:** Efektiviteti i ulët i fondeve buxhetore, mosndjekje e informacionit dhe vështirësi në justifikimin e veprimeve të kryera.

**Shkaku:** Mosvlerësim dhe udhëzime të pasakta nga thesari.



**Rëndësia:** I Ulët

**Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria nr. 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), të marrë masa për të ardhmen lidhur me pasqyrat financiare (Pasqyra F5) duke plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat 1 dhe 2.

-Drejtori i Agjencisë së Trajtimit të Pronave, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa në të ardhmen për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për likuidimin e vendimeve gjyqësore, duke u udhëhequr nga qëllimi për krijimin e një marrëdhënie punëmarrës-punëdhënës të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

-Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogarinë e provizioneve, në rastet kur vendimet kanë marrë formë të prerë edhe pse mund të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

-Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim), për **7 rastet e konstatuara**, t`ju bashkëlidhë urdhër-shpenzimeve nr. 169, 165, datë 21.10.2020; nr. 165, datë 14.10.2020; nr. 170, datë 28.10.2020; nr. 186, datë 17.11.2020; nr. 187, datë 17.11.2020; nr. 212, datë 17.11.2020, dokumentet autorizuese dhe justifikuese, si kontratat (fotokopje ose pjesë të tyre), etj, si dhe në vazhdim në shpenzimet e kryera gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 (përveç shpenzimit të parë).

Në të ardhmen çdo urdhër shpenzimi të ketë të bashkëlidhur çdo dokument, fotokopje ose pjesë të kontratave, të cilat bëjnë të mundur justifikimin me lehtësi të veprimeve të kryera.

**Pika 4.** *Auditim mbi përcaktimin e procedurave për trajtimin e pronës, numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuar, numrin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim, numrin e kompensimeve të ekzekutuara për sipërfaqen e kompensuar dhe çështjet e ndjekura në gjykatë.*

Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015 deri në 31 dhjetor 2022, ATP ka vijuar me Kompensimin Financiar dhe Fizik të vendimeve përfundimtare, ku janë ekzekutuar në total 794 kërkesa nga subjektet e shpronësuar, me vlerë financiare rreth 7.842 mld lekë dhe është shpërndarë fond fizik nga fondi i tokës 713.2 ha. me një vlerë financiare prej 1,455 mld. Lekë.

Nga 794 vendime të ekzekutuara nga ATP-ja, 605 vendimi i përkasin kompensimin financiar dhe fizik, ndërsa 289 vendimeve i përkasin kompensimit financiar me kërkesë të veçantë.

Fondi i kursyer buxhetit të shtetit për vitin 2020-2021 nga kompensimi financiar me kërkesë të veçantë është 6,311,590,663 lekë.

Ndërsa për vitin 2022, kursimi për buxhetin e shtetit është zero për arsye se ATP ka shpërndarë vetëm fond për kështet e rradhës të Kompensimit me Kërkesë të Veçantë, pra nuk ka pasur vendimmarrje.

Nga auditimi i ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtar për kompensim deri në dhjetor të vitit 2022, nga ATP janë ekzekutuar vetëm 794 vendime ekzekutimi për kompensim financiar, nga 18734 vendime përfundimtare të vlerësuar nga Sektori i Kompensimit i ATP.

Ngelen për tu ekzekutuar 17940 vendime për 4 vite, për periudhën 2023-2026 në zbatim të nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

*Neni 16. Pika 6, të ligjit nr. 133/2015*

*Procesi i pagesës për të gjitha vendimet përfundimtare që kanë të njohur të drejtën e kompensimit do të përfundojë brenda një afati prej 10 vitesh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

**Konkluzion:**

*Në 7 vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015 deri në 31 dhjetor 2022, nga ATP janë ekzekutuar në total vetëm 794 vendime ekzekutimi për kompensim financiar, nga 18734 vendime përfundimtare të vlerësuara nga Sektori i Kompensimit i ATP-së, e përkthyer në përqindje vetëm 4,5 %, të vendime janë ekzekutuar, që do të thotë se me këto ritme Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtar për Kompensim që do të vlerësohen financiarisht sipas mënyrës dhe formave të përcaktuara në VKM-në 223/2016, të ndryshuar, është një proces pothuajse e pa realizueshmë, për zbatimin e nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015.*

Për periudhën 2021-2022 me ndryshimet që pësoj VKM nr. 223/2016, me VKM nr. 1114/2020, pika 16/4, nga ATP (Sektori i Kompensimit) është vijuar puna duke kryer ripërllogaritjen e vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit, bazuar me vlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual ku rezultojn që me rivlerësimin e bërë preken rreth 3843 vendime dhe që do të përfitojnë një vlerë financiare afërsisht 17 Mld lekë, deri në periudhën e auditimit lista e subjekteve që përfitojnë nga rivlerësimi i ndryshimit të zërit kadastral aktual nga ATP-ja nuk ishte bërë njoftimi publikisht në faqen zyrtare të institucionit. në kundërshtim me nenin 11, pika 2 të ligjit nr. 133/2015.

*Neni 11, Pika 2.*

*ATP-ja njofton publikisht, nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, Buletinit të Njoftimeve Zyrtare dhe/ose në media, listën e subjekteve që përfitojnë nga Fondi i Kompensimit të pronave për periudhën përkatëse, duke i orientuar subjektet që të hapin llogari pranë njëres prej bankave të nivelit të dytë.*

**Konkluzion:**

*Nga Rivlerësimi financiar i zërit kadastral aktual me 10 %, preken rreth 3843 vendime që do të përfitojn një vlerë financiare rreth 17 mld lekë, në zbatim të ndryshimet që pësoj ligji dhe VKM-ja, këto vendime rezultojn të pa publikuara në faqen zyrtare të institucionit, në Buletinin e Njftimimeve Zyrtare, në zbatim të nenit 11, pika 2 të ligjit nr. 133/2015.*

**Periudha janar-dhjetor 2020**

**1. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare.**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, janë regjistruar pranë sporteleve 67 aplikime të reja për kompensim financiar/fizik dhe ka vijuar procesi i shqyrtimit të dosjeve të cilat janë depozituar më parë të cilët do të trajtohen me vendim.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, ATP ka vijuar procedurat për kompensim financiar/fizik, dhe rezultojn :

-Janë administruar 67 aplikime të reja;

-Janë ekzekutuar 25 vendime me vlerë financiare dhe 1 vendim është mbyllje procedimi;

-Është shpërndarë Fondi Financiar, në vlerë prej 49,115,904.46 lekë

-Nga Fondi i Tokës është shpërndarë një sipërfaqe prej 1,009,645.2 m2 e barazvlefshme me një vlerë financiare prej 196,463,618.04 lekë.

**2. Për kompensimin financiar me kërkesë të veçantë:**

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezultojn:

-Janë administruar 55 kërkesa të reja;

-Janë trajtuar me vendim 80 aplikime, nga të cilat për 75 aplikime ATP ka vijuar me levrimin e kësteve, ndërsa për 5 aplikime është vendosur mbyllje e procedimit administrative;

### **Periudha janar-dhjetor 2021**

#### **1. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare.**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, janë regjistruar pranë sporteleve 107 aplikime të reja për kompensim financiar/fizik dhe ka vijuar procesi i shqyrtimit të dosjeve të cilat janë depozituar më parë dhe do të trajtohen me vendim.

#### **2. Për kompensimin financiar me kërkesë të veçantë:**

Gjatë muajit janar 2021 në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezulton:

-Janë trajtuar me vendim 6 aplikime, për të cilat ATP ka vijuar me levrimin e kësteve;

-Fondi që do të lëvrohet për 6 vendime në total është vlera 278,555,501.76 lekë dhe është lëvruar për këstin e parë vlera 55,711,100.35 lekë;

-Për kompensimin me kërkesë të veçantë janë lëvruar këstet e rradhës II, III, IV dhe V për aplikime të bëra në vite, në total vlera 629,568,910.35 lekë për 204 aplikime.

### **Periudha janar-dhjetor 2022**

#### **1. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare.**

-Gjatë periudhës shkurt-dhjetor nuk ka pasur vendimmarrje për kompensim financiar dhe fizik për shkak të vendimit të marrë nga Gjykata Kushtetuese në datë 15 shkurt 2021.

Me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 15.02.2021, i cili vendosi për shfuqizimin e disa pikave të ligjit nr. 133/2015, në ATP është pezulluar procesi i Kompensimit Financiar të vendimeve përfundimtare.

**Publikimet e bëra për aplikimet për periudhën janar-dhjetor 2020 nga ATP-ja janë si vijon:**

Nr.	Muaj	Aplikim nga subjekti për kompensim financiar	Aplikim nga subjekti shpronësim nga ndërtimet informale	Aplikimet e ekzekutuara nga ndërtimet informale	Dosje të tërhequra nga subjekti kërkues
1	Janar	0	119	-	83
2	Shkurt	0	119	-	71
3	Mars	8	10	-	27
4	Prill	2	32	103	4
5	Maj	6	104	62	18
6	Qershor	12	111	75	37
7	Korrik	14	157	137	46
8	Gusht	8	170	-	25
9	Shtator	18	171	131	36
10	Tetor	15	120	107	35
11	Nentor	7	131	101	28
12	Dhjetor	13	251	129	19
<b>TOTALI</b>		<b>103</b>	<b>1495</b>	<b>845</b>	<b>429</b>

**Publikimet e bëra për aplikimet për periudhën janar-dhjetor 2021 nga ATP-ja janë si vijon:**

Nr.	Muaj	Aplikim nga subjekti për kompensim	Aplikim nga subjekti shpronësim nga ndërtimet pa leje	Aplikimet e ekzekutuara nga ndërtimet informale	Dosje të tërhequra nga subjekti kërkues
1	Janar	11	190	142	16
2	Shkurt	21	172	146	17

3	Mars	11	119	144	27
4	Prill	14	94	-	20
5	Maj	4	34	-	15
6	Qershor	10	56	151	16
7	Korrik	10	57	-	9
8	Gusht	7	34	252	11
9	Shtator	4	44	-	25
10	Tetor	4	69	-	13
11	Nentor	7	23	-	10
12	Dhjetor	4	246	502	15
<b>TOTALI</b>		<b>536</b>	<b>1138</b>	<b>1337</b>	<b>194</b>

**Publikimet e bëra për aplikimet për periudhën janar-dhjetor 2022 nga ATP-ja janë si vijon:**

Nr.	Muaj	Aplikim nga subjekti për kompensim	Aplikim nga subjekti shpronësim nga ndërtimet pa leje	Aplikimet e ekzekutuara nga ndërtimet informale	Dosje të tërhequra nga subjekti kërkues
1	Janar	0	62	-	19
2	Shkurt	5	80	-	21
3	Mars	7	247	-	31
4	Prill	4	251	244	22
5	Maj	1	111	-	6
6	Qershor	0	56	-	13
7	Korrik	1	27	-	5
8	Gusht	1	2	-	6
9	Shtator	3	46	-	8
10	Tetor	1	34	-	4
11	Nentor	1	38	-	1
12	Dhjetor	0	14	-	2
<b>TOTALI</b>		<b>24</b>	<b>968</b>	<b>244</b>	<b>138</b>

### **Në lidhje me Trajtimi i Kërkesave për Njohje Pronësie**

ATP ka regjistruar në total 16 462 kërkesa të patrajtuara (kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas Ligjit Nr. 133/2015). Gjatë periudhës 3 vjeçare të përcaktuar në ligj janë trajtuar me vendim 9 512 kërkesa. Me përfundimin e afatit të Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka kryer njoftimin e subjektit kërkues (trashëgimtar ligjor/përfaqësues me prokurë), të tërheqë dokumentacionin e depozituar në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për 6950 kërkesa të patrajtuara.

Gjatë periudhës Janar 2022–Dhjetor 2022 rezulton se pranë ATP-së, janë depozituar 135 kërkesa për tërheqje dokumentacioni tekniko/ligjor të dosjeve të administruara pranë ATP-së, të cilat nuk rezultojnë të trajtuara me vendim brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj. Gjithashtu Sektori i Asistencës Ligjore, ka shqyrtuar kërkesat për informacion që janë depozituar pranë ATP-së nga subjektet kërkuese që kanë dosje të administruara pranë ATP-së, Avokatura e Shtetit, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit Administrativ.

### **Çështje të ndjekura e të ankimuar në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre.**

ATP për periudhën Janar - Dhjetor 2022 është përfaqësuar në dy shkallët e gjyqësorit, civil dhe në atë administrativ, për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, si vijon:

Për këtë periudhë në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor janë depozituar 471 padi në të gjitha Gjykatat e Rretheve, në Gjykatat e Apelit, në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe në Apelin Administrativ.

Gjatë kësaj periudhe janë mbyllur me vendim 465 çështje nga ku:

-Janë pranuar 31 padi.

-Janë rrëzuar 140 padi.

-Kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e çështjes 152 padi.

-Janë ushtruar 86 ankime dhe 75 rekorse.

- Në lidhje me vendimarrjen e ATP-së sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të nenit 29 të Ligjit Nr. 133/2015 rezulton se janë depozituar 7 padi dhe rrëzuar 3 padi.

- Në lidhje me kundërshtimin e vlerësimeve financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e Kompensimit parashikuar në nenin 19 të ligjit janë depozituar 8 padi dhe janë rrëzuar 3 padi.

-Në lidhje me vlerësimin financiar të vendimeve që kanë njohur të drejtën e Kompensimit parashikuar në nenin 15 të ligjit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë depozituar 27 padi.

Në lidhje me njohjen e të drejtës së pronësisë parashikuar në nenin 34 të ligjit në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile janë depozituar 179 padi.

**Titulli i Gjetjes:** Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtar për Kompensim.

**Situata:** Nga auditim i ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtar për kompensim deri në dhjetor të vitit 2022, për 7 vite nga ATP janë ekzekutuar vetem 794 vendime ekzekutimi për kompensim financiar, nga 18734 vendime përfundimtare të vlerësuara nga Sektori i Kompensimit i ATP. Ngelen për tu ekzekutuar 17 940 vendime për 4 vite të ngelura, për periudhën 2023-2026 në zbatim të nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

**Kriteri:** Ligji nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, nenit 16, pika 6.

**Efekti:** Përformancë e ulët në ekzekutimin financiar i vendimeve përfundimtar për kompensim. **Shkak:** Mungesë përgjegjshmërie nga ish-drejtuuesit dhe stafi i ATP.

**Rëndësia:** I lartë

#### **Pika 5. Zbatimi i legjislacionit në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.**

1. Dokumentacioni i parashikimeve vjetore të prokurimit publik për ATP-në për vitet 2020, 2021, 2022.

Në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka vendosur:

-Për vitin 2020 janë parashikuar të kryhen gjithsej 24 procedura prokurimi publik për blerje të vogla nga të cilat ATP ka realizuar 18 procedura prokurimi dhe 5 procedura kanë qenë mbi vlerën 800.00 lekë dhe janë realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe 1 procedurë prokurimi për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike për ATP.

1. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Mirëmbajtje kondicionerësh” datë 30.06.2020, me fond limit 600.000 ALL, fitues i procedurës “D.Xh.” rezulton se:

Oferta e subjektit fitues është anomalisht e ulët (47% e fondit limit, 279.000 ALL), sipas Nenit 56, pika 1, nën-pika a dhe c, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit kur: autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, “Mungon një informacion i tillë në dosje”, gjithashtu në përputhje me Nenin 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 në dosje mungon “Raporti elektronik i realizuar nga vetë sistemi”.

2. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparaturave, pajisje teknike, shërbim për riparimin e makinerive fotokopjuese ” datë 16.06.2020, me fond limit 800.000 ALL, fitues i procedurës “E.” në shumën 650.000 ALL, rezulton se:

Ka parregullsi në përputhshmërinë ligjore të argumentimit të fondit limit sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nuk ka procesverbale testim tregu dhe mungon argumentimi i përcaktimit të fondit limit.

-Për vitin 2021 janë parashikuar të kryhen gjithsej 25 procedura prokurimi publik për blerje të vogla nga të cilat ATP ka realizuar 17 procedura prokurimi dhe 6 procedurë ka qenë mbi vlerën 800.000 lekë dhe janë realizuar 4 nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe 2 nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

1. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Mirëmbajtje objekte ndërtimore” datë 02.11.2021, me fond limit 600.000 ALL, fitues i procedurës është “D-G” 313.760 ALL, rezulton se:

Bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, Neni 12, “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 3, në dosje mungon raporti elektronik i realizuar nga vetë sistemi; “Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit” .

2. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Dezinfektim i Ambjenteve” datë 22.02.2021, me fond limit 800.000 ALL, fitues i kontratës është “A” në shumën 265.500 ALL, rezulton se:

Oferta e subjektit fitues është anomalisht e ulët (40% e fondit limit), sipas Nenit 56, pika 1, nën-pika a dhe c, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit kur: autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, “Mungon një informacion i tillë në dosje”, gjithashtu në përputhje me Nenin 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 në dosje mungon “Raporti elektronik i realizuar nga vetë sistemi”.

3. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Shërbime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” datë 15.09.2021, me fond limit 650.000 ALL, fitues i kontratës është “S.”, në shumën 457.000 ALL, rezulton se:

Bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nga Autoriteti Kontraktor nuk ka procesverbale që të vërtetojnë të gjitha problematikat e aktiveve që janë përcaktuar në preventiv, përveç rasteve të pjesëve që kanë konsum periodik, gjithashtu rezulton që një pjesë e zërave të preventivit që nuk janë pjesë konsumi janë përfshirë dhe në zërat e preventivit të prokurimit të vitit 2020. Gjithashtu duhej pasur parasysh dhe përzgjedhja e subjektit fitues që të ishte sa më afër autoritetit kontraktor për të shmangur kostot e tepërta të transportit, kjo gjë duhet të ishte marrë parasysh nga autoriteti kontraktor përpara se të vendosej për subjektin fitues.

Për vitin 2022 janë parashikuar të kryhen gjithsej 20 procedura prokurimi publik për blerje të vogla nga të cilat ATP ka realizuar 15 procedura prokurimi dhe 6 procedurë ka qenë mbi vlerën 700.000 lekë dhe janë realizuar 3 nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe 2 nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

1. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Shërbime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” datë 07.04.2022, me fond limit 420.000 ALL, subjekti fitues “A.M”, në shumën 399.000 ALL, rezulton se:

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë, të klasifikuar si të përshtatshëm për këtë procedurë. Nga komisioni është bërë njoftimi i fituesit në sistem për ofertuesin e renditur i pari për këtë procedurë prokurimi. Me procesverbalin e datës 11.04.2022 të mbajtur nga komisioni i prokurimit operatori fitues “B” është tërhequr nga konkurimi për arsye

objektive. E njëjta situatë ka ndodhur dhe me operatorët e tjerë deri tek operatori fitues “A.M.” i renditur i pesti në këtë procedurë me vlerën 399.000 ALL pa tvsh.

Bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nga konstatimi i dosjes rezulton se:

*Nga ana e autoritetit kontraktual janë kryer shërbimet për riparim mjeti për të cilat, në dosje ka vetëm foto të mjeteve në ambientet e servisit, nuk ka procesverbal mbi gjendjen teknike të mjeteve si dhe nuk ka akte të verifikimit të difektit të mjeteve. Në këtë aspekt është e pamundur që të përcaktohet nëse janë kryer të gjitha punimet nga ana e subjektit fitues. Mungon raporti elektronik i realizuar nga vetë sistemi.*

2. Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit, “Shërbime për mirmbajtjen e aparateve dhe veglave të punës” datë 16.03.2022, me fond limit 700.000 ALL, subjekti fitues “T.E”, në shumën 612.000 ALL, rezulton se:

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomikë, të klasifikuar si të përshtatshëm për këtë procedurë. Nga sistemi është bërë njoftimi i fituesit në sistem për ofertuesin e renditur i pari për këtë procedurë prokurimi. Me procesverbalin e datës 17.03.2022 të mbajtur nga komisioni i prokurimit operatori fitues “X.S.” është tërhequr nga konkurimi për arsye objektive. Operatori fitues “T.E.” i renditur i dyti në këtë procedurë me vlerën 612.000 ALL pa tvsh.

*Nuk ka procesverbale testim tregu dhe mungon argumentimi i përcaktimit të fondit limit.*

**Pika 6.** *“Auditim mbi procedurat e ndjekuara për kompensimin financiar për vendimet përfundimtare të vlerësuara financiarisht nga fondi i kompensimit deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës të ATP-së, në zbatim të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.*

Për periudhen 2020-2022 nga ATP-ja janë marrë gjithësej 25 vendime për kompensim deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës të ATP-së:

Vendimet e marra (25) janë sipas listës si më poshtë:

Numër rendor	Aplikimi		VENDIMI I KKKP ose ZRKKP				SUBJEKTI I SHPRONËSUAR		PËRFAQËSUESI ME PROKURË		QARKU	VLERA E PËRFITUAR
	Numër dosje	Data e hapjes se dosjes	Nr.	Data	Muaji	Viti	EMËR	MBIEMËR	EMËR	MBIEMËR		
1	1222	16.10.2017	75	21	3	1995	P. D.		I.	D.	VLORE	436,120.00
2	696	13.06.2017	653	11	9	1995	N. SH.		A.	SH.	SHKODE	1,685,178.00
3	996	02.08.2018	1361	19	1	1996	M. Z.		M.	Z.	KORÇE	360,389.00
4	29	17.02.2020	674	24	1	1996	R.H.		D.	H.	TIRANË	7,031,745.00
5	55	11.03.2020	699	16	2	1996	Q.Ç		G.	N.	TIRANË	2,790,330.30
6	939	26.07.2017	178	8	11	1995	S.K.		TH.	K.	FIER	351,257.60
7	178	29.03.2018	1483	4	7	1996	N.K.		E.	K.	DURRES	386,931.00
8	1130	10.10.2018	494	29	12	1998	SH.N.		P.	N.	FIER	1,102,600.00
9	1284	06.12.2018	146	23	7	2007	SH.B.		L.	A.	KORÇE	1,020,000.00
10	59	13.05.2020	320	22	10	2007	S.M.		S.	M.	DURRES	9,816,000.00
11	69	04.06.2020	69	5	10	1994	H.I.		XH.	I.	GJIROK.	59,786.96
12	71	12.06.2020	468	14	2	1996	F.L.		E.	R.	ELBASA	368,172.13

13	793	18.05.2018	162	28	10	1996	K. K.	A.	K.	FIER	236,730.20
14	72	12.06.2020	318	22	10	2007	S.M	A.	SH.	DURRES	1,170,000.00
15	987	09.08.2017	435	25	5	1994	N. I	RR.	SH.	TIRANË	4,114,073.40
16	1030	24.08.2017	30	1	3	1995	R.D.	A.	D.	DIBER	217,685.60
17	801	23.05.2018	482	13	11	1995	O.B.	G.	B.	TIRANË	1,218,835.80
18	86	15.07.2020	428	6	2	1996	Q.R.	D.	P.	TIRANË	2,895,706.10
19	720	30.04.2018	624	25	6	1996	S.K.	G.	N.	TIRANË	1,391,391.60
20	62	20.05.2020	733	15	10	1996	M.B	N.	P.	TIRANË	2,772,516.60
21	200	15.03.2017	28	4	12	1994	H.K.	XH.	K.	TIRANË	215,769.17
22	1004	07.08.2018	545/	9	12	1994	A.GJ.	K.	GJ.	ELBASA	1,496,232.00
23	672	16.04.2018	694	5	2	1995	F. K.	G.	SH.	TIRANË	6,857,625.60
24	22	24.01.2018	94	25	1	1996	H. O.	G.	O.	VLORE	684,708.40
25	60	09.02.2018	80	30	5	1995	A.M.	H.	M.	GJIROK	436,120.00
		<b>TOTALI</b>									<b>49,115,904.5</b>

Në lidhje me sa sipër, nga grupi i auditimit u auditua dokumentacioni i vendimeve përfundimtare të vlerësuara financiarisht nga fondi i kompensimit deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës të ATP-së, si më poshtë:

### **1. Dosja e subjektit të shpronësuar K.K..**

Dosja nr. 793 prot., datë 18.05.2018, të subjektit kërkues A.K, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të trashëgimtarëve ligjor të subjektit të shpronësuar K.K, është marrë vendimi nr. 97, datë 29.06.2020, “Për kompensimin e pronës” për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr.162, datë 28.10.1996 të ish-KKKP Ballsh, në emer të subjektit të shpronësuar Kamber Kamberaj, në vleren prej 236 730.2 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 4931.8 m<sup>2</sup>, në pasuritë me nr.375, të ndodhur në Z.K. 3665, Fshati U., Bashkia Pogradec dhe pasurinë 374 të ndodhur në Z.K. 1317, Fshati B., Bashkia Pogradec, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

Në doje është administruar vendimi nr.162, datë 28.10.1996 të ish-KKKP Ballsh, në emer të subjektit të shpronësuar K.K., ku është i njohur e drejta e kompensimit të pronës për sipërfaqen 2300 m<sup>2</sup> duke u përllogaritur 2300 m<sup>2</sup> x 320 lekë/m<sup>2</sup> = 736 000 lekë.

Vendimit nr.162, datë 28.10.1996 të ish-KKKP Ballsh i mungon planimetria e miratuar nga Kryetari i Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, por në dosje ndodhet vetëm planimetria e miratuar nga zyra e urbanistikës.

Për shyrtime e kërkesës është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacioni nr. 793/6 prot., datë 29.6.2020, mbi shqyrtimin e kërkesës nr. 793 prot., datë 18.05.2018, me objekt Kompensimi i sipërfaqes së njohur me vendim nr.162, datë 28.10.1996 të ish-KKKP Ballsh, në emer të subjektit të shpronësuar K. K. i përgatitur nga grupi i punës, jurist M.B, gjeodet B. M, i pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G, i mbikqyrur nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B., ku është propozuar ekzekutimi i vlerësimit financiar dhe kalimin e shumës prej 236 730.2 lekë në llogarin bankare në emër të Kamber Kamberaj dhe kompesimin fizik nga fondi i ATP-së me sipërfaqe prej 4931.8 m<sup>2</sup> në pasurinë me nr.374, të ndodhur në Z.K. 1317, fshati B., Bashkia Pogradec dhe pasurinë nr.375 të ndodhur në Z.K. 3665, fshati U., Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.



Në dosje janë administruar edhe 3 shkresa ku njoftohet subjekti kërkues A.K. për plotësim dokumentacioni.

-Me shkresen nr.793/1 prot., datë 9.7.2019, ATK Tiranë, njofton subjektin për plotësim dokumentacioni, në lidhje me mungesen e fragmentit të hartes treguese.

-Me shkresen nr.793/2 prot., datë 31.7.2019, ATK Tiranë, përsëri njofton subjektin për plotësim dokumentacioni, në lidhje me depozitimin e fragmentit të hartes treguese.

Nga ASHK DV Fier (Zyra Mallakaster) me shkresen nr.2075/1 prot., datë 10.09.2019 është kthyer përgjigje bazuar në shkresen nr.793/2 prot., datë 31.7.2019, ATK Tiranë, ku ka të bashkëlidhur kartelen e pasurisë në Z.K. 2715 Mollaj dhe fragment të hartes kadastrale.

-Përsëri nga ATK Tiranë, me shkresen nr.793/4 prot., datë 27.9.2019, njofton subjektin për plotësim dokumentacioni, në lidhje me përcaktimin e zonës kadastrale ku keni përfituar tokë bujqësore sipas ligjit 7510, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, ndërkohë shkresa ishte e depozituar në dosje Z.K. 2715 Mollaj dhe fragmenti i hartes kadastrale, *çfarë do të thotë së nga grupi i punës zvarritet parqitja e relacionit për vendimarrje pa ndonjë motiv edhe pse dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me kërkesar të parashikon ligji.*

Në lidhje me kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 4931.8 m<sup>2</sup>, rezultoi se kjo sipërfaqe është e përfituar në dy pasuri të ndryshme, njëra me sipërfaqe 931.8 m<sup>2</sup> me nr.pasurie 375 në Z.K.3665 Fshati U., Bashkia Pogradec dhe tjetra me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup> me nr.pasuritë me nr.375, të ndodhur në Z.K.1317, Fshati B., Bashkia Pogradec, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

Nga ana inspektorit gjeodet B.M.pasuria nr.375 (pasuria “mëmë”) me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> Z.K. 3665 nuk është dhënë e gjithë pasuria subjektit të kompensuar fizikisht por është e ndarë në dy pasuri, ku njëra me sipërfaqe 931.8 m<sup>2</sup> që i ka kaluar subjektit të kompensuar dhe tjetra me sipërfaqe 1068.2 m<sup>2</sup>, ngelet pasuri në fondin e ATP-së, çfarë do të thotë se subjekti nuk është kompensuar dhe pozicionuar në pasurinë nr.375 me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, por është kompensuar vetëm për sipërfaqe 931.8 m<sup>2</sup>.

Në pasurinë me nr.375, e ndodhur në Z.K.1317, Fshati B., Bashkia Pogradec, kompensimi fizik nga fondi i ATP, duhej të ishte me sipërfaqe 2931.8 m<sup>2</sup> dhe jo 4000 m<sup>2</sup>, çfarë do të thotë se subjekti është plotësuar me kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 4931.8 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe të parcelezuar, kur nuk ka qenë e nevojshëm ndraja e pasurisë.

### **Konkluzion:**

*-ATP-ja ka kryer kompensimin fizik me fondin e tokës me sipërfaqe 4931.8 m<sup>2</sup>, duke mos zbatuar kriterin për shpërndarjen e fondit të tokës për kompensim fizik, jo në pronën gjeografisht më pranë pronës së njohur për kompensim, siç mund të jetë Qarku i Gjirokastrës ose Qarku Berat, por ka kapërcyer dy Qarqe duke kaluar në një Qarkë tjetër, konkretisht në Qarkun Korçë, Bashkia Pogradec, Fshati U., në kundërshtim me pikën 19, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.*

*-Mungon njoftimi nga ATP drejtuar subjektit kërkues A.K., për fillimin e procedurave për kompensim financiar dhe fizik me fondin e tokës, në kushtet kur VKM 223 datë 23.03.2016, ka ndryshuar mënyren dhe formen e kompesimit, ku subjekti kërkues duhet të deklaroj se është dakort për vazhdimin e procedurave sipas kushteve të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.*

*-Mungon e administruar në dosje, deklarata e subjektit kërkues për vazhdimin e procedurave për kompensim financiar nga fondi i kompensimit deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës, në zbatim të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.*

## **2. Dosja e subjektit të shpronësuar M. Z..**

Dosja nr. 996 prot., datë 02.08.2018, të subjektit kërkues znj. M.Z, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të trashëgimtarëve ligjor të subjektit të shpronësuar M.Z., është marrë vendimi nr. 84, datë 30.04.2020, “Për kompensimin e pronës” për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr.1362, datë 19.01.1996 të ish-KKKP Bashkia Korçë, në emer të subjektit të shpronësuar M.Z., në vleren prej 360 389 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaq 6522 m<sup>2</sup>, në pasuritë me nr.251, të ndodhur në Z.K. 3016, fshati P, Korçë, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

*Nga auditimi rezultoi se:*

Për shyrtimin e kërkesës nr. 996 prot., datë 02.08.2018, të subjektit kërkues znj. M.Z është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacioni nr.996/4, datë 30.04.2020, me objekt Kompensimi i sipërfaqes së njohur me vendim nr.1362, datë 19.01.1996 të ish-KKKP Bashkia Korçë, në emer të subjektit të shpronësuar M.Z.i përgatitur nga grupi i punës, inspektori jurist E.Sh.dhe inspektori gjeodet A.L., i pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G., i mbikqyrur nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B., ku është propozuar ekzekutimi i vlerësimit financiar dhe kalimin e shumës në vleren prej 360 389 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaq 6522 m<sup>2</sup> në pasuritë me nr.251, të ndodhur në Z.K. 3016, fshati P., Korçë.

Nga ana ATP-së më shkresën nr.996/3 i është drejtuar subjektit kërkues “Njoftim për plotësim dokumentacioni” ku në këtë shkresë citohet se “... nga verifikimi i dokumentacionit e administruar ne dosjen nr. 996 prot., datë 02.08.2018 si dhe në dosjen bazë që ndodhet në arkivën e ATP-së u konstatua mangësitë si më poshtë: “Dekalara noteriale përmes së cilës subjektet vetëdeklarojnë nëse kanë përfituar apo jo kompesim fizik”.

Ndërkohë në dosje është e administruar dekalara noteriale datë 18.04.2018 përmes së cilës subjektet vetëdeklarojnë nëse kanë përfituar apo jo kompesim fizik”, çfarë do të thotë se “Njoftimi për plotësim dokumentacioni”.

### **Konkluzion:**

*Relacioni nr.996/4, datë 30.04.2020 i paraqitur nga grupi i punës për ekzekutimin e vlerësimit financiar dhe kompensimin fizik është bërë 20 muaj me vonësë, pa pasur ndonjë mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor, çfarë do të thotë se subjekti kërkues nuk ka marrë shërbimin e kërkuar nga ATP-ja, brenda afateve ligjore dhe brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e Breshme të ATP-së.*

## **3. Dosja e subjektin të shpronësuar S.M.**

Për subjektin e shpronësuar S.M. nga ish-ZRKKP Qarku Durrës, janë marrë 3 vendime brenda ditës duke u ndarë në tre dosje të veçanta dhe konkretisht:

1.Me vendim nr.318, datë 22.10.2007, ish-ZRKKP Qarku Durrës, i ka njohur të drejten e pronësisë subjektit të shpronësuar S.M. një sipërfaqe prej 50 000 m<sup>2</sup>.

2.Me vendim nr.319, datë 22.10.2007 ish-ZRKKP Qarku Durrës, i ndryshuar me vendim nr.372, datë 29.06.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, i ka njohur subjektit të shpronësuar S.M. një sipërfaqe prej 74270 m<sup>2</sup> nga 80000 m<sup>2</sup> të pretenduar, pjesa tjetër prej 3930 m<sup>2</sup> ka krijuar mbivendosje me vendim nr.146, datë 30.6.2006 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, ndërsa sipërfaqja prej 1800 m<sup>2</sup> është kthyer nga ish- AKKP-së Tiranë.

3.Me vendim nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, i ka njohur të drejten e pronësisë subjektit të shpronësuar S.M. një sipërfaqe prej 120 000 m<sup>2</sup>.

Tre vendimet e sipërcituar janë mbështetur në të njëjtën dosje me nr.142 dhe 143 datë 23.07.2007, të hapur pranë kësaj zyre në emër të subjektit të shpronësuar S.M., ku kërkuesi ka paraqitur pran ZRKKP Qarku Durrës dokumentin “Vërtëtim” nr. 403 prot., datë 12.09.2007 nga Këshilli i Qarkut, Seksioni i Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës, me anë të cilit vërtëtohet se në emër të z.S.M. është regjistruar në modularin nr.1 me nr.rendor 9, në Fshatin

P. para Reformës Agrare të vitit 1946, një sipërfaqe prej 250 dy nga të cilat 200 dy tokë “arë” dhe 50 dy “livadh” si dhe 70 rrënjë “ullinj”.

Me vendim nr. 66 datë 15.01.2007 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës, është vendosur përcaktimi i vendodhjes dhe i kufizimeve të pronës të trashigimlënësit S.M. me sipërfaqe, S.1. 120 dy, S.2. 50 dy dhe S.3. 80 dy.

Bazuar në tre vendimet e sipërcituara, me datë 08.10.2018, subjekti kërkues z. I.M, në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M. *ka plotësuar formularin e aplikimit nr. 1121 prot., sipas rubrikave përkatëse ku ka shprehur vullnetin e tij të lirë për kompensim financiar me kërkesë të veçantë në masën 40% të vlerës dhe heqjen dorë nga pjesa tjetër e mbetur prej 60%.*

Aplikimi nr. 1121 prot., me datë 08.10.2018 subjekti kërkues z. I.M, në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M. edhe pse *kan kaluar 2 vite nuk është shqyrtuar kërkesa për kompensimin financiar nga Sektori i Trajtimit të Kërkesave të Veçanta edhe pse kërkuesi legjitimohet në kërkesën e tij për kompensimin financiar të pronës në kuptim të nenit 5, pika 9 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar si dhe bazuar në aktet që shoqërojnë kërkesën e tij.*

Mbas 18 muajsh nga ATP-ja me shkresën nr.1121/1 prot., datë 21.04.2020 është kërkuar “Vertëtim Kadastral” drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës, ku nga Këshilli i Qarkut është kthyer përgjigje brenda javës.

Trashigimtari i subjektit të shpronësuar z. I.M, ka parqitur përsëri kërkesë pranë ATP-së me nr.1121/2 prot., datë 22.04.2020 me objekt:

-Trajtimin i vendimit nr.318 dhe nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në Sektorin e Kompensimit Financiar e Fizik.

-Trajtimin e vendimit nr.372, datë 29.06.2009 të AKKP-së, në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta.

Dy vendimet e ish-ZRKKP Qarku Durrës nr.318 dhe nr.320, datë 22.10.2007, trashigimtari i subjektit të shpronësuar z. I.M, me datë 05.05.2020 i shet palës blerëse z. S.M. dhe z. A. Sh. të gjithë të drejtat që rrjedhin nga vendimi nr.318 dhe nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës.

Direkt mbas blerjes e të gjithë të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr.318 dhe nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës është pranuar dhe shqyrtuar kërkesa nr. 59 prot., datë 13.05.2020 të palës blerëse z. S.M. dhe kërkesa nr. 72 prot., datë 12.06.2020 të palës blerëse A.Sh. për kompensimin financiar e fizik të pronës së njohur, ku në mënyrë të përsheptuar është marrë edhe vendimi për kompensim financiar dhe fizik nga ATP-ja.

Lidhur sa më sipër, bazuar në tre vendimet e subjektit të shpronësuar S.M. pranë ATP-së Tiranë janë shqyrtuar dy aplikime nga Sektori i Kompensimit Financiar e Fizik dhe për një aplikim subjekti ka shprehur vullnetin për kompensim financiar me Kërkesë të Veçantë për Kompensim Financiar dhe konkretisht:

**3.1. Në lidhje me vendimin nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës,** të subjektit të shpronësuar S.M., është shqyrtuar kërkesa nr. 59 prot., datë 13.05.2020, bazuar në aplikimin e subjektit kërkues S.M. në cilësinë e subjektit përfitues të subjektit të shpronësuar S.M., ku është marrë vendimi nr. 89 datë 22.05.2020, për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në emer të subjektit të shpronësuar S.M., në vlerën prej 9,816,000 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 185 315.3 m<sup>2</sup>, në pasurinë nr. 246 në Z.K. 1536, sipërfaqe 2800 m<sup>2</sup>, fshati I., Bashkia Belsh, Qarku Elbasan, pasuria nr.1/81 me sipërfaqe 1951.7 m<sup>2</sup>, fshati S., Bashkia Ura Vajgurore, Qarku Berat, pasuria nr.136 me sipërfaqe 4400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.137 me sipërfaqe 15400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.138 me sipërfaqe 9400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.139 me sipërfaqe 2500 m<sup>2</sup>, ndodhur në Z.K. 2457, fshati L., Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, pasurinë 342/, me sipërfaqe 7500 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Z.K. 2091. Fshati K., Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, pasuria nr.49/11 me sipërfaqe 12293 m<sup>2</sup>, ndodhur në Z.K. 1795, fshati G., Bashkia Pogradec,

Qarku Korçë, pasuria nr. 119/2, me sipërfaqe 78966.4 m<sup>2</sup> dhe pasuria nr. 108/7, me sipërfaqe 50104.2 m<sup>2</sup> fshati të ndosur në Z.K. 1753, fshati Gj., Bashkia Belsh, Qarku Elbasan, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

Në dosje është administruar një kontratë shitje dhe transferimi, ku trashigimtari i subjektit të shpronësuar z. I.M., me datë 05.05.2020 në bazë të kontratë-shitje dhe transferimi i shet palës blerëse z. S.M. të gjithë të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në emër të subjektit të shpronësuar S.M., për sipërfaqen prej 120 000 m<sup>2</sup>. Çmimi që blerësi do ti paguaj shitësit për blerjen e kalimin e të drejtave që rrjedhin nga vendimi si dhe të gjitha të drejtave të tjera të lidhur me të, është 79,000 Euro.

Për sa më sipër, subjekti kërkues z. S.M., blerësi i të drejtave reale nga trashëgimtari ligjor i subjektit të shpronësuar nëpërmjet kontratës së shit-blerjes dhe transferimit, është trajtuar për kompensim në totalë në shumën prej 49,080,000 lekë, ku shuma prej 9,816.000 lekë është 20/% e vlerës financiare e publikuar dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtarë 80 % i vlerës është i barabartë me shumen prej 39 264 000 lekë që do të kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës. Kjo vlerë e konvertuar në m<sup>2</sup> përfshinë një sipërfaqe prej 185 315.3 m<sup>2</sup>.

Nga ana e inspektorit jurist M.B dhe inspektori gjeodet B.M.me shkresën nr.59/1 datë 22.05.2020, i është drejtuar znj. J.B. Drejtor i Përgjithshëm, nëpërmjet Drejtorit të Kompensimit S.D. dhe Përgjegjësit Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G., “Relacioni” ku i drejtohen Drejtorit të Përgjithshëm se z. S.M., në cilësinë e subjektit përfitues të subjektit të shpronësuar S.M., ka paraqitur kërkesën e tji nr. 59 prot., datë 13.05.2020, me objekt për kompensimin e pronës së njohur me vendim nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës në emër të subjektit të shpronësuar S.M.

Në relacion ndër të tjera citohet së “...nga korespondeca me Sektorin e Kompensimit të Kërkesave të Veçanta rezulton se vendimi objekt shqyrtimi administrativ ka qënë objekt shqyrtimi pranë këtij sektori, por me kërkesën nr.1121/2 prot., datë 22.04.2020 subjekti ka kërkuara që ky vendim të kalojë për shqyrtim pranë Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe në vijim të kësaj kërkesë nëpërmjet Memo nr.1121/3 prot., datë 08.05.2020 është bërë kalimi i dokumentacionit pranë këtij sektori.

Edhe nga verifikimet në database-n e kompensimit, ku jepen të dhënat mbi përfituesin e kompensimeve financiare ndër vite, nuk rezulton që për vendimin për të cilin aplikohet në këtë procedim, subjekti i shpronësuar të kenë përfituar kompensim financiar.

Mbi këtë “Relacioni” të paraqitur nga grupi i punës është marrë edhe vendimi nga Drejtori i Përgjithshëm.

#### **Konkluzion:**

*-Nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit kërkues S.M. në cilësinë e blerësit të të drejtave që burojnë nga vendimi ish-ZRKKP Qarku Durrës, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar, pika 1.*

*-Nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim aplikimi nr. 1121 prot., datë 08.10.2018, i subjektit kërkues z. I.M, në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M., ku ka shprehur vullnetin e tij të lirë për kompensim financiar me kërkesë të veçantë në masën 40% të vlerës dhe heqjen dorë nga pjesa tjetër e mbetur prej 60%, por ka kaluar për shqyrtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit një vleftë prej 29,448,000 lekë, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.*

*-Nga ATP-ja është shtyrtuar kërkesa nr. 59 prot., datë 13.05.2020, të subjektit kërkues S. M, në cilësinë e subjektit përfitues të subjektit të shpronësuar S.M., brenda javës pa respektuar aplikimet e tjera të bëra nga subjektet e shpronësuar.*

*-Është marrë vendim nga ATP-ja për kompensimin fizik me fondin e tokës me sipërfaqe 185 315.3 m<sup>2</sup>, duke mos zbatuar kriterin e përzgjedhjes së pronës gjeografisht më pranë pronës të njohur për kompensim fizik, por është i kompensuar në një qarkë tjetër më largë se prona e njohur për kompensim, konkretisht në 4 pasuri të përzgjedhura buzë rrugës nacionale Tiranë-*

*Pogradec me sipërfaqe totale prej 31 700 m<sup>2</sup> dhe konkretisht, pasuria nr.136 me sipërfaqe 4400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.137 me sipërfaqe 15400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.138 me sipërfaqe 9400 m<sup>2</sup>, pasuria nr.139 me sipërfaqe 2500 m<sup>2</sup>, ndodhur në Z.K. 2457, fshati Lin, Bashkia Pogradec, në kundërshtim me pikën 19, të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.*

*-Planvendosja e pronës që shoqëron vendimin e kompensimit fizik nuk ka të plotësuar të dhënat e llojit të pasurisë si dhe kordinatat e vendodhjes së pasurisë.*

**3.2. Në lidhje me vendimin nr.318, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës,** të subjektit të shpronësuar S.M., është shyrtuar kërkesa nr. 72 prot., datë 12.06.2020, bazuar në aplikimin e **subjektit kërkues A.Sh** në cilësinë e subjektit përfitues të subjektit të shpronësuar S.M., ku është marrë vendimi nr. 100, datë 29.06.2020, për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr.318, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në emer të subjektit të shpronësuar S.M., në vleren prej 1,170,000 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 46800 m<sup>2</sup>, në 10 pasuri në Z.K. 3819, Fshati V. Qarku Korçë, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

*Nga auditimi rezultoi se:*

Për shyrtrimin e kërkesës nr. 72 prot., datë 12.06.2020, të subjektit kërkues A.Sh. është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacioni nr.72/1, datë 29.6.2020, me objekt Kompensimi i sipërfaqes së njohur me vendim nr.318, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në emer të subjektit të shpronësuar S.M. i pregatitur nga grupi i punës, jurist V. N., gjeodet B.M., i pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G., i mbikqyrur nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B., ku është propozuar ekzekutimi i vlerësimit financiar dhe kalimin e shumës në vleren prej 1,170,000 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 46800 m<sup>2</sup>, në 10 pasuri në Z.K. 3819, Fshati V. Qarku Korçë, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

Në dosje është administruar një kontratë shitje, ku trashigimtari i subjektit të shpronësuar z. I.M., me datë 05.05.2020 në bazë të kontratë-shitje dhe transferimi i shet palës blerëse z. A.Sh. të gjithë të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr.318, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në emer të subjektit të shpronësuar S.M., për sipërfaqen prej 50 000 m<sup>2</sup>. Çmimi që blerësi do ti paguaj shitësit për blerjen e kalimin e të drejtave që rrjedhin nga vendimi si dhe të gjitha të drejtave të tjera të lidhura me të, është 970 000 lekë.

Subjekti kërkues z. A.Sh., blerësi i të drejtave reale nga trashëgimtari ligjor i subjektit të shpronësuar nëpërmjet kontratës të shit-blerjes dhe transferimit, është trajtuar për kompensim në totalë me shumën prej 5,850,000 lekë, ku vlera prej 1,170,000 lekë është 20/% e vlerës financiare e publikuar dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtarë 80% i vlerës i barabartë me shumën prej 4,680,000 lekë do të kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës, jo vlerë e konvertuar në m<sup>2</sup> përfshinë një sipërfaqe prej 46 800 m<sup>2</sup>, që do të kompensohet fizikisht. Një kopje e vendimit nr. 100, datë 29.06.2020, “Për kompensimin e pronës” është dërguar në DV ASHK Korçë me shkresën nr.72/3 prot., datë 29.6.2020, për regjistrimin e pasurive të përfituar me kompensim fizik me sipërfaqe 46 800 m<sup>2</sup>, në 10 pasuri të ndryshme që ndodhen në Z.K. 3819, Fshati V. Qarku Korçë.

Kompensimi fizik me sipërfaqe 46800 m<sup>2</sup>, që ndodhet në Z.K. 3819, fshati V. Qarku Korçë, nuk është regjistruar nga DV ASHK Korçë për faktin së nga 10 pasuri, 4 janë me mbivendosje me pasuritë e regjistruar në emer të K-M Korçë.

Në këto kushte nga ana DV ASHK Korçë me shkresën nr.1330 prot., datë 10.7.2020 i është drejtuar aplikuesit A.Sh. për dijeni ATP-së “Për plotësim dokumentacioni”, në shkresë citohet se “...pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjir rezultoi se pasuritë 733, 737, 765 dhe 767 me sipërfaqe totale prej 10227 m<sup>2</sup> krijojnë mbivendosje, pasi në këto pasuri figuron pronarë Manastiri Shën Prodhomit sipas AMTP-së dhe se në këto pasuri në seksioni “E” të kartelës nuk është e regjistruar “kufizim” në favor të ATP-së. Ndërsa për 6 pasuritë e tjera me sipërfaqe

36573 m<sup>2</sup> ka mospërputhje të sipërfaqes të çeluara sipas kartelave përkatëse dhe sipërfaqeve sipas ATP-së”.

Për 6 pasuritë e tjera që nuk kanë krijuar mbivendosje mund të vazhdoni procedurat e regjistrimit citohet në shkresë, duke paraqitur një planrilevimi të detajuar për sipërfaqën që ju do të regjistroni.

Në lidhje sa më sipër,

Nga ana e inspektorit gjeodet B.M.dhe inspektorit jurist V.N me shkresën nr.72/6 datë 24.9.2020, i është drejtuar znj. J.B. Drejtor i Përgjithshëm, nëpërmjet Drejtorit të Kompesimit S.D.dhe Përgjegjësit Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G., me një “Memo” ku këkohet korigjimi i vendimit nr. 100, datë 29.06.2020, “Për kompensimin e pronës” për pikën 3 të dispozitivit të saj si dhe në planëvendosjen përkatëse si më poshtë:

Në pikën 3 të dispozitivit të vendimit në vend të numrit të pasurive (10 pasuri) të ndodhur në Z.K. 3819, Fshati V., Qarku Korçë, të vihet numri i sakt 179/2. Z.K. 1556 me sipërfaqe 26 896.55 m<sup>2</sup>, pasuri e ndodhur në fshatin D., Njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, sipas pozicionimit të pasqyruar në planvendosjen përkatëse të pronës ku shtrihet ky numër pasurie.

Me vendimi nr. 131, datë 24.09.2020 “Për korigjimin e gabimit material të vendimit nr.100, datë 29.06.2020” ATP-ja ka vendosur të kompensoj fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe 46 800 m<sup>2</sup>.

#### **Konkluzion:**

*-Nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit kërkues A.Sh. në cilësinë e blerësit të të drejtave që burojnë nga vendimi ish-ZRKKP Qarku Durrës, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar, pika 1.*

*-Nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim aplikimi nr. 1121 prot., datë 08.10.2018, i subjektit kërkues z. I.M., në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M. ku ka shprehur vullnetin e tij të lirë për kompensim financiar me kërkesë të veçantë në masën 40% të vlerës dhe heqjen dorë nga pjesa tjetër e mbetur prej 60%, por ka kaluar për shqyrtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit një vlefte prej 3,510,000 lekë, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.*

*-Është marrë vendim nga ATP-ja për kompensimin fizik me fondin e tokës me sipërfaqe 46 800 m<sup>2</sup>, duke mos zbatuar kriterin e përzgjedhjes së pronës gjeografisht më pranë pronës të njohur për kompensim fizik, siç mund të jetë Qarku i Elbasanit, por është i kompensuar në një Qarkë tjetër më largë se prona e njohur për kompensim, konkretisht në Fshatin V. Qarku Korçë, në kundërshtim me pikën 19, të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.*

*-Mungon në dosje e administruar “Kërkesa për konfirmim” brenda institucionit, nëse pranë Sektorit të Kërkesave të Veçanta ka aplikime apo ekzekutime për këtë vendim.*

*-Mungon në dosje e administruar E-maile të printuara në lidhje me “Kërkesa për konfirmim” brenda institucionit (ATP-së).*

*-Nga inspektori gjeodet B.M.dhe nga inspektori jurist V.N., pasuritë e përcaktuara për kompensim fizik nga fondi i tokës, nuk është kërkuar informacion nga DV ASHK Korçë për statusin juridik të pasurive nëse janë në pronësi “shtet” apo “të të tretet” në kundërshtim me pikën 39, gërma “ç”, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.*

*-Për 6 pasuritë e tjera me sipërfaqe 36573 m<sup>2</sup> që nuk ka mbivendosje nuk është vijuar me përgatitjen për saktësimin e sipërfaqeve të lira që janë pjesë e fondit të ATP për kompensim fizik, por ka vijuar procedurën për kompensim në një zonë kadastrale të një qarku tjetër, pa pasur më parë një kërkesë nga subjekti për kompensim fizik me pronë shtetërore, në kundërshtim me pikën 39, gërma “b”, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.*

#### **4. Dosja e subjektit të shpronësuar Q.T..**

Dosja nr. 86 prot., datë 15.07.2020, të subjektit kërkues znj. D.P., në cilësinë e trashigimtarit ligjorë e subjektit të shpronësuar Q.T., është marrë vendimi nr. 126 datë 22.05.2020, “Për kompensimin e pronës” për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr.428, datë 06.02.1996 të ish-KKKP Tiranë, në emer të subjektit të shpronësuar Q.T., në vleren prej 2,895,706.1 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe totale 57376.593 m<sup>2</sup>, nga këto sipërfaqë 3699 m<sup>2</sup> në pasurinë nr. 354 në Z.K. 2404, fshati L., Qendër Kurvelesh, Rrethi Tepelenë, sipërfaqe 6799 m<sup>2</sup>, në pasurinë nr. 31/4 në Z.K. 2348, fshati K., Qendër Piskovë, Rrethi Përmet, sipërfaqe 7593.013 m<sup>2</sup>, në pasurinë nr. 384 në Z.K. 3327, fshati Sh., Qendër Shushice, Rrethi Elbasan dhe sipërfaqe 39285.58 m<sup>2</sup>, në pasurinë nr. 373/1 në Z.K. 3327, fshati Sh., Qendër Shushice, Rrethi Elbasan, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit. *Nga auditimi rezultoi se:*

Për shyrtimin e kërkesës 86 prot., datë 15.07.2020, të subjektit kërkues znj. D.P. është ngritur një grup pune për shyrtimin e kërkesës, me të cilën është paraqitur relacioni nr.86/1, datë 23.9.2020, me objekt kompensimi i sipërfaqes së njohur me vendim nr.428, datë 06.02.1996 të ish-KKKP Tiranë, në emer të subjektit të shpronësuar Q.T., i përgatitur nga grupi i punës, jurist V.N., gjeodet B.M., i pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik Y.G..

Relacioni nr.86/1, datë 23.9.2020, është mbikqyrur nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B..

Në dosje është administruar Emaillet e printuar në lidhje me në lidhje me “Kërkesa për konfirmim” brenda institucionit (ATP-së).

Në dosje është administruar deklarata noteriale datë 13.07.2020, ku deklarohet se nuk kam përfituar nga shpërndarja e tokës bujqësore sipas dispozitave të ndryshme ligjore, nuk kam përfituar kompensim fizik si dhe nuk kam bërë kërkesë të veçanta për kompensim financiar. Në dosje është administruar deklarata noteriale datë 13.07.2020, ku deklarohet se nuk kam përfituar nga shpërndarja e tokës bujqësore sipas dispozitave të ndryshme ligjore, nuk kam përfituar kompensim fizik si dhe nuk kam bërë kërkesë të veçanta për kompensim financiar. Mungon e administruar në dosje, deklarata e subjektit kërkues për vazhdimin e procedurave për kompensim financiar nga fondi i kompensimit deri në 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës, në zbatim të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, znj. V.N. me detyrë, specialist/jurist.*

*Raste kur nga ana e ATP-së është punuar me dy standarte, ku për disa subjekte edhe pse kanë aplikuar ndër vite për kompensimin financiar të pronës, janë marrë vendime mbas 2-3 vitesh ndërsa për disa subjekte janë shqyrtuar dhe janë marrë vendime nga ATP brenda muajt nga momenti i aplikimit nga subjektit i shpronësuar dhe konkretisht:*

#### **5. Dosja e subjektit të shpronësuar O.B..**

Dosja nr. 801 prot., datë 23.05.2018, të subjektit kërkues znj. G.B., përfaqësues me prokurë e trashigimtarëve e subjektit të shpronësuar O.B., është marrë vendimi nr. 124 datë 23.09.2020, “Për kompensimin e pronës” për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr. 482, datë 13.11.1995 të ish-KKKP Tiranë, në emer të subjektit të shpronësuar O.B., në vleren prej 1,218,835.80 lekë si dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqe totale 21 960.01 m<sup>2</sup>, nga këto e ndarë në sipërfaqe 20 281.59 m<sup>2</sup> në pasurinë nr. 21/5 në Z.K. 2256 dhe sipërfaqen 1 679.42 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 24/4 në Z.K. 2256, Fshati K., Qarku Elbasan, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

*Nga auditimi rezultoi se:* Për shyrtimin e kërkesës nr. 801 prot., datë 23.05.2018, të subjektit kërkues znj. G.B. është ngritur një grup pune për shyrtimin e kërkesës, me të cilën është paraqitur relacioni nr. 801/1, datë 23.9.2020, me objekt Kompensimi i sipërfaqes së njohur me vendim nr. 482, datë 13.11.1995 të ish-KKKP Tiranë, në emer të subjektit të shpronësuar O.B., i përgatitur nga grupi i punës, jurist E.S., gjeodet E.S., i pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të

Kompensimit Finaciar dhe Fizik Y.G., i mbikqyrur nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B..

Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur është hapur dosja nr. 801 prot., datë 23.05.2018 në të cilën ndodhën të administruar dokumentat e kërkuar, ku dokumenti i fundit i kërkuar nga grupi i punës mbanë datën 15.9.2018 (prokura e posaçme nga dhoma e noterisë Tiranë).

Nga grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e kërkesës mbas 28 muajve është dorëzuar relacioni për marrjen e vendimit për kompensimin financiar të pronës së njohur me vendim nr. 482, datë 13.11.1995 të ish-KKKP Tiranë edhe pse e gjithë dokumentacioni i kërkuar është i plotësuar sipas parashikimeve të legjistacionit në fuqi, veprime këto në kundërshtim me ligjin 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe me VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

#### **6. Dosja e subjektit të shpronësuar Q.T.**

-Në lidhje me dosjen nr. 86 prot., datë 15.07.2020, të subjektit kërkues znj. D.P., në cilësinë e trashigimtarit ligjorë e subjektit të shpronësuar Q.T., rezultoi se nga grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e kërkesës është dorëzuar relacioni brenda 2 muajve për marrjen e vendimit nr. 126 datë 23.09.2020, “Për kompensimin financiar të pronës”.

#### **7. Dosja e subjektit të shpronësuar M.G.**

-Në lidhje me dosja nr. 62 prot., datë 20.05.2020, të subjektit kërkues z. N.P., përfaqësues me prokurë e trashigimtarëve e subjektit të shpronësuar M.G., rezultoi se nga grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e kërkesës është dorëzuar relacioni brenda 4 muajve për marrjen e vendimit nr. 128 datë 23.09.2020, “Për kompensimin financiar të pronës”.

**Konkluzion:** Nga ana e ATP-së është punuar me dy standarte, ku për disa subjekte edhe pse kanë aplikuar ndër vite për kompensimin financiar të pronës, janë marrë vendime mbas 2-3 vitesh ndërsa për disa subjekte janë shqyrtuar dhe janë marrë vendime nga ATP brenda muajt nga momenti i aplikimit nga subjektit i shpronësuar.

**1.Titulli i Gjetjes:** ATP-ja ka kryer kompensimin fizik me fondin e tokës, jo në pronën gjeografisht më pranë pronës së njohur për kompensimit.

**Situata:** Është kryer kompensim fizik me fondin e tokës me sipërfaqe 4931.8 m<sup>2</sup>, për subjektin kërkues A.K. duke mos zbatuar kritërin për shpërndarjen e fondit të tokës për kompensim fizik, jo në pronën gjeografisht më pranë pronës së njohur për kompensim, siç mund të jetë Qarku i Gjirokastres ose Qarku Berat, por ka kapërcyer dy Qarqe duke kaluar në një Qarkë tjetër, konkretisht në Qarkun Korçë, Bashkia Pogradec, Fshati U., në kundërshtim me pikën 19, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” i ndryshuar.

**Kritëri:** VKM nr. 223, datë 23.3.2016 pikën 19.

**Shkaku:** Miratimi nga ATP-ja jo në pronën gjeografisht më pranë pronës së njohur për kompensim fizik.

**Impakti:** Përfitim i padrejtë i pronës së njohur për kompensim fizik.

**Rëndësia:** I mesëm.

**2.Titulli i Gjetjes:** ATP-ja ka kryer kompensimin fizik me fondin e tokës, duke mos njoftuar subjektin për vazhdimin e procedurave për kompensim financiar dhe fizik me fondin e tokës.

**Situata:** Mungon njoftimi nga ATP drejtuar subjektit kërkues A.K., për fillimin e procedurave për kompensim financiar dhe fizik me fondin e tokës, në kushtet kur VKM 223 datë 23.03.2016, ka ndryshuar mënyren dhe formen e kompensimit, ku subjekti kërkues duhet të deklaroj se është dakort për vazhdimin e procedurave sipas kushtëve të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016”.

**Kritëri:** VKM nr. 223, datë 23.3.2016 pikën 19.



**Shkaku:** Miratimi nga ATP-ja i kompensimit financiar pa pasur më parë një njetim për fillimin e procedurës.

**Impakti:** Përfitim i pa vullnëtshtëm i formes së kompensimit financiar i pronës së njohur.

**Rëndësia:** I mesëm.

**3.Titulli i Gjetjes:** Drejtuesi i ATP-së ka pranuar Relacionin nga grupi i punës 20 muaj me vonesë jashtë çdo afati.

**Situata:** Relacioni nr.996/4, datë 30.04.2020 i paraqitur nga grupi i punës për ekzekutimin e vlerësimit financiar dhe kompensimin fizik në lidhje me shyrtime të kërkesës nr. 996 prot., datë 02.08.2018, të subjektit kërkues znj. M.Z., është bërë 20 muaj me vonesë, pa pasur ndonjë mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor, çfarë do të thotë se subjekti kërkues nuk ka marrë shërbimin e kërkuar nga ATP-ja, brenda afatëve ligjore në kundërshtim me pikën 2 të nenit 91 “Afati për përfundimin e procedurës administrative” të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative i R.SH.

**Kritëri:** Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative i R.SH. pikën 2 e nenit 91.

**Shkaku:** Miratimi me shumë vonesë nga ATP-ja i kompensimit financiar subjektit kërkues.

**Impakti:** Subjekti kërkues nuk ka marrë në kohën e duhur shërbimin e kërkuar nga ATP-ja.

**Rëndësia:** I mesëm.

**4.Titulli i Gjetjes:** Drejtuesi i ATP-së nuk ka vepruar për bashkimin e vendimeve përfundimtare për ekzekutim.

**Situata:** Nga ish-ZRKKP Qarku Durrës janë marrë tre vendime në emër të subjektit të shpronësuar S.M. konkretisht: me vendimin nr.318, datë 22.10.2007, i ka njohur të drejtën e pronësisë me sipërfaqe prej 50 000 m<sup>2</sup>, me vendim nr.319, datë 22.10.2007 ish-ZRKKP Qarku Durrës, i ndryshuar me vendim nr.372, datë 29.06.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, i ka njohur subjektit të shpronësuar S.M. një sipërfaqe prej 74270 m<sup>2</sup> nga 80000 m<sup>2</sup> të pretenduar, pjesa tjetër prej 3930 m<sup>2</sup> ka krijuar mbivendosje me vendim nr.146, datë 30.6.2006 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, ndërsa sipërfaqja prej 1800 m<sup>2</sup> është kthyer nga ish- AKKP-së Tiranë dhe me vendim nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, i ka njohur të drejtën e pronësisë subjektit të shpronësuar S.M. një sipërfaqe prej 120 000 m<sup>2</sup>.

Nga ATP-ja nuk është vepruar për bashkimin e tre vendimeve përfundimtare për tu ekzekutuar, në emër të subjektit të shpronësuar S.M. veprim ky në kundërshtim me pikën 2/1 të VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” i ndryshuar.

**Kritëri:** VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016 pika 2/1.

**Shkaku:** Mos bashkimi i vendimeve përfundimtare në një të vetëm për ekzekutim.

**Impakti:** Zvarritje nga ana ATP në vendimarrje për kompensim financiar.

**Rëndësia:** I mesëm.

**5.Titulli i Gjetjes:** Transferimi i dosjes nga Sektori i Kërkesave të Veçanta në Sektorin e Kompensimit Financiar 20% me 80%.

**Situata:** Nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim aplikimi nr. 1121 prot., datë 08.10.2018, i subjektit kërkues z. I.M., në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M. ku ka shprehur vullnetin e tij të lirë për kompensim financiar me kërkesë të veçantë në masën 40% të vlerës dhe heqjen dorë nga pjesa tjetër e mbetur prej 60%, por është transferuar dhe pranuar dosja për shqyrtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit një vlerë prej 32,958,000 lekë, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.

**Kritëri:** VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016, pika 22, germa “b”.

**Shkaku:** Mos shqyrtimi i dosjes nga Sektori i Kërkesave të Veçanta.

**Impakti:** Mos kursimi nga buxheti i shtetit një vlerë prej 32,958,000 lekë, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.

### **8. Dosja e subjektit të shpronësuar R.H..**

Në emër të subjektit të shpronësuar R.H. është marrë vendimi me nr. 83, datë 30.04.2020, për kompensimin financiar në vlerën 7,031,745 (shtatë milionë e tridhjetë një mijë e shtatëqint e dyzet e pesë) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 126,698.1m<sup>2</sup> në fshatin, P. Shushicë, Elbasan, me nr. pasurie 376, 380, 388, 392, 394, 402, 403, 447, 450, 451, 456, 482, në Z.K 3022.

Në Vendimin me nr.4102 si dhe Akti nr.6068 ka lëshuar aktin e trashëgimtarve M. H., A.H., S.H., B.H.

Në Vendimin me nr. 4967 si dhe Akti nr.8415 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë të ndjerit M.H., me trashëgimtare D.H., bashkeshortja, E.M. e bija dhe M.Gj. e bija.

Për shqyrtimin e kërkesave të qytëtarve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i tyre konstatohet se është bërë selektiv, kur ka dosje me vitë të bëra kërkesat pranë ATP dhe nuk janë shqyrtuar ndërsa aplikim me nr. 29, datë 17.02.2020, është përfunduar brenda 2 muajve, pa ndjekur rradhen sipas datave të aplikimeve.

Në dokumentacionin e bashkangjitur vendimit është paraqitur me prokurë znj. D.H., e cila përfaqëson, B.A., S.K. dhe A.H. si dhe prokura e M.G., banuse në Peshtan Kolonjë-Ersekë, konstatohet se në dokumentacionin e paraqitur nuk ka të dhëna nga ish-ZRPP Ersekë aktualisht ASHK- Kolonjë, pavarësisht Deklaratës Notëriale me nr. 8756 Rep dhe nr. 1036 nga D.H. e cila deklaron se “subjektët e shpronësuar nuk kanë përfituar tokë buqësore“ nuk është paraqitur një dokument ligjor nëse M.G ka përfituar tokë buqësore, veprim ky në kundërshtim me nënin 21 (Pika 2 ) dhe nënin 36 (Pika 1 ) e ligjit 133/2015 me ndryshime si dhe VKM nr.222 datë 23.03.2016 citon “Për trajtimin e kërkesave për njohje të të drejtës të kompesimit të pronës” të ndryshuar kreu i III (pika 12).

### **9. Dosja e subjektit të shpronësuar S.K.**

Në emër të subjektit të shpronësuar S.K. është marrë vendimi me nr.91, datë 22.05.2020, për kompensimin financiar në vlerën 351,257.6 (Treqint e pesëdhjet e nje mije e dyqind e pesëdhjet e shtatë pike gjashtë ) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 6921.23 m<sup>2</sup> në fshatin Allambrez, Rrethit Berat, me nr. pasurie 1043/2, zona kodastrale 1016. Aplikim është bërë në ATP në vitin 2017 me nr. prot 939 datë 26.07.2017, mbas 3 vitesh me datë 22.05.2020 është marrë vendimi datë 22.05.2020, për kompensim financiar dhe kompensim fizik pra kemi zgjatje të procedurave prej 3 vitesh, ndërko i gjithë dokumentacioni ka qenë në përputhje me kërkesat e ligjit.

Në dokumentacionin e bashkangjitur vendimit me nr 91 ,datë 22.05.2020 të z.Th.K., në cilësinë e trashëgimtarit të vetëm, banues në Zharës Patos, në Deklaratën Notëriale me nr.2379 Rep dhe Nr.1330 Kol, deklaron se “subjektët e shpronësuar nuk kanë përfituar toke buqësore“ nuk argumentohet me dokument argumentus ligjor nëse ka përfituar toke buqësore.

### **10. Dosja e subjektit të shpronësuar N.K..**

Në emër të subjektit të shpronësuar N.K. është marrë vendimi me nr.88, datë 22.05.2020, për kompensimin financiar në vlerën 386,931 (Treqint e tëtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqint e tridhjet e një ) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 6586.1 m<sup>2</sup> në fshatin Garunj e Vogel, Peqin–Elbasan, me nr.pasurie 157/1, zona kodastrale 1696.

Për shqyrtimin e kërkesave të qytëtarve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i tyre konstatohet se është bërë në mënyrë selektive, çfarë do të thotë se kërkesa e bërë në ATP me nr. prot 178 datë 29.03.2018, është shqyrtuar me datë 22.05.2020, Në relacionin e paraqitur nga grupit i punës nuk ka një dokument justifikues për vonesat e krijuara.

### **11. Dosja e subjektit të shpronësuar Q.Ç..**

Në emër të subjektit të shpronësuar Q.Ç. është marrë vendimi me nr.82, datë 30.04.2020 për kompensimin financiar në vlerën 2,790,330.3 (dy milion e shtatëqint e nëntëdhjetë mijë e treqint e tridhjetëtre, pike tre) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe

64,145,5.1 m<sup>2</sup> në fshatin Gurakuq, Bashkia Librazhd, me nr.pasurie 1559, zona kodastrale 1887.

Në dosjen e subjektit të shpronësuar, konstatohet se mungon statusi juridik nga ASHK – Librazhd, për sipërfaqën që do të kompensohet fizikish nga fondi i ATP-së.

Nga auditimi rezultoi se kërkesa e z. G.N.j me nr. 55 prot, datë 11.03.2020, është përfunduar brenda 50 ditëve (brenda afateve që parashikon Kodi i Procedurës Administrative, pika 2 e nenit 91 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative i RSH) duke e krahasuar me kohën e shqyrtimit të ndjekur për dosjet e tjera, rezulton se kjo dojsje ka qënë me përparsi shqyrtimi i kërkesës.

### **12. Dosja e subjektit të shpronësuar Sh.N..**

Në emër të subjektit të shpronësuar Sh.N. është marrë vendimi me nr.90, datë 22.05.2020 për kompensimin financiar në vlerën 1,102,600 (një milion e njëqint dy mijë e gjashtëqint) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 21,726.1m<sup>2</sup> në fshatin Allambrez, Qarku Berat, me nr.pasurie 1043/1, zona kodastrale 11016.

Aplikimi për kompensim financiar është bërë me nr 1130 prot, datë 10.10.2018, në emër të subjektit të shpronësuar Sh.N..

Në dokumentat e paraqitura pranë ATP janë depozituar çelja e llogarisë në banka K. B. datë 05.12.2018 si dhe prokura me nr 17260 datë 18 11.2019 në datën 03.01.2020

Në shkresën e dërguar z. P.N. me nr .1130/3 datë 23.10.2019 në lëndën “Njoftim për plotësim dokumentacioni“ në të cilën kërkohet Prokurë e posaçme për të nënshkruar trashgimtarët ligjorë, për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre me prokurën e posaçme ”*shkresa e nisur me vonësë mbas 1 viti*“.

### **13. Dosja e subjektit të shpronësuar Sh.B..**

Në emër të subjektit të shpronësuar Sh.B. është marrë vendimi me nr.92, datë 22.05.2020, për kompensimin financiar në vlerën 1,020,000 (Një milion e njëzet mijë) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 24.000 m<sup>2</sup> në fshatin Gurabardh, Rrethi Korçë, me nr. Pasurie 33, pa numër të zonës kadastrale.

Aplikim është bërë në ATP me nr. Prot., 1284 datë 06.12. 2018, mbas 3 vitesh është marrë vendimi datë 22.05.2020, për kompensim financiar dhe kompensim fizik pra kemi zgjatje të procedurave prej 2 vitesh, ndërko i gjithë dokumentacioni ka qënë në përputhje me kërkesat e ligjit.

Në marrjen e informacionëve nga ATP-ja konstatohet se është punuar me dy sandarte në disa u dërgohen shkresa institucionëve përkatëse për marrjen e informacioneve si p.sh.:

Shkresa me nr 1284/9 prot datë 22.05.2020 ASHK, shkresa me nr.1284/1 prot datë 31.07.2019, shkresa me nr.1284/3 prot. datë 02.10.2019, Përgjigje e shkresës me nr.6696/1 prot datë 12.11.2019.

Në shkresën me nr.5680/1 prot. datë 30.01.2020, Bashkia Maliq i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjensisë së Trajtimit të Pronave ku rezulton se ”Tokat me pasurinë nr.64/9 dhe 64/19 janë ndarë sipas ligjit 7501 datë 19.07.1991, theksojmë se nuk ka të cilësuar përonat që kjo tokë është dhënë përonave përkatës dhe identifikimin e tyre, (mugon identifikimi i tyre).

Gjithashtu theksojmë se mbas përgjigjeve të dhëna nga institucioni i ATP-së drejtuar znj. L. A. si përfaqësuese e pronës të Sh.B. në vendimin me nr.92, datë 22.05.2020 me nr.protokolli 1284/8 është kompensuar me sipërfaqe 24 000 m<sup>2</sup> në Fshatin Gurabardhë, të rrethit Korçë pa pasur as një dokument argumentues ligjor për pasurinë me nr.33 Gurabardhë, Qaku Korçë, nga institucionet përkatëse nuk ka asnjë konfirmim mbi statusin juridik të pasurisë me nr. 33. Gurabardhë.

Në plan vendosjen e pronës kostatojmë se nuk janë hedhur kordinatat përkatëse të kësaj pronë të punuar nga Ing. G.Gj..

Në dokumentacionin e bashkangjitur vendimit me nr. 92 ,datë 22.05.2020 të zj. L.A., në cilësinë e trashëgimtarit të vetëm banues në Zharës Patos, në Deklaratën Notëriale me nr.2877 Rep dhe Nr.1881/2Kol., deklaroi se “subjektet e shpronësuar nuk kanë përfituar toke

bujqësore“ mungon një dokument argumentus ligjor nëse ka përfituar tokë bujqësore, në kundërshtim me nenin 21 (Pika 2 ) dhe nënin 36 (Pika 1) e ligjit 133/2015 me ndryshime si dhe VKM nr.222 datë 23.03.2016 citon “Për trajtimin e kërkesave për njohje të të drejtës të kompsesimit të pronës” të ndryshuar kreu i III (pika 12).

#### **14. Dosja e subjektit të shpronësuar N.I., R, M.G.**

Në Vendimin me nr.129, datë 23.09.2020, për kompensimin financiar në vlerën 4,114,073.4 (Katër milion e njëqint e katërmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e tre pikë katër) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 74,127.4 m<sup>2</sup> në fshatin Kryezjar, Qendra Administrative Shiregjan, Rrethi Elbasan, me nr. Pasurie 8973,89/43, Zona Kadastrale 2296, fshati Kryezjarr, Qendra Administrative Shirgjan, Rrethi Elbasan për sipërfaqën 12,979.6 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 140/14, Z.K. 2296.

Për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i tyre konstatohet se është bërë në mënyrë selektiv, mbasi kërkesa është bërë në ATP në vitin 2017 me nr. prot 987 datë 09.08.2017 dhe shqyrtuar nga ATP-ja në datë 23.09.2020, pra kemi zgjatje të procedurave deri në 4 vjet pa ndonjë arsye objektive.

#### **15. Dosja e subjektit të shpronësuar R/D.**

Në Vendimin me nr.127, datë 23.09.2020, për kompensimin financiar në vlerën 217,685.6 (dyqintë shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqintë e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 5,004.3 m<sup>2</sup> në fshatin Procan, Njësia Administrative Kabash Gramsh, Qarku Elbasan.

Për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i tyre konstatohet është bërë selektiv, mbasi kërkesa është bërë në ATP në vitin 2017 me nr. Prot 1030 datë 24.08.2017, janë paraqitur të gjitha kërkesat si dhe nr. i llogarisë prokura e posaçme etj dhe është shqyrtuar në datë 23.09.2020, pra kemi zgjatje të procedurave deri në 4 vjet.

#### **16. Dosja e subjektit të shpronësuar S.K..**

Në Vendimin me nr.125, datë 23.09.2020, për kompensimin financiar në vlerën 1,391,391.6 (Një milion e treqind e nënëdhjetë e një mijë e treqint e nëntëdhjetë e një pikë gjashtë) lekë, si dhe kompensimin fizik nga fondi ATP-së me sipërfaqe 25,070 m<sup>2</sup> në fshatin K., Komuna Bradashesh, Qarku Elbasan me nr.pasurie 5/12 sipërfaqe 12,095 m<sup>2</sup>, nr.pasurie 5/13 me sipërfaqe 11,748 m<sup>2</sup> nr.pasurie 5/7 sipërfaqe 1227 m<sup>2</sup> zona kadastrale 2256.

Për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i tyre konstatohet se është bërë selektiv, mbasi kërkesa është bërë në ATP në vitin 2018 me nr. Prot 720 datë 30.04.2018, janë paraqitur të gjitha kërkesat si dhe nr. i llogarisë prokura e posaçme etj dhe është shqyrtuar në datë 23.09.2020, që do të thotë se zgjatje e procedurave deri në 4 vjet.

Sipas aktit të trashëgimisë të trashëgimtarit N.K. dhe lënjen e pasurisë trashëgimtarëve të tjerë ligjore K.K., I.K. S.K., megjithëse në dosje ndodhet Deklarata Notëriale e përfaqësuar nga S.K datë 10.04.2018 ku shprehimisht thuhet “subjektët e shpronësuar nuk kanë përfituar tokë bujqësore“, por nuk shoqërohet me dokument argumentus ligjor nëse ka përfituar tokë bujqësore nga ASHK-ja e Korçës dhe Tiranës si dhe nga institucionet e tjera, në kundërshtim me nenin 21 (Pika 2 ) dhe nënin 36 (Pika 1) e ligjit 133/2015 me ndryshime si dhe VKM nr.222 datë 23.03.2016 citon “Për trajtimin e kërkesave për njohje të të drejtës të kompsesimit të pronës” të ndryshuar kreu i III (pika 12).

**Konkluzion:** *Për të gjitha rastet e konstatuara, ATP-ja nuk ka respektuar afatet e shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve dhe ndjekjen e procedurave ligjore, në zbatim të pikes 2 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative i R.SH. ku citohet “Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçem, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”.*

#### **17. Dosja e subjektit të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar F, F dhe V. K.**

Vendimi i ATP nr. 142, datë 04.11.2020 (korrigjuar gabimi material me Vendim ATP nr.17, date 17.09.2021), ATP Tiranë, sipas aplikimit për kompensim financiar/fizik nr. 672, datë 16.04.2018 të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar F, F.dhe V.K (trashëgimtarët),

përfaqësuesi me prokurë B.K, Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, ku kërkohet kompensim financiar dhe fizik, sipas vendimit të KKKP Tiranë nr. 694, datë 05.02.1995, Qarku Tiranë, Bashkia Tiranë.

### **Përmbajtja e dosjes**

*Po paraqesim kronologjikisht veprimet e kryera sipas dokumentacionit në dosje:*

-Me nr. 672, datë 16.04.2018, është protokolluar kërkesa e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar F, F dhe V.K. (trashëgimtarët), përfaqësuesi me prokurë B.K., drejtuar Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik ku ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, dhe kërkohet kompensim financiar dhe fizik, sipas vendimit të KKKP Tiranë nr. 694, datë 05.02.1995.

-Më datë 26.03.2019, z. Bujar Kapexhiu ka paraqitur “Kërkesë/Ankesë”, e protokolluar në ATP me nr. 2950, datë 26.03.2019, ku kërkon kalimin e dosjes me nr. 672, datë 16.04.2018 nga kompensim financiar fizik në Sektorin e Kërkesave të Veçanta, sipas deklaratave noteriale për 20 % të vlerës financiare dhe kanë hequr dorë përfundimisht nga pjesa tjetër takuese.

Sa sipër, sipas deklaratës noteriale nr. 438 rep, nr.180 kol/2, datë 25.03.2019, trashëgimtarët e subjektit F., F. dhe V.K., kanë deklaruar se:

*“Deklarojmë se jemi plotësisht dakord që në bazë të Vendimit nr. 694, datë 05.02.1995 të KKP, Tiranë, të cilin e kemi depozituar në ATP, për efekt të trajtimit financiar me kompensim të veçantë, të vlerësuar në masën 20 % të vlerës së pronës, sipas ligjit nr. 133/2015, jemi dakord që të kompensohemi në masën 20% të vlerës së pronës sipas ligjit 133/2015, dhe të heqim përfundimisht dorë nga pjesa tjetër”.*

-Sipas “MEMO” nr. 672/1, datë 03.04.2019, hartuar nga grupi i punës: znj. Ergyn Katunsi inspektore juriste; z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe nga z. S.D. Drejtor i Kompensimit, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., është rekomanduar kalimi i dosjes nr.672, datë 16.04.2018 në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K., në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta.

-Me nr. 672/2, datë 15.09.2020, ndodhet formulari “Plotësim Dokumentacioni”, sipas së cilës z. S.Sh., noter, ka paraqitur dokumentacione dëshmi trashëgime dhe kthim përgjigje.

**-Dokumentet Nr. 672/3, , 672/6-mungojnë**, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

-Me shkresë nr. 672/4, datë 27.10.2020, është protokolluar kërkesa e z. G.S., për kalimin e dosjes nga Sektori i Kompensimit të Kërkesave të Veçanta në Sektorin e Kompensimit Fizik dhe Financiar, sipas kontratës për “Kalimin e të drejtave reale” me nr. 1421 rep., nr. 650 kol., datë 26.10.2020, si subjekt i vetëm përfitues për Vendimin e ish-KKKP Tiranë me nr. 694. Datë 05.02.1995 dhënë, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K.

-Me nr. 672/5, datë 27.10.2020, është protokolluar “MEMO” drejtuar Znj. J.B. “Mbi kalimin e dosjes nr. 672 prot., datë 16.04.2018, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V. K.”, në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik.

-Me shkresë nr. 672, viti 2020, drejtuar DV ASHK Gramsh, Kërkesë për konfirmim, kërkohet konfirmim për pronat në Fshatin M.

-Me nr. 672/7, datë 04.11.2020, është protokolluar Relacioni drejtuar Znj. J.B. “Mbi shqyrtimin e kërkesës nr. 672 prot., datë 16.04.2018, me objekt kompensimin e pronës së njohur me vendimin nr. 694, datë 05.02.1994, të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar F, F dhe V. K”,

-Me nr. 672/8, datë 04.11.2020, është protokolluar vendimi i ATP Tiranë, nr. 142, datë 04.11.2020, Për Kompensimin e Pronës.

-Me shkresë nr. 672/9, datë 04.11.2020, drejtuar DV ASHK Librazhd, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi 142, datë 04.11.2020 i ATP Tiranë, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K..

-Me shkresë nr. 672/10, datë 04.11.2020, drejtuar DV ASHK Gramsh, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi 142, datë 04.11.2020 i ATP Tiranë, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K.

-Me shkresë nr. 672/11, datë 04.11.2020, drejtuar DV ASHK Elbasan, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi 142, datë 04.11.2020 i ATP Tiranë, për kompensimin me tokë bujqësore.

-Me shkresë nr. 672/12, datë 04.11.2020, drejtuar DV ASHK Tirana-Jug, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi 142, datë 04.11.2020 i ATP Tiranë, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F. F. dhe V.K.

*-Me shkresë nr. 672/13, datë 04.11.2020, drejtuar z.G. S., Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi 142, datë 04.11.2020 i ATP Tiranë, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K..*

-Me nr. 672/14, datë 17.09.2021, është protokolluar “MEMO” drejtuar Znj. J.B. “Mbi korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 142, datë 04.11.2020, në emër të subjektit të shpronësuar F. F. dhe V.K.

-Me nr. 672/15, datë 04.11.2020, është protokolluar vendimi nr. 17, datë 17.09.2021 i ATP Tiranë, “Për korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 142, datë 04.11.2020”.

-Me shkresë nr. 672/16, datë 17.09.2021, drejtuar DV ASHK Elbasan, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi nr. 17, datë 17.09.2021 i ATP Tiranë, “Për korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 142, datë 04.11.2020, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F. F. dhe V.K.

-Me shkresë nr. 672/17, datë 17.09.2021, drejtuar DV ASHK Librazhd, Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi nr. 17, datë 17.09.2021 i ATP Tiranë, “Për korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 142, datë 04.11.2020, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V. K..

-Me shkresë nr. 672/18, datë 17.09.2021, drejtuar z. G.S. , Njoftim Vendimi, njoftohet vendimi nr. 17, datë 17.09.2021 i ATP Tiranë, “Për korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 142, datë 04.11.2020, për kompensimin me tokë bujqësore, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K..

### **Analiza e fakteve**

-Sipas “MEMO” nr. 672/1, datë 03.04.2019, hartuar nga grupi i punës: znj. E.K. inspektore juriste; z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe nga z. S.D. Drejtor i Kompensimit, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., është rekomanduar kalimi i dosjes nr. 672, datë 16.04.2018 në emër të subjektit të shpronësuar F. F. dhe V.K., në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta.

*Pra , sa më sipër është zgjatur pa arsye procedura e kompensimit të subjektit të shpronësuar prej datës 16.04.2018 deri më datë 03.04.2019, pra për 1 vit, kur është pranuar kalimi i dosjes nr.672, datë 16.04.2018 në emër të subjektit të shpronësuar F, F dhe V.K, në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta.*

Sipas relacioneve dhe MEMO-ve drejtuar ish-Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B., nr. 672/5, datë 27.10.2020, nr. 672/7 prot., datë 04.11.2020 “Mbi shqyrtimin e kërkesës nr. 672 prot., datë 16.04.2018, me objekt kompensimin e pronës së njohur me vendimin nr.694, datë 05.02.1994, të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar F., F. dhe V.K.”, të hartuara nga grupet e punës: znj. V.N., z. G.X, inspektor inxhinier; pranuar nga z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe mbikqyrur nga z. S.D.Drejtor i Kompensimit të Pronës, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., rezulton se sipas vendimit, z. G.S. do të trajtohet për kompensim me vlerën e përgjithshme prej 34,288,128 lekë. *Sa më sipër, është vonuar trajtimi i kërkesës nga Sektori i Kërkesave të veçanta prej datës 03.04.2019 deri më datë 26.10.2020, kur është kryer kalimi i të drejtave reale, për një periudhë prej 1 viti e 6 muaj.*

Grupi i punës ka nxjerrë konkluzion dhe propozon ekzekutimin e vlerësimit financiar dhe kalimin e shumës prej 6,857,625.6 lekë në llogarinë bankare, në emër të G.S. dhe kompensimin fizik nga fondi i ATP me sipërfaqen totale 150,933.75 m<sup>2</sup>.

Në total është ekzekutuar 100% kompensimi për subjektin F., F. dhe V.K., të cilët ja kanë shitur të drejtat reale z. G.S., bazuar në kontratën për “Kalimin e të drejtave reale” nr.1421, rep.nr.650 kol., datë 26.10.2020, sipas së cilës subjekti përfitues i kompensimit është z. G.Sh.

Por, konstatohet se veprimi i lidhjes së kontratës për kalimin e të drejtave reale, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, ku në asnjë rast nuk cilësohet kalimi i të drejtave reale për subjektet e shpronësuara.

Sa sipër në pikën 9, të nenit 5, cilësohet se:

“Subjekt i shpronësuar” janë personat juridikë ose fizikë apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti ”Në nenin 10, pika 2, cilësohet:

“Fondi i Kompensimit të pronave përdoret për kompensimin financiar të subjekteve të shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta e kompensimit, me vendim përfundimtar”

Dhe sidomos në nenin 10, pika 7, ku cilësohet:

“Subjektet e shpronësuara, të cilat disponojnë një vendim përfundimtar për kompensim, përfitojnë kompensim nga Fondi i Kompensimit në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj”.

Në asnjë rast në ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, nuk përcaktohet se e drejta për kompensim financiar/fizik mund të transferohet.

**Sa sipër nuk mund të kryhen transferime të drejtash reale, përderisa nuk janë të përcaktuara në ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015, pasi vetë citimi në pikën 7, të nenit 10, përbën në thelb ndalim të tjetërsimit të këtyre të drejtave, gjë që buron edhe nga vetë natyra specifike e së drejtës së kompensimit.**

Z. G.S., një ditë pas nënshkrimit të kontratës së kalimit të të drejtave reale, ka depozituar kërkesën në ATP me nr. 672/4, datë 27.10.2020 dhe po atë ditë me “MEMO” nr.672/5, datë 27.10.2020 grupi i punës i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B., nëpërmjet z. S.D. Drejtor Drejtorie, z.A.M. Përgjegjës i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të veçanta, përgatitur nga znj.N.R. Inspektor/Juriste, e pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas së cilës është rekomanduar/pranuar kalimi i dosjes nr.672 prot., datë 16.04.2018, nga Sektori i trajtimit të Kërkesave të Veçanta në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, mbi bazën e kërkesës nr. 672/4 prot., datë 27.10.2020.

Sa më sipër është nxjerrë Vendimi i ATP nr. 142, datë 04.11.2020, sipas të cilit është vendosur kompensimi financiar dhe fizik i z. G.S. në vlerën 34,288,128 lekë.

Vlera prej 6,857,625.6 është shpërndarë sipas urdhrit të nr. 171, datë 04.11.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B., dhe i është xhiruar përfituesit me më datë 04.11.2020.

Veprimi për kalimin e dosjes nr.672 prot., datë 16.04.2018, nga Sektori i trajtimit të Kërkesave të Veçanta në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe kryerja e kompensimit të plotë prej 34,288,128 lekë, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar neni 17, pika 2, germa a, ku përcaktohet se:

“Subjektet, që shprehin vullnetin për t’u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, mund të përfitojnë nga ky fond, si më poshtë:-kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 1 viti, atëherë ai përfiton 20 për qind të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere”.

Sa sipër konstatohet një vleftë në lekë prej **27,430,502.40 lekë** (34,288,128-6,857,625.6), i cili shpenzim do të kursehej, sepse nëse procedura do të vazhdonte sipas kërkesës fillestare së subjektit **F., F. dhe V.K.** duke mos qenë e nevojshme që ky i fundit të vendoste kalimin e të drejtave reale si dhe vetë përfituesi i të drejtave reale ka përfituar padrejtësisht, pra duke përfituar 80 % të vlerës së kompensimit fizik.

Sa sipër është pranuar nga ATP Tiranë, e cila ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 5, pikën 9, ku në asnjë rast nuk cilësohet kalimi i të drejtave

reale për subjektet e shpronësuar, duke pranuar kontratën nr.1421, rep.nr.650 kol., datë 26.10.2020.

**Në dosje nuk ndodhet praktika për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.**

Përveç sa u trajtua më sipër, u konstatua se nuk ka patur një korrespondencë me institucionet e lëshimit të titujve të pronësisë, etj, si dhe vërtetime negative për disponimin e aksioneve, obligacioneve, kompensimeve, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 6, pika 6, ku përcaktohet se:

*“Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfutur nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfutur më parë, zbritet nga shuma e përllogaritur për kompensim”.*

Gjithashtu u konstatua se ATP nuk ka bashkërenduar veprimtarinë e saj me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

Sa sipër bie në kundërshtim edhe me nenin 36, ku cilësohet se:

*“ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë pa tarifa dhe taksa informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia, si dhe të raportojë arsyet e mos përmbushjes së një mase apo rekomandimi të kërkuar”.*

**Titulli i Gjetjes:** Transferimi i dosjes nga Sektori i Kërkesave të Veçanta në Sektorin e Kompensimit Financiar 20% me 80%.

**Situata:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 1 rast, sipas vendimit nr. 142, datë 04.11.2020, ka kryer kompensimin e subjektit të shpronësuar F. F. dhe V.K. (trashëgimtarët), sipas vendimit të KKKP Tiranë nr. 694, datë 05.02.1995, nëpërmjet z. G.Sh., sipas kontratës për “Kalimin e të drejtave reale” me nr. 1421 rep., nr. 650 kol., datë 26.10.2020, në një kohë që dosja e subjektit ka kaluar 3 herë nga Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik në Sektorin e Kërkesave të Veçanta, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit një vlerë prej **27,430,502.40 lekë**, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.

**Kritëri:** VKM nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016, pika 22, germa “b”.

**Shkaku:** Mos shqyrtimi i dosjes nga Sektori i Kërkesave të Veçanta.

**Impakti:** Mos kursimi nga buxheti i shtetit një vlerë prej **27,430,502.40 lekë**, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.

**Rëndësia:** I lartë.

## **18. Dosja e subjektin të shpronësuar A.G..**

Vendimi i ATP nr. 144, datë 04.11.2020, ATP Tiranë, sipas aplikimit për kompensim financiar/fizik nr. 1004, datë 07.08.2018 të subjektit të shpronësuar A.G. (trashëgimtarët), Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, ku



kërkohej kompensim financiar dhe fizik, sipas vendimit të KKKP Tiranë nr. 545/2, datë 09.12.1994, Bashkia Elbasan.

Relacioni drejtuar ish-Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B. nr. 1004/2 prot., datë 04.11.2020 “Mbi shqyrtimin e kërkesës nr.1004 prot., datë 07.08.2018, me objekt kompensimin e pronës së njohur me vendimin nr.545/2, datë 09.12.1994, të ish-KKKP Bashkia Elbasan, në emër të subjektit të shpronësuar A.G”, të hartuar nga grupi i punës: znj. A.H., inspektore juriste; z. E.S. inspektor gjeodet; pranuar nga z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe mbikëqyrur nga z. S.D. Drejtor i Kompensimit të Pronës, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., është hartuar në kushtet kur:

***Në dosje nuk ndodhet praktika për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.***

U konstatua se nuk ka patur një korrespondencë me institucionet e lëshimit të titujve të pronësisë, etj, si dhe vërtetime negative për disponimin e aksioneve, obligacioneve, kompensimeve, etj., mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 6, pika 6, ku përcaktohet se:

*“Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfutur nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfutur më parë, zbritet nga shuma e përlogaritur për kompensim”.*

Gjithashtu u konstatua se ATP nuk ka bashkërenduar veprimtarinë e saj me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

Sa sipër bie në kundërshtim edhe me nenin 36, ku cilësohet se:

*“ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë pa tarifa dhe taksa informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbushjes së një mase apo reko-mandimi të kërkuar”.*

Meqenëse, sipas programit të auditimit, për probleme të veçanta auditimi do të shtrihet edhe në periudhat e mëparshme, konstatohet se vendimi nr. 545/2, datë 09.12.1994 i ish-KKKP Bashkia Elbasan nuk ka vulën e Komisionit si dhe plan-vendosja bashkëlidhur është miratuar nga Bashkia Elbasan po nuk është konfirmuar me firmë e vulë nga ana e ish-KKKP Elbasan, gjë për të cilën i duhej rikthyer aplikuesit për plotësim dhe konfirmim të hartës.

### **Pretendimi i subjektit**

*Në lidhje me problematikën se Vendimi nr.542/2 datë 09.12.1994 ish KKKP Bashkia Elbasan, nuk ka vulën e Komisionit si dhe plan-vendosja bashkëlidhur është miratuar nga Bashkia Elbasan por nuk është konfirmuar me firmë e vulë nga ana e ish KKKP Elbasan, gjë për të cilën i duhej rikthyer aplikuesit për plotësim dhe konfirmim të hartës, si dhe z. E.S.i ne nr. 74/1 prot, të ATP observohet se:*

*Në rastin konkret, ish-KKKP Elbasan që ka dhënë vendimin, ka qenë një institucion i ngritur pranë Bashkisë Elbasan, dhe vendimi, si i gjithë dokumentacioni shoqërues i administruar në dosjen bazë që i përket këtij vendimi ,mban të njëjtën vulë, atë të Bashkisë. Gjithashtu ky*

vendim përmban të gjithë elementët e të tjerë identifikues si datën dhe nr. e protokollit dhe firmën e Kryetarit Të Komisionit të Kthimit të Pronave pranë Bashkisë Elbasan. Si i tillë ( pra si një vendim i vlefshëm), ai i është vënë në dispozicion grupit vlerësues nga Arkiva e ATP-së, me qëllim vlerësimin financiar. Gjithashtu sqarohet ky vendim komisioni ka prodhuar pasoja juridike pasi është i regjistruar në Zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme për pjesën e truallit të kthyer me këtë vendim. Po ashtu dhe nga verifikimi i gjendjes juridike të pronës së trajtuar me këtë vendim, administruar në dosje rezulton të ketë përputhshmëri dhe provueshmëri.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Theksojmë se në një vendim të vitit 1994, vulosja është elementi bazë për qënien një akt-administrativ i mirëfilltë:

**Observacioni nuk qëndron**

#### **19. Dosja e subjektin të shpronësuar A.M.**

Vendimi i ATP nr. 178, datë 28.12.2020, ATP Tiranë, sipas aplikimit për kompensim financiar/fizik nr. 60, datë 09.02.2018 të subjektit të shpronësuar **A.M.** (trashëgimtarët), Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, ku kërkohet kompensim financiar dhe fizik, sipas vendimit të ish-KKKP Vlorë nr. 80, datë 30.05.1995, Bashkia Vlorë.

Sipas relacionit drejtuar ish-Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B. nr. 60/8 prot., datë 28.12.2020 “Mbi shqyrtimin e kërkesës nr.60 prot., datë 09.02.2018, me objekt kompensimin e pronës së njohur me vendimin nr. 80, datë 30.05.1995, të ish-KKKP Bashkia Vlorë, në emër të subjektit të shpronësuar

A.M.”, të hartuar nga grupi i punës: znj. A.H., inspektore juriste; z.B.M.inspektor gjeodet; pranuar nga z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe mbikëqyrur nga z. S.D. Drejtor i Kompensimit të Pronës, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., rezulton se sipas vendimit, subjekti i shpronësuar do të trajtohet për kompensim financiar në vlerën 436,120 lekë (20% e vlerës së përgjithshme) dhe për kompensimin fizik në vlerën 1,744,480 lekë (80% e vlerës së përgjithshme).

**Në dosje nuk ndodhet praktika për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.**

U konstatua se nuk ka patur një korrespondencë me institucionet e lëshimit të titujve të pronësisë, etj, si dhe vërtetime negative për disponimin e aksioneve, obligacioneve, kompensimeve, etj., mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 6, pika 6, ku përcaktohet se:

*“Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfituar nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfituar më parë, zbritet nga shuma e përlogaritur për kompensim”.*

Gjithashtu u konstatua se ATP nuk ka bashkërenduar veprimtarinë e saj me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

Sa sipër bie në kundërshtim edhe me nenin 36, ku cilësohet se:

*“ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces. Çdo institucion shtetëror,*

*veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë pa tarifa dhe taksa informacionin apo dokumen-tacionin e kërkuar nga Agjencia, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbushjes së një mase apo reko-mandimi të kërkuar”.*

Meqenëse, sipas programit të auditimit, për probleme të veçanta auditimi do të shtrihet edhe në periudhat e mëparshme, konstatohet se vendimi nr. 80, datë 30.05.1995 i ish-KKKP Bashkia Vlorë nuk ka vulën e Komisionit si dhe plan-vendosja bashkëlidhur nuk është miratuar nga Seksioni i Urbanistikës dhe nuk është konfirmuar me firmë e vulë nga ana e ish-KKKP Vlorë, gjë për të cilën i duhej rikthyer aplikuesit për plotësim dhe konfirmim të hartës.

## **20. Dosja e subjektin të shpronësuar H.H.**

Vendimi i ATP nr. 143, datë 04.11.2020, ATP Tiranë, sipas aplikimit për kompensim financiar/fizik nr. 200, datë 15.03.2017 të subjektit të shpronësuar H.H (trashëgimtarët), Sektori i Kompensimit Financiar dhe Fizik ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, ku kërkohet kompensim financiar dhe fizik, sipas vendimit të ish-KKKP Kavajë nr. 28, datë 11.12.1994.

Sipas relacionit drejtuar ish-Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B. nr. 200/3 prot., datë 04.11.2020 “Mbi shqyrtimin e kërkesës nr.200 prot., datë 15.03.2017, me objekt kompensimin e pronës së njohur me vendimin nr. 28, datë 14.12.1994, të ish-KKKP Kavajë, në emër të subjektit të shpronësuar H.K.”, të hartuar nga grupi i punës: znj. E.P., inspektore juriste; z.G.Gj. inspektor gjeodet; z. Y.G., ish-Përgjegjës i Sektorit të Kompensimit Financiar dhe Fizik dhe z. S.D. Drejtor i Kompensimit të Pronës, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., rezulton se sipas vendimit, subjekti i shpronësuar do të trajtohet për kompensim financiar në vlerën 215,769.17 lekë (20% e vlerës së përgjithshme) dhe për kompensimin fizik në vlerën 863,077 lekë (80% e vlerës së përgjithshme).

*Në dosje nuk ndodhet praktika për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.*

U konstatua se nuk ka patur një korrespondencë me institucionet e lëshimit të titujve të pronësisë, etj, si dhe vërtetime negative për disponimin e aksioneve, obligacioneve, kompensimeve, etj., mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 6, pika 6, ku përcaktohet se:

*“Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfutur nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfutur më parë, zbritet nga shuma e përllogaritur për kompensim”.*

Gjithashtu u konstatua se ATP nuk ka bashkërenduar veprimtarinë e saj me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces

Sa sipër bie në kundërshtim edhe me nenin 36, ku cilësohet se:

*“ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë pa tarifa dhe taksa informacionin apo dokumen-tacionin e kërkuar nga Agjencia, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbushjes së një*

Meqenëse, sipas programit të auditimit, për probleme të veçanta auditimi do të shtrihet edhe në periudhat e mëparshme, konstatohet se vendimit nr. 28, datë 14.12.1994 dhe plan-vendosja bashkëlidhur të ish-KKKP Kavajë dhe nuk janë konfirmuar me firmë e vulë nga ana e ish-KKKP Kavajë, gjë për të cilën duhej rikthyer aplikuesit për plotësim dhe konfirmim të hartës.

**Titulli:** Dosje të Sektorit të Kompensimit Financiar.

**Situata:-** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 4 raste, sipas vendimeve nr. 142, datë 04.11.2020, nr. 144, datë 04.11.2020, nr. 178, datë 28.12.2020, nr. 143, datë 04.11.2020, në dosjet e arkivuara nuk ndodhen praktikat për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit të publikuara në buletinet sipas viteve.

- Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 3 raste, sipas vendimeve nr. 144, datë 04.11.2020, nr. 178, datë 28.12.2020, nr. 143, datë 04.11.2020, vendimet përkatëse të vlerësuara të ish-KKKP-ve, Elbasan, Vlorë dhe Kavajë, të cilat u gjetën në dosjet e arkivuara, nuk plotësonin kushtet për të qenë një akt administrativ, sepse nuk kanë vulën e institucionit, si dhe plan vendosjet ishin të pakonfirmuara nga KKKPronave.

**Kriteri:** Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” Ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse.

**Efekti:** Risqe në kompensimin e kryer dhe në administrim të dokumentacionit të vlerësimit.

**Shkaku:** Papërgjegjshmëri dhe Mosvlerësim nga stafi.

**Rëndësia:** I Mesëm

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me numër prot., dhe pa datë, e administruar në KLSH, me nr. 1172/9 prot, datë 12.05.2023, “Mbi Projekt-Raportin e auditimit” dërguar nga Znj. J.B. me detyrë, ish-Drejtori i Përgjithshëm, Z. S.D. me detyrë, ish-Drejtori i Kompensimit, Z. Y.G. me detyrë, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar, Z. M. B. me detyrë, ish-specialist/jurist, Z. E.S. me detyrë, ish-specialist dhe nga Z. B.M. me detyrë, specialist/gjeodet. ku janë shprehur objeksionët si më poshtë:*

### **1. Pretëndimi i subjektit:**

Pasi u njohëm me Projekt Raportin e Auditimit me nr. 1172/2, datë 12.04.2023, mbajtur në datë 17.03.2023, administruar pranë ATP me nr. 74/2 prot., datë 13.04.2023, ju parashitrojmë observacionet tona në lidhje me të gjitha gjetjet nga ana juaj që janë konstatuar si shkelje, si më poshtë vijon:

**NË LIDHJE ME GJETJEN 5,** që në 3 raste nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me "Kërkesë të Veçantë", por ka kaluar për trajtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit një vlerë prej 60, 388,502 lekë, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuara, (trajtuar në piken 6, nga faqja 63-96, Projekt Raportit të Auditimit), për të cilën rekomandohet që në vijimësi Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, duke i dhënë prioritet pranimi të kërkesave për trajtim në Sektorin e Kërkesave të Veçanta, sqarojmë:

ATP në zbatim të ligjit 133/2015 dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij ka si qëllim zbatimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes së pronave.

Kompensimi i pronarëve në masën 20%, 30%, apo 40% financiar, duke hequr dorë nga pjesa tjetër e pronës, është parashikuar si mënyrë kompensimi jo me qëllim kursimin e buxhetit të shtetit, pasi ligji 133/2015 nuk ka këtë qëllim, por është parashikuar si një mundësi financiare për subjektet, të cilët me qëllim që të kompensohen financiarisht apo të përfitojnë më shumë se 10 000 000 milion lekë, heqin dorë nga pjesa tjetër e pronës.<sup>i</sup>

Prandaj gjetja se shtetit nuk i janë kursyer një vlerë prej 60, 388,502 lekë nuk qëndron, pasi kjo vlerë është e pronarit, të cilit shteti i ka borxh. Pra ajo çfare kërkojmë të sqarojmë është se këto vlera janë vlera të miratuara dhe dedikuara për kompensimin e pronave dhe nuk është në kompetencë të ATP-së të orientojë ish pronarët, trashëgimtarët e tyre apo përfituesit ligjorë për mënyrën e kompensimit të cilin ata zgjedhin për tu kompensuar.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Rastet e trajtuara në Projekt-Raport, subjektet aplikues në fillim kanë zgjedhur formën e kompensimit me kërkesë të vecantë 40% të vlerës financiar duke hequr dorë nga pjesa e tjetër e pronës prej 60%, por nga Sektorin e Kërkesave të Veçanta është zvarritur shqyrtimi i kërkesës të subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me "Kërkesë të Veçantë", çfarë ka bërë që nga ana e ATP nuk i është dhënë prioritet shqyrtimi i kërkesave të subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me trajtim me "Kërkesë të Veçantë".

*Në këto kushte observacioni në lidhje me komentin e paraqitur nuk merret në konsideratë.*

### **2. Pretëndimi i subjektit:**

**NË LIDHJE ME GJETJEN 6:** që në 3 raste nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit kërkuar në cilësinë e blerësit të të drejtave reale që burojnë nga vendime të ish- KKKP, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223/2016, (trajtuar në Piken 6, nga faqe 63-96, të Projekt Raportit të Auditimit), për të cilën rekomandohet që në vijimësi Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen duke pranuar kërkesa për aplikim vetem nga subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, sqarojmë:

E drejta e pronësisë, si një prej të drejtave themelore të individit, është e garantuar në nenin 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas nenit 15 të saj të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Është e vertetë se në ligjin 1335/2015, nuk ka asnjë dispozitë ndaluese, që nuk mund ta pengojë kompensimin e një pale e cila me kontrate shitblerje ka fituar të drejtën e kompensimit apo parablerjes, por ligjvënësi ka parashikuar edhe pjesën që Agjencia e Trajtimit të Pronave "pranojë kërkesa për aplikim nga subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, depoziton në ATP, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm. në zbatim të ligjit 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

*Për sa sipër observacioni nuk qëndron.*

### **3. Pretëndimi i subjektit:**

**NË LIDHJE ME GJETJEN 13,** që nga ATP-ja nuk është vepruar për bashkimin e tre vendimeve përfundimtare për tu ekzekutuar, në emër të subjektit të shpronësuar S.M., në kundërshtim me pikën 2/1 të VKM nr.766, datë 20.12.2017 "Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016 "Për percaktimin e rregullave dhe te procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Projekt Raportit të Auditimit), sqarojmë se: Koncepti i bashkimit të vendimeve është shtuar në VKM 223/2016 me shtesat e bëra nepermjet vkm nr. 766, datë 20.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për percaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave", të ndryshuar".

Duke qene se shtesa në VKM 766/2017 mbi bashkimin e vendimeve në fakt paraqitej e veshtire teknikisht për tu realizuar, si edhe të gjendur para faktit se që nga miratimi i kesaj

shtese në vitin 2017 e në vazhdim, në asnje rast nuk pati një kërkesë për bashkim vendimesh, këto shtesa u shfuqizuan me ndryshime të mevonshme në VKM 223/2016.

Arsyeja pse ëshëe shtuar mundësia e bashkimit të vendimeve, nepermjet shtimit të pikave nga 2/1 deri ne 2/3, lidhet me mundësinë e subjektit apo edhe disa subjekteve se bashku, për të përfituar kompensim fizik në pronën e njohur. Duke qenë se nga ndryshimi i zerit kadastral të origjinës, subjekti mund të gjendej para situatës që do të përfitonte si kompensim fizik vetëm një pjesë se pronës së njohur, i është dhënë mundësia me këto shtesa që të përfitojë me shumë sipërfaqe në një pronë të njohur me interes për të, duke bashkuar aty vendime të tjera të tij, apo edhe vendime të subjekteve të tjera.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Komenti i paraqitur nga subjekti i audituar në lidhje me Gjetjen 13, merret në konsideratë, në këto kushte hiqet gjetja dhe rekomandimi i paraqitur në Projekt-Raport.

#### **4. Pretëndimi i subjektit:**

**NË LIDHJE ME GJETJEN 14**, që Fondi i tokës i miratuar me VKM për kompensimin fizik, nuk rezulton të jetë i regjistruar kartelat e pasurisë së paluajtshme në emër të ATP, mos regjistrimi i këtyre pasurive të miratuar si fond për ATP-në ka bërë që disa raste të krijohet mbivendosje me pasuri të regjistruar në të tretë, çfarë ka bërë që ATP-ja, është e detyruar që me një vendim tjetër të bej korrigjimin e vendimit në lidhje me pasuritë që kanë krijuar mbivendosje me pasuri të regjistruara në personë të tretë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Projekt Raportit të Auditimit) sqarojmë se:

Verifikimi i kartelave përkatëse është bërë në gjendjen aktuale dhe me shënimet që ato kanë në momentin e verifikimit nga grupi i punës pa qenë në dijeni se disa numra pasurie mund të jenë në pronësi të personave të tretë të cilët nuk i kanë regjistruar titujt e pronësisë me. Këta numra pasurie ATP- ja i ka përdorur për të kompensuar fizikisht pronarët duke qenë se janë pjesë e fondit të saj.

Në rastin konkret të cilin ju e keni marrë në trajtim ka rezultuar se disa numra pasurie pjesë e fondit të tokës të ATP-së të cilat janë përdorur për kompensimin fizik të ish pronarëve **kanë krijuar mbivendosje me persona të tretë të cilët nuk i kishin regjistruar titujt e pronësisë**, dhe kjo është e lehtësisht e verikueshme nga korrenspodencat që ka pasur ATP me ASHK Korçë dhe me Mitropolinë e Shenjtë Korçë. ATP në këto raste ka vijuar me korrigjimin e vendimit duke e kompensuar fizikisht ish pronarin në një vend tjetër, pjesë e fondit të tokës.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Nuk merret në konsideratë komenti i paraqitur nga subjekti i audituar, për faktin se për 6 pasuritë e tjera që nuk kanë krijuar mbivendosje, ATP nuk ka vazhduar procedurat e regjistrimit duke mos paraqitur një planrilevimi të detajuar për sipërfaqën që ju do të regjistroni.

#### **5. Pretëndimi i subjektit:**

**NË LIDHJE ME GJETJEN 19**, që në shqyrtimin e dosjeve për kompensim rezultojnë vonesa në kompensimin deri në 3 vjet nga viti 2017 në vitin 2020, me vonësa të pa justifikuar pa pasur dokument justifikues mbi shkaqet e vonësës si dhe selektim dhe zgjedhje e subjektit për tu marrë në shqyrtim, ku rekomandohet që ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në kohë sipas kërkesave të ligjit, sqarojmë :

Rastet e vonësave kanë të bëjnë me shkaqet e arsyeshme dhe objektivisht të pavarura nga ATP, dhe konkretisht:

Mosplotësimi i dokumentacionit nga ana e subjekteve;

Pezullimi i kërkesave me vullnetin e subjekteve si pasoje e ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore;

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Observacioni në lidhje me komentin e paraqitur nga subjekti i audituar nuk merret në konsideratë për faktin se mungon dokumenti që provon shtyrjen e vendimarrjes për subjektet kërkues që janë trajtuar në projekt raport.

***Pika 7/a. Ekzekutimi i vendimeve me kërkesë të veçantë për kompensim financiar në masën nga 20% deri në 40% të vlerësimit financiar të pronës së njohur si dhe përlllogaritja dhe lërimi i vlerës në këste.***

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezultoi:

- Janë administruar 55 kërkesa të reja;
- Janë trajtuar me vendim 80 aplikime, nga të cilat për 75 aplikime ATP ka vijuar me levrimin e kësteve, ndërsa për 5 aplikime është vendosur mbyllje e procedimit administrativ.
- Fondi i akorduar i cili do të lëvrohet përgjatë viteve për këto 75 vendime është në total vlera 805,983,436.71 lekë.
- ATP ka lëvruar vlerën 175,441,434.10 lekë;
- Gjithashtu, në fillim të vitit kalendarik është lëvruar kësti i radhës për 148 aplikime përgjatë viteve 2016-2019, të cilat kanë marrë kestin e dytë, të tretë dhe kestin e katërt, në vlerën 481'216'781.02 lekë.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton se, në fillim të vitit buxhetor 2023, ka përfunduar procedurat për levrimin e kështit të radhës për 147 (njëqind e dyzet e shtatë) vendime të subjekteve të shpronësuara, që kanë përfituar kompensim financiar, me kërkesë të veçantë, gjatë viteve 2019-2022, nga të cilët:

- për 75 (shtatëdhjetë e pesë) vendime, subjektet përfitojnë kestin e pestë,
- për 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) vendime, subjektet përfitojnë kestin e katërt,
- për 6 (gjashtë) vendime, subjektet përfitojnë kestin e tretë,

Vlera totale e fondit, të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që do të lëvrohet menjëherë në fillim të vitit buxhetor 2022, si kestit i radhës për 147 vendimet e subjekteve përfitues, është 437 287 601,77 lekë.

Gjatë kësaj periudhe vihet re një tendencë në rritje ku subjektet përmes kërkesave të administruara kanë kërkuar kalimin për trajtim të dosjeve nga kompensimi financiar dhe fizik në kompensim financiar me kërkesë të veçantë, kjo ka ardhur edhe si pasojë e ndryshimeve të akteve nënligjore.

*Në sektorin e kompensimit me kërkesë të veçantë u audituan me zgjedhje 20 dosje, disa nga këto dosje të audituar janë si vijon:*

#### **1. Dosja e subjektit të shpronësuar S.M..**

Në lidhje me vendimin nr.372, datë 29.06.2009 të ish-AKKP-së Tiranë, të subjektit të shpronësuar S.M., është shlyrtuar kërkesa nr. 1121/6 prot., datë 23.07.2020, bazuar në aplikimin e subjektit kërkues z. I.M., në cilësinë e trashigimtarit i vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M., ku është marrë vendimi nr. 113, datë 29.07.2020, "Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë" të pronës së njohur me vendim 372, datë 29.06.2009 të ish-AKKP-së Tiranë, në masën 20% të vlerësimit financiar të pronës së njohur, përlllogaritur në vlerën 5,993,926 lekë, bazuar në aplikimin nr. 1121 prot., datë 08.10.2018, të subjektit kërkues z. I.M., në cilësinë e trashigimtarit të vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M..

*Nga auditimi rezultoi se:*

Me datë 08.10.2018, subjekti kërkues z. I.M. ka plotësuar formularin e aplikimit me nr. 1121 prot., ku ka shprehur vullnetin për kompensim financiar me Kërkesë të Veçanta në lidhje me vendimin nr.372, datë 29.06.2009 të ish-AKKP-së, nga kërkuesi z. I.M., në cilësinë e trashigimtarit i vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar S.M. për kompensimin financiar të

pronës me kërkesë të veçantë, në masën 40% të vlerësimit financiar të pronës së njohur me vendim nr.372, datë 29.06.2009 të ish-AKKP-së Tiranë.

Kane kaluar 2 vite dhe kjo kërkesë për kompensimin financiar të pronës me kërkesë të veçantë, në masën 40% të vlerësimit financiar të pronës së njohur nuk është marrë në shqyrtim nga ATP-ja edhe pse kërkuesi legjitimohet në kërkesën e tij për kompesimin financiar të pronës në kuptim të nenit 5, pika 9 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar si dhe bazuar në aktët që shoqërojnë kërkesën e tij. Mbas 18 muajsh nga ATP-ja është kërkuar “Vertëtim Kadastral” drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës, ku nga Këshilli i Qarkut është kthyer përgjigje brenda javës.

Nga inspektori jurist Nergisa Rakipi i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm një Memo më nr.1121/3 datë 08.05.2020 ku i kërkon trajtimin i vendimit nr.318 dhe nr.320, datë 22.10.2007 të ish-ZRKKP Qarku Durrës, në Sektorin e Kompensimit Financiar e Fizik dhe trajtimin e vendimit nr.372, datë 29.06.2009 të AKKP-së, në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta, bazuar në kërkesën e parqitur pranë ATP-së me nr.1121/2 prot., datë 22.04.2020

Me kërkesën nr.1121/6 datë 23.07.2020 subjekti kërkuar z. I.M. ka kërkuar ndryshimin e kompensimit në sektorin e trajtimit të kërkesave të kompensimit të veçantë nga aplikim me 40% në aplikimin për të kompensuar në masën 20% të vlerësimit dhe heqjen dorë nga pjehesa tjetër e mbetur prej 80%.

Në lidhje me kërkesën nr.1121/6 datë 23.07.2020 të subjektit kërkuar z. I.M., grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e kërkesës i përbërë nga inspektori jurist N.R. dhe inspektori gjeodet G.Gj. i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me një Relacion nr.1121/7 datë 29.07.2020, ku propozojn ekzekutimin e aplikimit me nr. 1121 prot., datë 08.10.2018 për kompensim me kërkesë të veçantë në masën 20% të vlerësimit financiar të vendimit nr.372, datë 29.06.2009 të AKKP-së.

Bazuar në relacionin nr.1121/7 datë 29.07.2020, është marrë vendimi nr. 113, datë 29.07.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë” të pronës së njohur me vendim 372, datë 29.06.2009 të ish-AKKP-së Tiranë, në masën 20% të vlerësimit financiar të pronës së njohur, përlllogaritur në vlerën 5,993,926 lekë dhe levrimin e kësaj vlere.

#### **Konkluzion:**

*-Relacion nr.1121/7 datë 29.07.2020, rezulton që të mos jetë firmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta z. A.M..*

*-Kërkesa e subjektit kërkuar z. I.M. për kompensimin financiar të pronës me kërkesë të veçantë është shqyrtuar dhe miratuar mbas 2 vitesh nga Sektori i Trajtimit të Kërkesave të Kompensimit të Veçantë.*

## **2. Dosja e subjektit të shpronësuar H. V.**

Në lidhje me vendimin nr.299, datë 07.07.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Kavajë, të subjektit të shpronësuar **H.V.** është shqyrtuar kërkesa nr. 840 prot., datë 06.07.2017, bazuar në aplikimin e subjektit kërkuar z. A.B., në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë i trashigimtareve ligjor të subjektit të shpronësuar H.V, ku është marrë vendimi nr. 108, datë 30.06.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr.299, datë 07.07.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Kavajë, në emër të subjektit të shpronësuar H.V.

*Nga auditimi rezultoi se:*

Me datë 06.07.2017, subjekti kërkuar z. A.B. ka plotësuar formularin-tip i aplikimit për kompensim me nr. 840 prot., ku ka shprehur vullnetin për kompensim financiar në lidhje me vendimin nr. 299, datë 07.07.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Kavajë.

Me shkresën nr. 840/1 prot., datë 09.08.2019 ATP-ja njofton z. A.B. “Për plotësim dokumentacioni”, duke qenë se jemi në kushtet e ndryshimit të formës së kompesimit sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766, datë 20.12.2017, është e nevojshme që trashigimtarët e subjektit të shpronësuar të deklarojnë se janë dakort për



vazhdimin e procedurës sipas kushteve të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016”.

Bazuar në shkresën e sipërcituar të ATP-së, subjekti kërkues z. A.B. ka depozituar kërkesën me nr. 840/2 datë 29.08.2019, ku kërkon kompensim 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës, në zbatim të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016”.

Nga ana e ATP-së nuk është shqyrtuar kërkesa e z. A.B. të depozituar me nr.840/2 datë 29.08.2019, ku kërkon kompensim 20% të vlerës totale të kompensimit financiar dhe 80% e vlerës së mbetur në kompensim fizik me fondin e tokës.

Me shkresën nr. 840/3 prot., datë 10.10.2019 ATP-ja përsërit të njëjtën kërkesë duke njoftuar z. A. B. “Për plotësim dokumentacioni”, duke qenë se jemi në kushtet e ndryshimit të formës së kompesimit sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 223/2016 të ndryshuar me VKM nr. 766, datë 20.12.2017, është e nevojshme që trashigimtarët e subjektit të shpronësuar të deklarojnë se janë dakort për vazhdimin e procedurës sipas kushteve të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016”.

Pas njoftimit të dytë të AKP-së subjekti kërkues z. A.B. ka depozituar brenda ditës kërkesë me nr. 840/4 datë 12.11.2019 ku kërkon plotësim dokumentacioni dhe kërkesë nr. 840/5 datë 12.11.2019 për pezullimin e procedure.

Me kërkesën nr. 840 prot., datë 28.04.2020 të administruar në dosje, kërkuesi z. A.B. në cilësinë e përfaqësuesit të trashigimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar ka paraqitur kërkesën për tu trajtuar më kërkesë të veçantë në masën 40 %.

Bazuar në kërkesën e sipërcituar nëpërmjet inspektore juriste znj. A. H. i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me një Memo, me nr. 840/6 prot., datë 27.05.2020 ku propozon kalimin për shqyrtim të dosjes nr. 840 prot., datë 06.07.2017 në emër të subjektit të shpronësuar Haxhi Veliu në Sektorin e Kërkesave të Veçanta.

Për shqyrtimin e kërkesës në Sektorin e Kërkesave të Veçanta është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacionin nr. 840/7 prot., datë 30.06.2020, mbi shqyrtimin e kërkesës nr. 840 prot., datë 06.07.2017, me objekt Kompensim financiar më kërkesë të veçantë në masën 40 % të vlerësimit financiar të vendit nr. 299, datë 07.07.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Kavajë, në emër të subjektit të shpronësuar H.V., ku propozon ekzekutimin e aplikimit nr.840 prot., datë 06.07.2017.

Nisur nga propozimi për ekzekutim, është marrë edhe vendimi nr. 108, datë 30.06.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr. 299, datë 07.07.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Kavajë, në emër të subjektit të shpronësuar H. V., përllogaritur në vlerën 11,456,404 lekë, të ndarë në 5 këste, nga 8% për çdo vit, përkatësisht 2,291,280 lekë.

#### **Konkluzion:**

*Nga punonjësit e ATP-së janë përsëritur disa herë njoftimet ndaj subjektit kërkues z. A. B. “Për plotësim dokumentacioni”, pas 3 vitesh është shqyrtuar dhe miratuar kërkesa nr. 840 prot., datë 06.07.2017, bazuar në aplikimin e subjektit kërkues.*

### **3. Dosja e subjektit të shpronësuar S.P.**

Në lidhje me vendimin nr.1265, datë 23.03.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, të subjektit të shpronësuar S.P. është shqyrtuar kërkesa nr. 963 prot., datë 31.07.2017, bazuar në aplikimin e subjektit kërkues z. A. K., në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë i trashigimtareve ligjorë të subjektit të shpronësuar S.P. ku është marrë vendimi nr. 123, datë 21.09.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr.1 265, datë 23.03.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar S.P.

*Nga auditimi rezultoi se:*

Me datë 31.07.2017, subjekti kërkues z. A.K. ka plotësuar formularin-tip i aplikimit për kompensim me nr. 963 prot., ku ka shprehur vullnetin për kompensim financiar në lidhje me vendimin nr. 1265, datë 23.03.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë.

Në formularin-tip datë 31.07.2017 në faqen 2, me shkrim dore kërkuesi ka deklaruar se “Jam dakort të kompensohem për vlerën e publikuar në shumën prej 14,465, 304 lekë, si dhe për sipërfaqen prej 217 m<sup>2</sup> me të drejtë parablerje.

Me datë 15.06.2017 subjekti kërkues z. A.K. ka aplikuar pranë ish-ZVRPP Tiranë për informacion për pasuritë e kërkuar në planrilevimin e dorëzuar dhe nga kjo e fundit është kthyer përgjigje ku rezulton që 8 pasuritë të paraqitura në planrilevim janë të regjistruar në vol dhe faqe në Z.K. 8270 dhe janë në llojin e pasurisë “truall” dhe në emër “shtet”, që do të thotë se brenda pronës të njohur ka sipërfaqe të lira ku në mbështetje të Kreut III pika 16.2/a të VKM-së nr.766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.223 datë 23.03.2016” duhet që ATP të kishte vepruar me kompensim fizik në ish-pronën e subjektit të shpronësuar.

Në piken 16.2/ “Prioriteti i mënyrave të kompesimit përcaktohet sipas rendit të mëposhtëm:

- a. Kompensim fizik në ish-pronën e subjektit të shpronësuar.
- b. Kompensim fizik nga fondi i tokës.
- c. Kompensim financiar.

Aplikimi nr. 963 prot., 31.07.2017, subjekti kërkues z. A.K. rezulton që të mos jetë shqyrtuar edhe pse i gjithë dokumentacioni është në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766, datë 20.12.2017.

Pas 2 vitësh, me shkresën nr. 963/1 prot., datë 26.08.2019, ATP-ja njofton z. A.K. “Për plotësim dokumentacioni”, duke qenë se jemi në kushtet e ndryshimit të formës së kompensimit sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 223/2016 të ndryshuar me VKM nr. 766, datë 20.12.2017, është e nevojshme që trashigimtarët e subjektit të shpronësuar të deklarojnë se janë dakort për vazhdimin e procedurës sipas kushteve të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016”.

Pas një viti me kërkësen nr. 963/2 prot., datë 25.08.2020 të administruar në dosje, kërkuesi z. A.K. në cilësinë e përfaqësuesit të trashigimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar ka paraqitur kërkesën për tu trajtuar më kërkësë të veçantë në masën 40 %.

Bazuar në kërkesën e sipërcituar nëpërmjet inspektore juriste znj. E.S. i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me një Memo, me nr. 963/3 prot., datë 27.08.2020 ku propozon kalimin për shqyrtim të dosjes nr. 963 prot., datë 31.07.2017 në emër të subjektit të shpronësuar S.P. në Sektorin e Kërkesave të Veçanta.

Për shqyrtimin e kërkesës në Sektorin e Kërkesave të Veçanta është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacioni nr. 963/6 prot., datë 21.09.2020, me objekt Kompensim financiar më kërkësë të veçantë në masën 40 % të vlerësimit financiar të vendit nr. 1265, datë 23.03.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar S.P., i pregatitur nga grupi i punës, jurist J.K., gjeodet A.L., i mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta A.M., i pranuar nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B., ku propozua ekzekutimi i aplikimit 963 prot., datë 31.07.2017, për vlerën e publikuar në shumën prej 28,997,677 lekë dhe jo në shumën prej 14,465, 304 lekë, bazuar në deklaratën e datës 31.07.2017 ku shprehet se “Jam dakort të kompensohem për vlerën e publikuar në shumën prej 14,465, 304 lekë, si dhe për sipërfaqen prej 217 m<sup>2</sup> me të drejtë parablerje.

Nga verifikimi i shkresave që janë të administruara në dosje rezultoi se ATP-ja, në funksion të procesit të njohjes e të kompensimit të pronës, nuk ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike apo nga organet e pushtetit vendor që lidhet me procesin e privatizimit, në kundërshtim me nenin 36 të ligjit Nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

Ligjit Nr. 133/2015, datë 05.12.2015.

Neni 36

a) Subjektet, të cilat e kanë humbur të drejtën e parablerjes, për shkak se objekti është privatizuar nga të tretët sipas legjislacionit për privatizimin, duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që provon këtë fakt, dokumentacionin që provon se nuk janë në proces gjyqësor për këtë shkak, si dhe të deklarojnë se nuk kanë përfituar asnjë formë tjetër kompensimi për sipërfaqen e tokës për të cilën u është njohur e drejta e parablerjes. Për këto subjekte vendimet do të ekzekutohen përkundrejt kompensimit pasi vlera të publikohet në regjistrin e vendimeve të kompensimit;

b) Subjektet, të cilat nuk kanë hequr dorë

Nisur nga propozimi për ekzekutim, është marrë edhe vendimi nr. 123, datë 21.09.2020,, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr.1265, datë 23.03.1995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar S.P., përllogaritur në vlerën 11,599,030 lekë, të ndarë në 5 këste, nga 8% për çdo vit, përkatësisht 2,319,806 lekë.

#### **Konkluzion:**

*Në dosje mungon e administruar informacioni nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave, për objektet të cilat u është njohur e drejta e parablerjes, nëse janë privatizuar apo jo nga përsonei kërkues.*

#### **4. Dosja e subjektit të shpronësuar N. Z.**

Në lidhje me vendimin nr.284, datë 23.10.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, të subjektit të shpronësuar **N.Z.** është shlyrtuar kërkesa nr. 798 prot., datë 29.06.2017, bazuar në aplikimin e subjektit kërkues z. F.Z., në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë i trashigimtareve ligjor të subjektit të shpronësuar N.Z., ku është marrë vendimi nr. 103, datë 30.06.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr.284, datë 23.10.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar N.Z.

*Nga auditimi rezultoi se:*

Me datë 29.06.2017, subjekti kërkues z. F.Z. ka plotësuar formularin-tip i aplikimit për kompensim me nr. 798 prot., ku ka shprehur vullnetin për kompensim financiar dhe fizik në lidhje me vendimin nr. 284, datë 23.10.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë.

Pas 2 vitesh, ATK-ja me shkresën nr. 798/1 prot., datë 29.08.2019, njofton z. F.Z. “Për plotësim dokumentacioni”, duke qenë se jemi në kushtet e ndryshimit të formës së kompensimit sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 223/2016 të ndryshuar me VKM nr. 766, datë 20.12.2017, është e nevojshme që trashigimtarët e subjektit të shpronësuar të deklarojnë se janë dakort për vazhdimin e procedurës sipas kushteve të VKM nr. 766, datë 20.12.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 223 datë 23.03.2016”.

Subjekti kërkues z. F.Z. ka përsëritur disa herë kërkesën për trajtimin e pronës në lidhje me kompensimin, ku nga ana e ATP-së i është kërkuar herë pas herë të njëjtat dokumenta.

Më kërkesën nr. 798 prot., datë 23.10.2019 subjekti kërkues z. F.Z. në vijim të njoftimit të ATP-së nr.7 98/1 prot., datë 29.08.2019, ka kërkuar vazhdimin e procedurave për kompensim financiar më kërkesë të veçantë në masën 40 %.

Përsëri nga ana ATP-së kërkesa e subjektit nuk është shqyrtuar edhe pse nga kërkuesi ka plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore.

Në dosje janë administruar edhe ankesat e qytetarit (kërkuesit të subjektit të shpronësuar) për mos shlyrtimin e kërkesës, nga Sektorin e Kërkesave të Veçanta, ku konstaton me keqardhje se ka përfunduar procesi i shqyrtimit administrativ të disa aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçant, ku sipas listës që i bashkelidhet ankesës shumica e përfituesve me 40% kanë bërë aplikime në ATP pas aplikimit tim ( F.Z.).

Pas 8 muajve është shlytur kërkesa në Sektorin e Kërkesave të Veçanta ku për shlytimitin e kësaj kërkesë është ngritur një grup pune ku është paraqitur relacioni nr. 798/5 prot., datë 30.06.2020, me objekt Kompensim financiar me kërkesë të veçantë në masën 40 % të vlerësimit financiar të vendimit nr. 284, datë 23.10.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar N.Z., i pregatitur nga grupi i punës, jurist J.K., gjeodet G.Gj., i mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta A.M., i pranuar nga Drejtori i Kompensimit S.D.dhe i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm J.B., ku propozua ekzekutimi i aplikimit 798 prot., datë 29.06.2017, për vlerën e publikuar në shumën prej 14,934,087 lekë x 40% = 5,973,634 lekë e ndarë në 5 këste nga 8% për çdo vit.

Nisur nga propozimi për ekzekutim, është marrë edhe vendimi nr. 103, datë 30.06.2020, “Për kompensim financiar të pronës, me kërkesë të veçantë”, në masën 40% të pronës së njohur me vendim nr.284, datë 23.10.21995 të ish-KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar N.Z., përlllogaritur në vlerën 14,934,087 lekë x 40% = 5,973,634 lekë e ndarë në 5 këste nga 8% për çdo vit, përkatësisht 1,194,726 lekë.

**Konkuzion:**

*ATP-ja në ushtrimin e funksionit të kompetencave dhe detyrave që i atribuon ligji, ka zvarritur shlytimitin e kërkesave të veçanta të paraqitura nga subjektet kërkuar.*

**5. Vendimi i ATP nr. 04, datë 29.01.2021**

**ATP Tiranë**, sipas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë nr. 215, datë 20.05.2019 të subjektit të shpronësuar B.M. (trashëgimtarët), Sektori i Kompensimit Financiar me Kërkesë të Veçantë, ka hapur dosjen me të njëjtin numër dhe datë, ku kërkohet kompensim financiar, sipas vendimit nr. 162, datë 22.06.1995, ndryshuar me vendimin nr. 192, datë 30.09.1997, miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm znj. J.B., të ish-KKKP Bashkia Tiranë.

Relacionit drejtuar ish-Drejtorit të Përgjithshëm Znj. J.B. nr. 215/3 prot., datë 29.01.2021 “Mbi shlytimitin e aplikimit nr. 215 prot., datë 20.05.2019, për kompensimin me kërkesë të veçantë të pronës së njohur me vendimin nr. 162, datë 22.06.1995, ndryshuar me vendimin nr. 192, datë 30.09.1997, të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar B.M.”, të hartuar nga grupi i punës: znj. N.R., Inspektor jurist; z. G.Gj. Inspektor gjeodet; z. A.M, ish-Përgjegjës i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta dhe z. S.D. Drejtor i Kompensimit të Pronës.

Nuk ka dosjen të sistemuar, në dosje “mugon vendimi”, nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk ka shkresë të nisur as një institucion mbas aplikimit datë 18.01.2018, nuk janë pasqyruar të dhënat në regjistrin e ATP sipas pikes 4, nenit 30 të ligjit 133/2015, vonesa në dhenjen e relacionit, mos lenja gjurmë e arsyes se vonesës nga viti 2018 deri në 27.07.2021 “dërgimi i kërkesës ASHK-Elbasan në shkresën me nr 2333-A/4 Prot. Datë 08.04.2021, mugon formulari i kompensimit, në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010 ku citohet se “Grupi i punës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet.....”,

-Në Relacionin me Nr.233-A/3 datë 21.12.2020, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 5,161,761.60 ( pesë milionë njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë) lekë, sipas fondi i kompensohen 70% e vlerës në shumën 3,613,233.12 (tre milion e gjashtëqint e trembëdhjetë mijë e dyqint e tridhjetë e tre pike dymbëdhjetë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit F.Sh., datë 11.12.2020 si dhe vërtëtimin nga Fibank –Albania me nr.116440 datë 04.02.2020, me nr. Llogarie 21511000.

Në dosje mugon dokumenti nga ASHK e dërguar ATP për kompensim, formulari i aplikimit nga F.Sh., pa datë, nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit .

Në dosje nuk është bashkangjitur vendimi mbas relacionit nga grupi i punës dhe formulari i kompensimit.

Nga dokumentacionin e paraqitur konstatojm se është punuar me dy sandarte, kërkesa e bërë në datën 11.12.2020 dhe mbaron në datën 28.12.2020, që do të thotë se ka mbaruar brenda 17 ditëve.

**-Në Relacionin me Nr.3642A/5 Prot., datë 21.04.2022,** për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 14,289,304 (katërmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqint e katër) lekë,sipas fondi i kompensohen 70% e vlerës në shumën 10,002,512.80 (dhjetë milion e dy mijë e pesëqind e dymbëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit Aida Lekbello, datë 01.12.2021 në e-Albania.

Në dosje mugon dokumentacioni si Dëshmia e Trashegimisë dhe Prokura e posaçme dhe vërtëtimi Bankar.



Nuk pasqyrohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistënces Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës mungesat, lëvizjet e dosjeve, si dhe plotësimi i tyre me fotokopje në qoftë se origjinali pretendohet se është në dosje tjetër, ka vonesa në dhënjen e relacionit, në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010.

**-Në Relacionin me Nr.1256-A/15 Prot., datë 17.02.2021**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 6,380,723.60 (gjashtë milion e treqindë e tetëdhjetë mijë e shtatëqindë e njëzetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekë, sipas fondi i kompensohen 70% e vlerës në shumen 4,466,506.52 (katër milion e katërqintë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqintë e gjashtë pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit I.D., datë 28.10.2016, megjithëse VKM ka dalë në vitin 2016 në fletoren zyrtare nr. 141.

Në shkresën me Nr.1256-A/1 datë 23.11.2016 ATP i është drejtuar ZVRPP-Elbasan për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.1225/1 në ZK.8526, është kthyer përgjigjen nga ZVRPP-Elbasan në shkresën 1685/1 Prot. në datën 21.06.2018 me kartelat përkatse.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistënces Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonesat nga viti 2016 dhe përfunduar në vitin 2021, vendimi përfundimtar nuk ndodhet në dosje. Vonesat në dhënjen e relacionit janë në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010.

**-Në Relacionin me Nr.1256-A/15 Prot., datë 17.02.2021**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 6,380,723.60 (gjashtë milion e treqindë e tetëdhjetë mijë e shtatëqindë e njëzetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekë, sipas fondi i kompensohen 70% e vlerës në shumen 4,466,506.52 (katër milion e katërqintë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqintë e gjashtë pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit I.D., datë 28.10.2016, megjithëse VKM ka dalë në vitin 2016 në fletoren zyrtare nr. 141.

Në shkresën me Nr.1256-A/1 datë 23.11.2016 ATP i është drejtuar ZVRPP-Elbasan për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.1225/1 në Z.K. 8526, është kthyer përgjigjen nga ZVRPP-Elbasan në shkresën 1685/1 Prot. në datën 21.06.2018 me kartelat përkatëse.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistënces Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonesat nga viti 2016 dhe përfunduar në vitin 2021, vendimi përfundimtar nuk ndodhet në dosje.

Vonesat në dhënjen e relacionit janë në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010.

**-Në Relacionin me Nr.2906-B/1 Prot., datë 18.12.2020**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 17,576,424 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqintë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqintë e njëzet e katër) lekë, sipas fondi i kompensohen 70% e vlerës në shumen 12,303,496.8 (dymbëdhjetë milion e treqintë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tërë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit Kostandin Boshnjaku, datë 20.12.2020, megjithëse VKM me nr 355 datë 29.04.2020 ka dalë para 8 muajve.

Në dosje nuk ka shkresa të dërguar në ASHK për informacion, dosja e pa sistemuar, vendimi përfundimtar nuk ndodhet në dosje.

Vonesat në dhënjen e relacionit janë veprime në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010.

**-Në Relacionin me Nr.1596-A/3 Prot., datë 31.03.2021**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 13,619,205 (trembëdhjetë milion e gjashtëqintë e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqintë pesë) lekë, sipas fondit i kompensohen 70% e vlerës në shumen 9,533,443.50 (nëntë milion e pesëqintë tridhjetë e tre mijë e katërqintë e dyzet e tre pikë pesëdhjetë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit G.D., datë 24.06.2019, megjithëse VKM me Nr.316 ka dalë në vitin 2019 datë 15.05.2019.

Në shkresën me Nr. 2596/1 Prot, datë 30.10.2019 ATP i është drejtuar ZVRPP-Durrës për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.27/191 në Z.K. 8512, është kthyer përgjigjen nga ZVRPP-Durres në shkresën 7637/1 Prot. datë 18.11.2019 me kartelat përkatëse.

Pra nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga viti 2019 dhe përfunduar në vitin 2021.

Vonesat në dhënjen e relacionit janë veprime në kundërshtim me piken 8 të VKM 383, datë 19.05.2010.

**-Në Relacionin me Nr.3230-A/1 Prot., datë 29.01.2021**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 3,526,886.4 (tre milion e pesëqint e njëzet e gjashtë mijë e tetëqint e tetëdhjetë e gjashtë pikë katër) lekë, sipas fondit i kompensohen 70% e vlerës në shumën 2,468,820.48 (dy milion e katërqintë e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqint e njëzet pikë dyzet e tetë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit L.K., datë 19.02.2020, megjithë VKM me nr.892 datë 18.11.2020.

Në dosje mugojnë shkresat të nisut ASHK-së për statusin juridik të pasurisë me nr.7/109, të ndodhur në Zonën Kadastrale 8518 Durres.

**-Në Relacionin me Nr.3772-A Prot., datë 7.02.2022**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 10,766,920 (dhjetë milion e shtaqint e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqint e njëzet) lekë, sipas fondit i kompensohen 70% e vlerës në shumën 7,536,844 (shtatë milion e pesëqint e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqintë dyzet e katër) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit E.K., datë 07.02.2022, megjithëse VKM me nr 543 ka dale në vitin 2021.

Në dosje nuk është vendimi pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.3772Prot.-A/7 datë 21.04.2022.

**-Në Relacionin me Nr.3625-A/2 Prot., datë 26.10.2021**, për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 8,595,030 (tëtë milion e pesqint e nëntëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë) lekë, sipas fondit i kompensohen 70% e vlerës në shumën 6,016,521 (gjashtë milion e gjashtëdhjetë mijë e pesqint e njëzet e një) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit A. K., datë 13.10.2021, VKM ka dale me nr.604 datë 29.07.2020.

Në dosje nuk është vendimi pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.3625-A/7 Prot. datë 24.12.2021.

Në shkresën me Nr. 3625-A/2 Prot, datë 26.10.2021 ATP i është drejtuar ZVRPP-Tirana Jug për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.9/1177 në Z.K. 8340, është kthyer përgjigjen nga ZVRPP-Tirana Jug në shkresën 10798/3 datë 23.12.2021 me kartelat përkatëse.

Nga verifikimi kostatojme *“Mos përputhje të shkresës së dhënë në kartelat e DV ASHK-Tirana jug ku jepen të dhëna për pasurinë 9/1276 në zonën kadastrale 8340 në Volumin 33 /faqë 126”*.

Relacioni i përgatitur nga grupi ka punuar parcelën me nr. pasurie nr.9/1177 për sipërfaqen 285 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale 8340, pra ka pasaktësi në nr. e pasurisë të trajtuar, pot ka trajtuar nr. Pasurie tjetër.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga dalja e VKM nr 604. Datë 29.07.2020 dhe përfunduar në fund të vitin 2021.

**-Në Relacionin me Nr.3061-A Prot., datë 27.11.2020** për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 11,547,498.2 (njembedhjetë milion e pesqint e dyzetë shtatë mije e katërqint e nëntëdhjet e tetë pikë dy) lekë, sipas fondit i kompensohen 70% e vlerës në shumën 8,083,248.74 (tëtë milion e tetëdhjetë e tre mijë e dy e dyzet e tetë pikë shtatëdhjet e katër)lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit Liri Leka, “pa datë“, VKM me nr.604 datë 20.07.2020.

Dosja nuk është e inventarizuar sipas rradhes se veprimeve të kryera, nuk është vendimi pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.3061-A/3 Prot. datë 27.11.2020. Në shkresën me Nr. 3661-A Prot, datë 18.09.2020 i është drejtuar DV ASHK Tirana-Veri për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.4/1619 në Z.K. 8340, nuk është kthyer përgjigjen nga DV ASHK Tirana-Veri.

Nga verifikimi konstatojme *“Mugojnë të dhënat dhe shkresat me kartelat e AV ASHK Tirana-Veri”*, pra nuk është punuar me të njëjtin standart si në dosjet e tjera.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga dalja e VKM nr. 604. Datë 20.07.2020 dhe përfunduar në fund të vitin 2020.

**-Në Relacionin me Nr.3655-A/1Prot.,datë 21.04.2022** për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 13,124,158.44 (trembedhjetë milion e njëqint e njëzet e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e katër) lekë, sipas fondit kompesohen 70% e vlerës në shumën 9,186,910.91 (nëntë milion e njëqint e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqint e dhjetë pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit O.L., “pa datë“, VKM me nr.526, datë 22.09.2021.

Dokumentacioni në dosje nuk është e inventarizuar sipas rradhes se veprimeve të kryera, nuk është vendimi pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.3655. Prot. datë 21.04.2022.

Pra nga verifikimi konstatojme *“Mugojnë të dhënat dhe shkresat me kartelat e DV ASHK”*, pra nuk është punuar me të njëjtin standart si në dosjet e tjera.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga dalja e VKM nr.526. Datë 22.09.2021 dhe përfunduar në fund të vitin 2022.

**-Në Relacionin me Nr.2960-A/3Prot.,datë 03.06.2021** për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 5,388,500 (pesë milion e treqint e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqint) lekë, sipas fondit i kompesohen 70% e vlerës në shumën 3,771,950 (tre milion e shtatëqint e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqintë pesëdhjetë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit L.N., datë 26.06.2020 mbas daljes së VKM me nr.737 datë 12.12.2018.

Dokumentacioni në dosje nuk është e inventarizuar sipas rradhes se veprimeve të kryera, nuk është vendimi nga titullari i istucionit, pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.2960-A/3Prot.,datë 03.06.2021 për kompensimin financiar të truallit.

Në shkresën me Nr.2960 A/1 datë 13.07.2020 i është drejtuar DV ASHK-Sarandë për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr.4/1619 në Z.K. 8642 dhe kthimi i përgjigjes nga AV ASHK-Sarandë me nr.6266/1 prot datë 24.02.2021.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga dalja e VKM nr.727. datë 12.12.2018 dhe përfunduar në fund të vitin 2021.

**- Në Relacionin me Nr.3451-D/1-AProt.,datë 03.06.2021** për kompensimin financiar të truallit të zëna me ndërtime pa leje në vlerën 15,952,015.80 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë pikë tetëdhjetë)lekë,sipas fondit i kompesohen 70% e vlerës në shumën 11,166,411.06 ( njëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e njëmbëdhjetë pikë zero gjashtë) lekë.

Në dosje është formulari i aplikimit të aplikantit E.R., datë 06.04.2021 mbas daljes së VKM me nr.841.24.12.2019.

Dokumentacioni në dosje nuk është e inventarizuar sipas rradhes se veprimeve të kryera, nuk është vendimi pas relacionit të përgatitur nga grupi shkresën me Nr.3451-D/1 Prot. datë 03.06.2021.

Në shkresën me Nr. 3451-A/3 Prot., datë 11.03.2021 i është drejtuar ZVRPP-Tirana-Jug për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr. 8/982 në Z.K. 8270, nuk është kthyer përgjigjen nga DV ASHK Tirana-Jug.

Nga verifikimi konstatohet *“Mugojnë të dhënat dhe shkresat me kartëlat e DVASHK Tirana-Jug”*, pra nuk është punuar me të njëjtin sandart si në dosjet e tjera.

Nuk argumentohet lëvizja e dosjes nga Sektori i Asistencës Ligjore në Sektorin e Kompensimit, nuk argumentohet në relacionin të përgatitur nga grupi i punës për vonësat nga dalja e VKM nr.841. Datë 24.12.2019 dhe përfunduar në fund të vitin 2021.

*Në të gjitha rastet e audituar ka zvarritje të procesit të kompensimit të pronave për trojet e zëna nga ndërtime pa lejë, kur sipas VKM të dale në vitin 2019 dhe llogaritur për sipërfaqet e zëna, konstatohet se procedurat janë zgjatur nga 1 deri në 3 vjet, sipas pasqyrës konstatohet se 21 subjekte u ka dale VKM-të në vitin 2019 dhe janë shqyrtuar në prill të vitit 2022, në dosje ka mugesë informacioni nga ASHK-ja, dosjet me tejkallim afatesh janë:*

Dosje me nr. 2404-B e vitit 13.03.1019, dosja me nr 2404-A viti 2019, dosja me nr.2404-E viti 2019, dosja me nr .2404-D viti 2019, dosja 2404-C viti 2019, dosja me nr.2404-A/7 me aplikimet nga z. H.P., z. A.P., z. G.P., z .Sh.P., z. L.L, z. H.L., z. Sh.P. dhe znj. M.G., shqyrtuar në prill të vitit 2022 dhe kanë aplikuar në vitin 2019.

Dosjet janë të pa sistemuara, pa inventar, pa shënime për lëvizjet nga një drejtori në tjetrën, mugesë dokumentacioni mbi shkaqet e vonësive, pa pasur një gjurmë dhe arsye për vonesat e krijuara.

Nuk ka shkresa të nisura ASHK-së, mungon bashkëpunimi me instucionet e tjera, për të marrë informacion për të dhënat juridike të këtyre pronave të ish-pronarve.

Nga të dhënat rezulton se VKM-të kanë dalë në mars 2019 dhe kërkesat janë bërë në vitin 2019, dosjet janë shqyrtuar në prill të vitin 2022.

Po ashtu në të gjitha rastet e mësipërme sipas pasqyrës është i njëjti fenomen, për shqyrtimin dhe dhënjën me vonëse të relacionit.

### **Konkluzion:**

*Vonesat në marrjen dhe shqyrtimin e aplikimeve mos dokumentimi i vonesës në dosje me dokument argumentues ligjor mbi shkaqet si dhe dhënjën e relacionit mbas 2 vitesh, janë në kundërshtim me nënin 26 (pika a) e ligjit 133/2015 dhe (Piken 8) të VKM 383, datë 19.05.2010 ku citohet se “Grupi i punës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, brenda 60 (gjashëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet.....”.*

**Titulli i Gjetjes:** Mos ndjekja e procedurave në përshtatshmëri me ligjin për kompesimin e ish-pronarve.

**Situata:** Staf i ATP ka shqyrtuar 21 dosje në vitin 2022 kur aplikimet kanë qënë me vitin 2017, 2018, 2019 dhe nuk janë ndjekur procedurat njësoj për të gjithë aplikantët, ka mungesa informacioni nga instucionet e tjera kryesisht nga ASHK-ja.

**Kritëri:** Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, neni 36.

**Ndikimi:** Shqyrtimi i dosjeve selektive dhe mos ndjekja në kohe e aplikimeve, për menaxhimin dhe administrimin e dosjeve ka një inpakt negativ në arritjen realizimit të planëve vjetore në këtë institucion.

**Rëndësia:** I Lartë.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me numër prot., dhe pa datë, e administruar në KLSH, me nr. 1172/9 prot, datë 12.05.2023, “Mbi Projekt-Raportin e auditimit” dërguar nga Znj. J.B. me detyrë, ish-Drejtori i Përgjithshëm, Z. S.D. me detyrë, ish-Drejtori i Kompensimit, Z. Y.G. me detyrë, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Kompensimit Financiar, Z. M.B. me detyrë, ish-*

*specialist/jurist, Z. E.S. me detyrë, ish-specialist dhe nga Z. B.M.me detyrë, specialist/gjeodet. ku janë shprehur objeksionët si më poshtë:*

### **1. Pretëndimi i subjektit:**

Pasi u njohëm me Projekt Raportin e Auditimit me nr.1172/2, datë 12.04.2023, mbajtur në datë 17.03.2023, administruar pranë ATP me nr. 74/2 prot., datë 13.04.2023, ju parashtrojmë observacionet tona në lidhje me të gjitha gjetjet nga ana juaj që janë konstatuar si shkelje, si më poshtë vijon:

**NË LIDHJE ME GJETJEN 20**, që: Në 2 (dy) raste nuk është marrë informacion i plote për subjektin e shpronësuar nese kanë përfituar tokë bujqësore nga ASHK-ja, nuk ka një informacion nëse ka përfituar tokë bujqësore, në kundërshtim me nenin 21 (Pika 2) dhe nenin 36 (Pika I) c ligjit 133/2015 me ndryshime si dhc VKM nr. 222 datë 23.03.2016 citon "Për trajtimin e kërkesave për njohjen e të drejtës së kompsisimit të pronës" të ndryshuar, ku rekomandohet që: ATP marrë masa dhe të ndjek procedurat ligjore për plotësimin e dosjes sipas kërkesave të ligjit, duke kërkuar informacion nga instiucionet përkatëse nëse qytetari ka përfituar tokë bujqësore ose jo dhe te bëjë korrigjimet përkatëse, sqarojmë:

Në çdo rast ATP ka marrë informacionin lidhur me faktin nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë me Ligjin 7501 "Për Tokën". Ky informacion është marrë përmes deklaratave noteriale të subjektit kërkues, si detyrim i subjektit, i përcaktuar në VKM nr. 223/2016, të ndryshuar, dhe në cdo rast të deklarimeve të rreme është përgjegjësia e deklarusit. ATP nuk mund të dyshojë mbi vërtetësinë e një akti notarial. Nëse ATP do kishte detyrimin që në fazën e ekzekutimit të vlerësimeve financiare, të mbledhte informacion nga institucionet e treta nëse subjektet kanë përfituar ose jo nga ligji 7501, atëhere nuk kishte pse të parashikohej në VKM nr. 223/2016 të ndryshuar detyrimi i subjektit për të paraqitur deklaratën notarial lidhur me këtë fakt.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Komenti i paraqitur nga subjekti i audituar në lidhje me Gjetjen 13, merret në konsideratë, në këto kushte hiqet gjetja dhe rekomandimi i paraqitur në Projekt-Raport.

### **2. Pretëndimi i subjektit:**

**NË LIDHJE ME GJETJEN 22**, që nga të dhënat sipas viteve te kompensimit për parcelat ndërtimore të ardhura nga ASHK për vitet 2020-2022 nuk kanë dokumenta jutifikuese për vonesat e tyre kundërshtim me (Pikën 8) të VKM 383, datë 19,05 2010 ku shprehimisht thuhet "Grupi i punës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet..... , ku rekomandohet te merren masat përkatëse për ndjekjen e të gjithë subjekteve me të njëjtin standart dhe të lerë giurme mbi ato dosje ku ka mugesë dokumentacioni te argumentuar ligjorisht, sqarojmë se:

Shpejtësia apo vonesa në hetimin adiminsitrativ dhe përpilimin e relacionit nga ana e grupit të punës është gjithmonë në varësi të përgjigjes që vjen nga ASHK përkatëse në lidhje me statusin juridik të pasurisë objekt kompensimi, plotësimit të dokumentacionit nga subjekti kërkues, si dhe pamjaftueshmërisë së fondit financiar që transferohet nga ASHK-ja.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Komenti i paraqitur nga subjekti i audituar nuk merret në kosideratë.

## ***10. Hartimi i regjistrit të aplikimeve dhe përgjigjeve nga sektori i Marrëdhënieve me Publikun. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indiciet nga ankesat e administruara në KLSH.***

Nga auditimi u konstatua se:

***1.Ankesa e dërguar prej Z. H.M. pa nr. Prot., datë 11.01.2023, protokolluar në KLSH me nr. 62 prot., datë 16.01.2023.***

### **Përmbajta e ankesës**

Ankesa përmbledhet sa më poshtë:

Z.H.M. ka paraqitur ankesën dhe ka dhënë argumentet e tij, si më poshtë:

Z. H.M., ka paraqitur ankesën e tij për ATP Tiranë, lidhur me njohjen dhe kthimin e një sipërfaqe totale 49 dynym tokë bujqësore, e ndarë në dy parcela, e cila ndodhet në fshatin Gjec, Komuna Prezë, Rrethi Tiranë.

Z. M. parashtron:

“ATP Tiranë (ish-AKKP), ka hapur dosjen nr. 367, datë 05.05.2011, në emër të z. H.M. me kërkesë H.M.. Me nr. 367/23, datë 18.09.2012, AKKP Tiranë ka mbajtur proces-verbalin ku konfirmohet se z. H.M. i është trajtuar me vlerësim ligjor nr.367/21, datë 16.03.2012 dhe po i njëjti dokument ligjor është në fazën e shqyrtimit për të cilën është hapur dosja nr.1125, datë 05.10.2011.

Meqenëse me ligjin nr. 77/2022 ATP është aktivizuar përsëri deri më 31.12.2024, dosja jonë 295/2011 është trajtuar ku me vendim të AKKP nr.616, datë 22.04.2013 ka vendosur se dokumentacioni i ndodhur në dosjen 367, datë 05.05.2011(aktualisht nr.295) nga pikëpamja formale dhe procedurale janë konform VKM nr.255/2010, pikës 4/b/c.

Përfundimisht AKKP me vendimin nr.616/2013 ka vendosur pezullimin e kërkesës për njohjen e së drejtës së pronës me pretendimin se i njëjti dokument kadastral është përdorur nga një subjekt tjetër me dosjen nr.1125 (si palë ndërhyrëse) dhe na orientojnë që t'i drejtohem gjykatës.

I jemi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 1656, datë 06.02.2014 ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 616, datë 22.04.2013 të AKKP Tiranë dhe urdhërimin e AKKP të vazhdojë procedurat e shqyrtimit të kërkesës së z. F.M. me objekt njohjen dhe kthimin e një sipërfaqe totale 49 dynym tokë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 3687, datë 06.11.2014, pasi vendimi mori formë të prerë u nxorr urdhri i ekzekutimit nr. 1656U/2014.

Edhe pala ndërhyrëse me përfaqësues Sh.M. bënë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendim nr.12754, datë 20.12.2013 ka vendosur kthimin e kërkesë padisë së bashku me aktet që e shoqërojnë paditësve Sh. M., etj.

Pas këtij vendimi AKKP, aktualisht ATP Tiranë duhej të ishte shprehur me vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës, në një afat kohor 06.12.2014 deri në 02.2019, pra kemi një vendim apa ekzekutuar nga data 20.12.2014.

Më datë 29.09.2016, me nr. 3293/2 prot., ATP lëshon shkresën zyrtare ku shprehet se:

-Me shkresën nr. 295/2, datë 13.05.2016, ATP ka kërkuar konfirmimin e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë.

-Me shkresën nr. 295/4, datë 13.05.2016, ATP ka kërkuar konfirmimin e Njesisë Administrative Prezë.

-Me shkresën nr. 295/1, datë 13.05.2016, ATP ka kërkuar konfirmimin e ALUIZNIT Drejtoria Rajonale Tiranë dhe konfirmon:

ATP ka ekzekutuar plotësisht pikën 3 të vendimit nr. 1656, datë 21.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendim nr. 3687, datë 06.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Më datë 24.02.2021, me nr.1576/1 prot., ATP na drejtohet me një shkresë ku informon se “në dosje nuk ndodhet e administruar shkresa nr. 3293, datë 29.09.2016, për të bërë mundur e kërkesës së z. H.M. është e nevojshme të na përcillni kopje të kësaj shkrese”.

Pra, kjo shkresë është zhdukur nga dosja 295 e megjithatë kjo kopje ju dërgua ATP edhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. H-11/4, datë 07.05.2021, poë përsëri nuk janë shprehur me vendim.

Unë nuk kam bërë padi në gjykata kundër ATP, sepse nuk dihej se sa vite duhen për t'u shprehur, por meqenëse doli ligji nr.77/2022 për aktivizimin e ATP, po ju drejtohem përsëri me shpresën që kërkesa jonë do të merret në konsideratë sa më shpejt që te jetë e mundur”.

### **Përmbajtja e dosjes së ankimesit.**

Ankesa përmban dokumentacionin bashkëlidhur (fotokopje):

-Shkresë e KLSH nr. 481/2, datë 24.08.2021 drejtuar z. H.M., për trajtimin e dosjes në auditimin e rradhës.

-Proces-Verbal me nr. 367/23, datë 18.09.2012, i mbajtur në AKKP Tiranë ku konfirmohet se z. H.M. i është trajtuar me vlerësim ligjor nr.367/21, datë 16.03.2012 dhe po i njëjti dokument ligjor është në fazën e shqyrtimit dhe hetimit administrativ për të cilën është hapur dosja nr.1125, datë 05.10.2011 në emër të Z. H.M. me kërkues Sh.M..

Për këto arsye ju kërkua përfaqësuesve në cilësinë e kërkuesve për dokumentacionin:

1. Vërtetimi kadastral sipas fletës përkatëse të regjistrit.
2. Certifikatë e trungut familjar të vitit 1946 për seicilën nga palët pretenduese.

Proces-verbali është nënshkruar për AKKP nga grupi i punës L.F. Inspektore Juriste, A.S. Inspektore Juriste, D.K.Ing/Gjeodet.

Për pronarët është nënshkruar nga:

-përfaqësuesi me prokurë i dosjes 367, datë 05.05.2011- H.M.

-përfaqësuesi me prokurë i dosjes 1125, datë 05.10.2011- Sh.M

-Vendim nr. 1656/U “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” me objekt: “Anullimin e vendimit nr. 616, datë 02.04.2013 të AKKP Tiranë.

Urdhërimin e palës së paditur të vazhdojë procedurat e shqyrtimit të kërkesës së përfaqësuesit z. H.M. me objekt njohjen dhe kthimin e një sipërfaqe totale 49 dynym tokë.

- Vendim nr.12754, datë 20.12.2013 “Për kthimin e kërkesë-padisë” i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me ka vendosur kthimin e kërkesë padisë së bashku me aktet që e shoqërojnë paditësve Sh.M..

- Shkresa e ATP nr. 3293/2, datë 29.09.2016 “Kthim përgjigje”, drejtuar znj. N.B., Përmbarese Gjyqësore Privat, ku informohet se:

-Me shkresën nr. 295/2, datë 13.05.2016, ATP ka kërkuar konfirmimin e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë.

-Me shkresën nr. 295/4, datë 13.05.2016, ATP ka kërkuar konfirmimin e Njësisë Administrative Prezë.

-Me shkresën nr. 295/5, datë 03.06.2016, ATP ka lajmëruar kreditorin H. F.M.për plotësim të dokumentacionit.

Në fund ATP shprehet se ka ekzekutuar plotësisht pikën 3 të vendimit nr. 1656, datë 21.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendim nr. 3687,datë 06.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

-Shkresa e ATP nr. 1576/1, datë 24.02.2021, “Kthim përgjigje” Ministrisë së Drejtësisë (drejtoritë përkatëse) dhe për dijeni Z. H.M., ku informon veç të tjerave se “në dosje nuk ndodhet e administruar shkresa nr. 3293/2, datë 29.09.2016, për të bërë mundur e kërkesës së Z. M. është e nevojshme të na përcillni kopje të kësaj shkrese”.

-Relacione shpjeguese për projekt ligje të ndryshme.

### **DOSJA NË ATP**

#### **Përmbajtja e dosjes**

Për sa sa u përmend edhe në rubrikën për trajtimin e dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, dosja është tërhequr nga ankuesi me proces-verbalin nr.295/13, datë 24.12.2020 dhe në dosje ndodhen fotokopje të dokumentacionit të tërhequr.

Nga verifikimi në ATP Tiranë, rezulton se në emër të ankimesit është hapur nr. 367, datë 05.05.2011 dhe më pas dosja 295, datë 31.12.2015.

Po analizojmë përmbajtjen e dosjes nr.295, datë 31.12.2015 (fotokopje), si më poshtë:

-**Shkresë** nr.2596/1, datë 24.12.2020 “Kthim përgjigje” z. H.M. në përgjigje të kërkesës së subjektit nr. 2596 prot., datë 22.12.2020, për dorëzimin e dosjes sipas proces-verbalit nr. 295/13 prot., datë 24.12.2020, mbi tërheqjen e dokumentacionit që ndodhet në dosjen nr. 295

prot., datë 31.12.2015, të depozituar në emër të subjektit të pretenduar të shpronësuar H.M., të pa trajtuar brenda afateve ligjore të përcaktuar në nenin 34, të ligjit nr. 133/2015.

**-Proces-Verbali** nr.295/13, datë 24.12.2020 “Për tërheqje dokumentacioni”, i mbajtur midis ATP përfaqësuar nga *inspektor/ing. R.K. e cila ka në ngarkim (dosjen/praktikën)* dhe palës së interesuar H.M., në lidhje me tërheqjen e kërkesës së pa trajtuar dhe dokumentacionit bashkëlidhur në emër të subjektit të pretenduar si i shpronësuar z. H.M. me nr. 295, datë 31.12.2015.

Proces-Verbali përmban 45 (dyzetepesë) tituj dokumentesh, të fotokopjuara, si më poshtë:  
*1.Vërtetim pronësie nr.428, datë 05.04.2010, lëshuar nga SAMT Qarku Tiranë, ku vërtetohet se z. H.M. është regjistruar në dokumentacionin kadastral të vitit 1946, Tokë Arë, Djerrë, Ullishte, gjithsej 49 dynym dhe 23 rrënjë ullinj.(origjinale).*

*Vendim nr. 5043, datë 18.06.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përcaktim i kufijve dhe vendndodhje e pronës prej 49 dy tokë të trashëgimlënësit H.M.. (origjinale).*

*2.Shkresë ZRPP dt.20.09.2010, kthim përgjigje e shkresës nr.271, datë 10.08.2010, duke përcaktuar pasuritë pronë shtet në pronën e pretenduar (noterizuar).*

### **ANALIZA E FAKTEVE**

- Në emër të z. H.M. me kërkues H.F., është hapur dosja **nr. 367, datë 05.05.2011.**

-Me **nr.367/21, datë 16.03.2012** është kryer vlerësimi ligjor “Mbi shqyrtimin e dosjes nr. 367, datë 05.05.2011 në emër të subjektit të shpronësuar H.M..

**Sa sipër është krijuar një vonese prej 10 muajsh e 11 ditë,** e pajustificueshme.

Vlerësimi ligjor është hartuar:

Shqyrtoi dhe vlerësoi: Grupi i punës: F.L., Jurist; D.K Inxhinier.

Mbikqyri dhe pranoi: Përgjegjësi i sektorit të Shqyrtimit z. P.P..

Sa sipër është vendosur dhe rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm z. E.C.:

*-Njohja e së drejtës së pronësisë subjektit të shpronësuar H.M., trashëgimtarëve të tij ligjorë për pronën me sipërfaqe 49000 m2 që ndodhet në Fshatin G, Fushë, Komuna Prezë, rrethi Tiranë.*

*-Kthimi i sipërfaqes S2=4000 m2, 18 trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar H.M.,*

*-Kompensimin për sipërfaqen 29785 m2, 18 trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar H.M..*

*-Moskthimin dhe moskompensimin e sipërfaqes prej 15215 m2, meqenëse trashëgimtarët ligjorë të subjektit e kanë përfutur këtë sipërfaqe sipas ligjit “Për Tokën”.*

**Lidhur më këtë vlerësim ligjor nuk ka asnjë vendimarrje nga ish- Drejtori i Përgjithshëm z. E.C.**

**-Proces-Verbal nr. 367/23, datë 18.09.2012,** i mbajtur në AKKP Tiranë ku konfirmohet se z. H.M. është trajtuar me vlerësim ligjor nr.367/21, datë 16.03.2012 dhe po i njëjti dokument ligjor është në fazën e shqyrtimit dhe hetimit administrativ për të cilën është hapur dosja nr.1125, datë 05.10.2011 në emër të Z. H.M. me kërkues Sh.M..

Për këto arsye ju kërkua përfaqësuesve në cilësinë e kërkuesve për dokumentacionin:

1. Vërtetimi kadastral sipas fletës përkatëse të regjistrit.

2. Certifikatë e trungut familjar të vitit 1946 për seicilën nga palët pretenduese.

Proces-verbali është nënshkruar për AKKP nga grupi i punës L. F. Inspektore Juriste, A. S. Inspektore Juriste, D.K., Ing/Gjeodet.

Për pronarët është nënshkruar nga:

-përfaqësuesi me prokurë i dosjes 367, datë 05.05.2011- H.M.

-përfaqësuesi me prokurë i dosjes 1125, datë 05.10.2011- Sh.M.

***Megjithëse proces-verbali është pranuar nga pronarët, përsëri është shtyrë afati i shqyrtimit të dosjes edhe me 6 muaj të tjerë,*** ku vetë KKKP kundërshton vetveten në mënyrë antiligjore, sepse dokumentacioni ka qenë qartësisht në emër H.M..

***Më pas me Vendimin nr. 616, datë 22.04.2013, AKKP (A.P. Drejtor i Përgjithshëm), ka marrë vendim për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për njohjen e së drejtës së pronësisë, sepse sipas AKKP dokumentacioni ligjor i depozituar në dosje nuk jep fakte juridike, të cilat të vërtetojnë të drejtën e pronësisë për njërin nga subjektet e shpronësuar.***



Por, sikurse u trajtua edhe më sipër dokumentet nga kadastra e gjithcka tjetër është në emër H.M. .

**Me këtë vendim qytetari është vonuar 7 muaj të tjerë.**

Vendimi i mësipërm e ka detyruar qytetarin t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 1656, datë 06.02.2014 ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 616, datë 22.04.2013 të AKKP Tiranë dhe urdhërimin e AKKP të vazhdojë procedurat e shqyrtimit të kërkesës së z. F.M. me objekt njohjen dhe kthimin e një sipërfaqe totale 49 dynym tokë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 3687, datë 06.11.2014, pasi vendimi mori formë të prerë u nxor urdhri i ekzekutimit nr. 1656U/2014.

**Fakti i vendimit të gjykatës tregon paligjshmërinë e Vendimit nr. 616, datë 22.04.2013 të AKKP Tiranë, ku vetë gjykata në pjesën arsyetuese është shprehur se:**

“Gjithashtu pala e paditur pavarësisht se pronën e pretendojnë dy subjekte duhet të shprehet me vendim në mënyrë që të marrë zgjidhje konflikti me rrugë gjyqësore”.

**Si rezultat i zgjatjes së procedurës, shqyrtimi i dosjes është vonuar me 10 muaj të tjerë, për faj të AKKP.**

**Vendim nr.12754, datë 20.12.2013 “Për kthimin e kërkesë-padisë”** i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur kthimin e kërkesë padisë së bashku me aktet që e shoqërojnë paditësve H.M., S.K., B.M., P.M., Sh.M., për shfuqizimin e Vendimit nr. 616, datë 22.04.2013 të AKKP.

Pas këtij vendimi, AKKP Tiranë nuk ka vepruar për shqyrtimin e dosjes, megjithëse Shoqëria Përmbartimore J., me shkresat: nr. 160, datë 30.12.2014, nr. 108, mdatë 29.01.2015, nr.1268, datë 20.09.2016; nr. 1465 prot., datë 14.10.2016 nr. 352, datë 02.03.2017, nr.162, datë 17.01.2019, i është drejtuar AKKP, ATP, për vazhdimin e procedurave për pronën H.M..

Me shkresë nr. 295/5, datë 03.06.2016, të nëshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. S.Q., i drejtohet z. M. kërkesë për plotësimin e dosjes.

*Siç u përmend më sipër dosja ka qenë e kompletuar qysh në vitin 2012, kur me vlerësimin ligjor nr.367/21, datë 16.03.2012 është kryer vlerësimi ligjor “Mbi shqyrtimin e dosjes nr. 367, datë 05.05.2011 në emër të subjektit të shpronësuar H.M..*

*Në vijim të paligjshmërisë, ATP me shkresë nr. 295, datë 13.05.2016, i është drejtuar Qarkut Tiranë dhe Njësisë Administrative Prezë, për konfirmim të gjendjes juridike të Pronës. Siç u tha më sipër procesi ka qenë i mbyllur.*

**Këto zgjatje të paligjshme të procedurës së shqyrtimit nga ATP Tiranë, i kanë shkaktuar qytetarit një vonesë prej 2 vjet e 3 muaj.**

Procedura nuk ka vazhduar më nga ana e ATP kur me shkresën nr. 295/12, datë 12.06.2019, i është drejtuar z. H.M., ku e njofton lidhur me dosjen e tij 295, datë 21.12.2015, se dosje është mbyllur referuar nenit 34, të ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 dhe cdo problem është në kompetencë të gjykatës.

Më këtë janë shkaktuar edhe 2 vjetë të tjerë në të cilët dosja e z. Mesiti nuk është shqyrtuar.

**Gjithsej vonesa prej vitit 2011 deri në vitin 2019, pra rreth 8 vjet vonesa të paligjshme, të shkaktuara nga institucioni AKKP, ATP.**

Për sa sa u përmend edhe më sipër, dosja është tërhequr nga ankuesi me proces-verbalin nr. 295/13, datë 24.12.2020 dhe në dosje ndodhen fotokopje të dokumentacionit të tërhequr.

## **KONKLuzion**

*Qytetarit ankues z. H.M., (si dhe gjithë trashëgimtarëve) si rezultat i vonesave të gjata prej 8 viteve (2011-2019) nga ana e AKKP, ATP, Tiranë, i është shkelur e drejta e tyre, duke qenë plotësisht përligjur për të kërkuar vendimmarrje nga ana e institucionit ATP lidhur me pronën e tyre, detyrim i konfirmuar edhe nga vendimet 2 shkallëve të gjykatës, si rezultat i papërgjegjshmërisë dhe neglizhencës së stafit të institucionit në fjalë.*

**Titulli: Ankesa e z. H.M., protokolluar në KLSH me nr. 62 prot., datë 16.01.2023.**

**Situata:** AKKP dhe ATP Tiranë, kanë zgatur procedurat ligjore për vendimmarrje për Subjektin e Shpronësuar H.M., herë me justifikime dhe vendimmarrje antiligjore për pezullim procedurash dhe herë pa shkak, ku preteksti ka qenë se për të njëjtin subjekt të shpronësuar kanë aplikuar 2 degë trashëgimtarësh, duke ju hapur 2 dosje dhe vonesa që kanë vazhduar edhe pas vendimmarrjes së formës së prerë të 2 shkallëve të gjykatës procedurë e përfunduar në Nëntor 2014 me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 3687, datë 06.11.2014, dhe u nxorr urdhri i ekzekutimit nr. 1656U/2014.

*Sa më sipër qytetarit ankues z. H.M., (si dhe gjithë trashëgimtarëve) si rezultat i vonesave të gjata prej 8 viteve (2011-2019) nga ana e AKKP, ATP, Tiranë, i është shkelur e drejta e tyre, duke qenë plotësisht i përligjur për të kërkuar vendimmarrje nga ana e institucionit AKKP, ATP lidhur me pronën e tyre, detyrim i konfirmuar edhe nga vendimet 2 shkallëve të gjykatës, si rezultat i papërgjegjshmërisë dhe neglizhencës së stafit të institucionit në fjalë.*

**Kriteri:** Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”; Ligji nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar,

**Efekti:** Përformancë e ulët në kryerjen e shërbimit për subjektin e shpronësuar H.M. (trashëgimtarët).

**Shkaku:** Mungesë përgjegjshmërie nga drejtuesit dhe stafi i ATP

**Rëndësia:** I lartë

## **2. Ankesa e dërguar prej Z. A. O. pa nr. Prot., datë 08.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 1115 prot., datë 12.12.2022.**

### **Përmbajta e ankesës**

Ankesa përmbledhet sa më poshtë:

Z. A.O. ka paraqitur ankesën dhe ka dhënë argumentat e tij, si më poshtë:

*Z. A.O., ka paraqitur ankesën e ti për ATP Tirënë, Drejtorinë e Kompensimit, lidhur me detyrimin për leje të legalizimit të lëshuara mbi tokën truall të regjistruar në DV ASHK Sarandë.*

*Z. A.O. parashtron:*

*“Me aplikimin ATP-2022-4963358-XJ kam aplikuar pranë ATP, pasi është miratuar masa e kompensimit financiar me VKM nr.543, datë 29.09.2021, për mua dhe bashkëshorten pasi mbi truallin tim në qytetin e Sarandës një person i tretë është pajisur me leje legalizimi.*

*Pas një kalvari të gjatë, vjen përgjigje ku njoftojnë se aplikimi është refuzuar pa dhënë arsye. Pasi kam bërë ankesë në platformën e bashkëqeverisjes më japin arsye se ASHK Sarandë duhet t'i saktësojë sipërfaqen, pavarësisht se nga ASHK Sarandë u është vënë në dispozicion një material i kërkuar.*

*Me marrjen e përgjigjes i drejtohem ASHK Sarandë, pavarësisht se kjo është detyrë e ATP.*

*Me shkresën ne. 10274 prot., datë 26.10.2022, ASHK Sarandë kthen përgjigje profesionalisht pa lënë hapësira për interpretim.*

*Edhe pas kësaj ATP Tiranë, ka nxjerrë justifikime për të vështirësuar dhënien e shërbimit, të cilin nuk e kanë ofruar, i jam drejtuar 2 herë platformës së bashkëqeverisjes, por ATP nuk ka kthyer përgjigje e jo më të japë shërbim”.*

### **Përmbajtja e dosjes së ankimesit**

Ankesa përmban dokumentacionin bashkëlidhur:

-Përgjigje nga Zyra e Bashkëqeverisjes, ku thuhet se ankuesi do marrë përgjigje brenda 10 ditëve punë nga institucioni përgjegjës.

-Shkresa nr. 10274, datë 26.10.200, e DV ASHK Sarandë, drejtuar ATP-së (Drejtorisë së Kompensimit) dhe për dijëni z. A.O., ku i kthehet përgjigje z. A.O. për ankesën në portalin e bashkëqeverisjes për saktësim sipërfaqe ku sqarohet se:

Me shkresën nr. 4498/1, datë 09.06.2022, ASHK Sarandë ju ka kthyer përgjigje duke theksuar se sipërfaqja e pasurisë 9/27, regjistruar në volum 3, faqe 243 e llojit truall është 144 m<sup>2</sup> dhe rezulton e regjistruar në pronësi të A.dhe II.O..

Bashkëlidhur shkresës janë kopja e kartelës aktuale të pasurisë, ku fillimisht pasuria rezulton në bashkëpronësi të A.dhe II.O dhe mbi këtë pasuri është regjistruar pronësia e subjekteve S. dhe A.H. për objekt 2 kate me sipërfaqe baze 115.9 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 418 m<sup>2</sup>.

Sa i përket sipërfaqes 143.4 m<sup>2</sup> e cila figuron në kartelë, kjo sipërfaqe është saktësuar përfundimisht 144 m<sup>2</sup> sipas aktit të fitimit të pronësisë në kuadër të nenit 193 të Kodit Civil.

-Vendimi nr. 543, datë 29.09.2021 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara”.

### **Dosja në ATP dhe analiza e fakteve.**

Nga verifikimi në ATP Tiranë, rezulton se në emër të ankimesit është hapur i dosja nr. 3995-A, datë 12.02.2022, Drejtoria e Kompensimit.

*Nga këqyrja e dosjes nr. 3995-A, datë 12.05.2022, të hapur në emër të A. O. nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, është një dosje në shqyrtim e papërfunduar për të cilën ishte ngarkuar znj. J. K. dhe prej datës 28.12.2022 ndiqet nga juristi E.Sh, dorëzuar me proces-verbal prej znj. J.M..*

Dosja përmban dokumentet, të cilat po i paraqesim sipas rradhës kronologjike:

-Formular Aplikimi për “Kompensim në Vlerë për Pronarët e Pasurive të Paluajtshme Pronë Private që Preken nga Ndërtimet Informale (ALUIZNI), i z. A. O., datë 11.05.2022.

-Shfaqja e aplikimit në portalin e-albania, datë 11.05.2022.

-Dokument bankar për pagesën e shërbimit.

-Shkresë nr. 3995-A/1, datë 27.05.2022 e ATP drejtuar DV e ASHK Sarandë, kërkesë informacion për gjendjen juridike të pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, ku kërkohet përcaktimi i pjesëve takuese të seicilit prej bashkëpronarëve si dhe përcaktimi nëse pasuria është e litë nga çdo barrë hipotekore. (Në mungesë ZV Drejtori i Përgjithshëm z. A. R.)

-Shkresë nr. 4498/1, datë 09.06.2022 e DV ASHK Sarandë (protokolluar në ASHK 3995-A/2 prot, datë 15.06.2022), Kthim përgjigje, ku përcaktohet pasuria prej se pasuria në fjalë është regjistruar në pronësi të A.dhe II.O. (bashkëpronësi në pjesë ideale të barabarta), nuk përmban kufizime hipotekore dhe mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar në favor të shtetasit S. dhe A.H.

*Të dhënat e mësipërme janë të nevojshme por janë konsideruar të pamjaftueshme nga Grupi i Punës për të saktësuar pasurinë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, por në mungesë të kartelës së pasurisë, është konsideruar e nevojshme nga inspektori/juristi për vazhduar që dosja të mbahet e hapur në proces.*

-Shkresë nr. 3995-A/3, datë 08.08.2022 e ATP Tiranë drejtuar z. A. O., në përgjigje të suajës nr.ATP-2022-4963358-XJ, i bën me dije ankuesit se me shkresën nr. 3995-A/1, datë 27.05.2022 i është kërkuar DV ASHK Sarandë konfirmim për gjendjen juridike të pasurisë nr.9/27, të ndodhur në Z.K. 8642, duke na vendosur në dispozicion dhe kartelën e pasurisë përkatëse.

DV ASHK Sarandë me shkresën 3995-A/2 prot, datë 15.06.2022 ..nuk ka bashkëlidhur kartelën shoqëruese (Në mungesë ZV Drejtori i Përgjithshëm z. A.R.).

Më datë 11 Gusht ka përfunduar afati 60 ditor i verifikimit të kërkesës nga grupi i punës, në një kohë që veprimet kanë vazhduar deri më sot duke zgjatur afatin e shqyrtimit të kërkesës.

I gjithë dokumentacioni dhe veprimet e mëposhtme janë në zgjatje mbi 60 ditë, të periudhës së shqyrtimit.

-Bashkëlidhur KSHP nr. 3995-A/4, datë 29.08.2022 gjendet shkresa e z. A.O. datë 25.08.2022, ku bashkëlidhur saj ankimesi ka dërguar të dhënat e kartelës së pasurisë nr.9/27, ZK 8642 dhe pjesët takuese të bashkëpronarëve, të nxjerra me rrugë elektronike.

-Shkresë nr. 3995-A/5, datë 18.11.2022 e ATP drejtuar DV e ASHK Sarandë, kërkesë për rikonfirmim, ku citohet se “Me shkresën tuaj me nr. 4498/1 prot., datë

09.06.2022,...konfirmoni gjendjen juridike të pasurisë nr. 9/27 dhe listën e bashkëpronarëve, por nuk citoni zonën kadastrale dhe nuk bashkëlidhni kartelën e pasurisë pasi në shkresën përcjellëse shpreheni se informacioni i dhënë nuk është i garantuar nga DV ASHK Sarandë.

*Në vijim të procedurave, ATP Tiranë kërkon konfirmim për gjendjen juridike të pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, përcaktimin nëse kjo pasuri është e lirë nga çdo barrë hipotekore, inskripti apo bllokimi, duke bërë kështu të mundur nga ana jonë përcaktimin e vlerës së akorduar të kompensimit.*

-Bashkëlidhur KSHP nr. 3995-A/6, datë 09.01.2023, gjendet shkresa e DV ASHK Sarandë nr.11638/1, datë 29.12.2022, drejtuar ATP Tiranë dhe për dijeni z. A.O., kthim përgjigje për shkresën nr. 3995-A/5, datë 18.11.2022, ku konfirmohen edhe njëherë të gjithë të dhënat e kërkuara më parë si dhe në fund citohet se:

*Me shkresën nr.10274 Prot., dt.26.10.2022, ASHK Sarandë ka përcjellë pranë jush saktësimet e nevojshme si dhe kopjen e kartelës së pasurisë e cila ka rezultuar e lirë dhe pa asnjë kufizim ose barrë hipotekore të regjistruar në seksionet përkatëse të saj.*

-Shkresë nr. 3995-A/7 prot., datë 23.01.2023 e ATP drejtuar DV e ASHK Sarandë, kërkesë për rikonfirmim, ku citohet se:

*për vijimin e procedurave të përcaktimit të vlerës së akorduar të kompensimit, kërkojmë konfirmim për gjendjen juridike të pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, përcaktimin e pjesëve takuese të seicilit prej bashkëpronarëve si dhe një informacion nëse kjo pasuri është e lirë nga çdo barrë apo detyrim që mund të vendoset mbi pronën, duke bashkëlidhur edhe kartelën e pasurisë me të gjitha seksionet.*

Sa sipër konstatohet se janë kërkuar të njëjtat të dhëna të kërkuara edhe me shkresat e mëparshme, duke zgjatur afatin e shqyrtimit të kërkesës, në një kohë që sipas DV e ASHK Sarandë, të dhënat janë përcjellë me shkresën nr.10274 Prot., dt.26.10.2022, por që nuk konsiderohen nga ATP, për faktin e mungesës së KPP dhe pasaktësive në të.

-Shkresë nr. 3995-A/8 prot., datë 07.02.2023 e ATP drejtuar DV e ASHK Sarandë, kërkesë për rikonfirmim, ku citohet se

*për vijimin e procedurave të përcaktimit të vlerës së akorduar të kompensimit, kërkojmë konfirmim për gjendjen juridike të pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, përcaktimin e pjesëve takuese të seicilit prej bashkëpronarëve si dhe një informacion nëse kjo pasuri është e lirë nga çdo barrë apo detyrim që mund të vendoset mbi pronën, duke bashkëlidhur edhe kartelën e pasurisë me të gjitha seksionet.*

Për të katërtën herë rezulton se janë kërkuar të njëjtat të dhëna të kërkuara edhe me shkresat e mëparshme, duke zgjatur afatin e shqyrtimit të kërkesës, në një kohë që të dhënat janë përcjellë me shkresën nr. 10274 Prot., dt.26.10.2022, ASHK Sarandë, por ATP pretendon se nuk kanë kartelën e pasurisë bashkelidhur.

Në dokumentacionin e shkëmbyer me ankuesin, në mënyrë dixhitale, nga juristi znj. E. Sh., na është vënë në dispozicion fotokopje e shkresës nr. 10274, datë 26.10.2022, e DV ASHK Sarandë, drejtuar ATP-së (Drejtorisë së Kompensimit) dhe për dijeni z. A.O., ku i kthehet përgjigje z. A.O. për ankesën në portalin e bashkëqeverisjes për saktësim sipërfaqe ku sqarohet se:

Me shkresën nr. 4498/1, datë 09.06.2022, ASHK Sarandë ju ka kthyer përgjigje duke theksuar se sipërfaqja e pasurisë 9/27, regjistruar në volum 3, faqe 243 e llojit truall është 144 m2 dhe rezulton e regjistruar në pronësi të A.dhe II.O..

**Bashkëlidhur shkresës janë kopja e kartelës aktuale të pasurisë,** ku fillimisht pasuria rezulton në bashkëpronësi të A. dhe II.O. dhe mbi këtë pasuri është regjistruar pronësia e subjekteve S dhe A.H.për objekt 2 kate me sipërfaqe baze 115.9 m2 dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 418 m2.

*Sipas znj. S.B., protokolluese, rezulton se shkresa nr. 10274, datë 26.10.2022, e DV ASHK Sarandë, është protokolluar në ATP Tiranë me nr. 5972 prot., datë 28.10.2022 dhe shkresa ka hyrë në Sektorin përkatës **pa dokumentacionin bashkëlidhur dhe nuk ka kthim përgjigje.***

ASHK Sarandë në përgjigje të shkresës së ATP nr. 3995-A/8 prot., datë 07.02.2023, me shkresën nr. 1814/1 datë 10.03.2023 administruar pranë ATP me nr 3995-A/9 prot., datë 15.03.2023, konfirmon se pasuria nr. 9/27, ZK.8642, Sarandë figuron në emër të A.dhe II.O. duke bashkëlidhur me kartelën. Kjo përgjigje nga ASHK ka ardhur pas auditimit të dosjes nga KLSH, pra 35 ditë me vonesë nga kërkesa e fundit për rikonfirmim.

Pra më datë 15.03.2023, shqyrtimi nga Grupi i Punës, konsiderohet i mbyllur.

### **Konkluzioni i grupit të auditimit të KLSH**

ATP Tiranë, e ka trajtuar kërkesën e z. A.O. duke hapur dosjen nr. 3995-A, datë 12.05.2022, trajtim i cili është në proces, duke tejkalluar afatet ligjore dhe pa e kaluar për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm i AKP.

Shkak i tejkallimit të këtyre afateve, është bërë DV ASHK Sarandë, e cila ose nuk ka sjellë bashkëlidhur kartelën ose nuk i ka përcjellë të sakta të dhënat e kësaj KPP.

Kështu, theksojmë se deri në mbylljen e auditimit datë 17.03.2023 kanë kaluar 10 muaj e 5 ditë (307 ditë), nga data e kërkesës së z. D.O. dhe dosja është ende në proces, në një kohë që afati për këtë proces verifikimi duhej mbyllur brenda 60 ditësh, jo në përputhje me VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar, pika 8.

Brenda kësaj periudhe prej 307 ditësh janë shkaktuar vonesa në nisjen e shkresave si dhe kërkesave drejtuar DV ASHK Sarandë, si më poshtë:

- Shkresa për ASHK Sarandë është datë 27.05.2022.
- Përgjigja e DV ASHK Sarandë është protokolluar më datë 15.06.2022,
- Shkresa e dytë për rikonfirmim i është dërguar DV ASHK Sarandë më datë 18.11.2022.
- Përgjigja e DV ASHK Sarandë është protokolluar më datë 09.01.2023.
- Shkresa e tretë për rikonfirmim i është dërguar DV ASHK Sarandë më datë 23.01.2023.
- Shkresa e katërt për rikonfirmim i është dërguar DV ASHK Sarandë më datë 07.02.2023.

Në shkresat zyrtare të nisura DV ASHK Sarandë, kërkesa ka qenë paraqitja e kartelës për pasurinë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, dhe përgjigja e DV ASHK Sarandë ka qenë se kartela është dërguar me shkresë nr. 10274, datë 26.10.2022, për të cilën ATP pretendon se nuk ka patur kartelën bashkëlidhur, megjithëse në shkresë cilësohet se bashkëlidhur ndodhet kartela.

Megjithatë, theksojmë se qysh me shkresën e DVASHK Sarandë të protokolluar më datë 15.06.2022, jepen të dhënat e nevojshme por jo të mjaftueshme sipas ATP, për pasurinë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, sipas germës “c”, pikës 8, e VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar.

Dosja ka mbetur e hapur dhe procedurat janë zgjatur, si pasojë e mosparaqitjes zyrtare dhe më të dhëna të sakta të Kartelës së Pasurisë, nga DV ASHK Sarandë.

**Situata:** Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, ka trajtuar kërkesën e z. A.O. duke hapur dosjen nr. 3995-A, datë 12.05.2022 trajtim i cili është në proces, duke tejkalluar afatet ligjore dhe pa e kaluar për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm i AKP, me vonesa në dhënien e kompensimit financiar sipas Vendimit të KM nr. 543, datë 29.09.2021 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara”.

Dosja ka mbetur e hapur dhe procedurat janë zgjatur, si pasojë e mosparaqitjes zyrtare dhe më të dhëna të sakta të Kartelës së Pasurisë, nga DV ASHK Sarandë.

Zgjatja e afateve ligjore justifikohet me faktin se DV e ASHK Sarandë, nuk ka sjellë gjendjen juridike të pronës së dokumentuar të z. A.O., të kërkuar nga ATP Tiranë, megjithëse janë bërë 4 kërkesa dhe për këto kërkesa DV ASHK Sarandë është përgjigjur se kartela e pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, në emër të A. dhe II. O, është dërguar me shkresë

nr.10274, datë 26.10.2022, për të cilën ATP pretendon se nuk ka patur kartelën bashkëlidhur, megjithëse në shkresë cilësohet se bashkëlidhur ndodhet kartela.

Deri në mbylljen e auditimit datë 17.03.2023 kanë kaluar 10 muaj e 5 ditë (307 ditë), nga data e kërkesës së z. D.O. dhe dosja është ende në proces, në një kohë që afati për këtë proces verifikimi duhej mbyllur brenda 60 ditësh, **në tejkallim prej 247 ditësh.**

ATP, me shkresën nr 3995-A/8 datë 07.02.2023, i kërkoj sërish rikonfirmim në lidhje me gjendjen juridike duke bashkëlidhur kartelën e pasurisë me të gjitha seksionet.

ASHK Sarandë në përgjigje të shkresës së sipërcituar me shkresën nr. 1814/1 datë 10.03.2023 administruar pranë ATP me nr 3995-A/9 prot., datë 15.03.2023, konfirmon se pasuria nr. 9/27, ZK. 8642, Sarandë figuron në emër të A. dhe Il.O. duke bashkëlidhur me kartelën. Kjo përgjigje nga ASHK ka ardhur pas auditimit të dosjes nga KLSH, pra 35 ditë me vonesë nga kërkesa e fundit për rikonfirmim.

Pra më datë 15.03.2023, shqyrtimi nga Grupi i Punës, konsiderohet i mbyllur.

**Kriteri:** -Vendimi i KM nr. 543, datë 29.09.2021 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara”.

-VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar, pika 8.

**Efekti:** Vonesa në kryerjen e shërbimit dhe kompensimin financiar për pronarin A dhe Il. O.

**Shkaku:** Dosja ka mbetur e hapur dhe procedurat janë zgjatur, si pasoje e mosparaqitjes zyrtare dhe më të dhëna të sakta të Kartelës së Pasurisë, nga DV ASHK Sarandë.

**Rëndësia:** I mesëm

### **3.Ankesa e dërguar prej Z. H.K pa nr. Prot., datë 04.07.2022, protokolluar në KLSH me nr. 675 prot., datë 06.07.2022.**

#### **Përmbajta e ankesës**

Ankesa përmbledhet sa më poshtë:

Z. H.K. ka paraqitur ankesën dhe ka dhënë argumentet e tij, si më poshtë:

*Për të tretën herë z. H. K., 82 vjeç, i është drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, për problemin e kompensimit të tij financiar që duhej t`i paguhej atij si dhe 6 vëllezërve dhe motrave për kompensimin e shtëpisë së shembur në emër të së ndjerës C.K..*

Z. H.K. shprehet se:

*“ Kjo shembje e shtëpisë është bërë në vitin 1987 nga shteti komunist, por megjithëse dosja për trajtimin e kësaj çështjeje është hapur në Drejtorinë e ATP-së qysh më 1993, as unë dhe as trashëgimtarët e tjerë nuk im kemi marrë akoma lekët e dëmshpërblimit dhe se megjithë letrat që kam bërë, nga KLSH po vonohet përgjigja zyrtare.*

*Unë dhe vëllezërit dhe motrat e mia kemi kërkuar dëmshpërblimin financiar në vleftën 100% të masës së këtij dëmshpërblimi dhe jo 20 % në formën monetare kurse 80% në formën e kompensimit fizik. Për këtë çështje unë kam vënë në dijeni në muajin Maj të vitit 2021 se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka miratuar ligjin që i detyron të gjitha qeveritë e vendeve ish-komuniste të Evropës Lindore që t`i kompensojnë vetëm në formën financiare në masën 100% të gjithë shtetasit për pronat e tyre të shtetëzuara nga regjimet diktatoriale”.*

*Z. K. kërkon që pa vonesë të zbatohet ky ligj dhe të më jepët mua 100% financiarisht për 1/7 e pronës dhe të informohet sa më parë me shkresë zyrtare.*

#### **Përmbajtja e dosjes së ankimuesit**

Ankesa nuk përmban asnjë dokumentacion apo referencë bashkëlidhur.

#### **Dosja në ATP dhe analiza e fakteve**

Nga verifikimi në ATP Tiranë, rezulton se në emër të ankimuesit është hapur i dosja nr. 89, datë 20.07.2020, Drejtoria e Kompensimit të Veçantë me 20%.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar regjistrin e vendimeve të vitit 1995, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare Nr. 14 datë 08.05.2017, të cilat iu kanë njohur subjekteve të shpronësuar

të drejtën e kompensimit, si dhe vlerësimet financiare të këtyre vendimeve. Nga verifikimi në këtë regjistër rezulton se vendimi nr. 1310 datë 28.03.1995, i ish KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar C.A. dhe A.K., është publikuar me vlerë 25'314'282 lekë.

Në vijim, z. H.K., në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të subjektit të shpronësuar, ka paraqitur kërkesën e tij duke plotësuar "Formular Aplikimi, Kompensim Financiar me Kërkesë të Veçantë" e cila mban nr. 89 prot., datë 20.07.2020, pranë sektorit të Trajtimit me Kërkesë të Veçantë, duke kërkuar formën e kompensimit financiar për pjesën e tij takuese, me 20% të vlerësimit të vendimit nr. 1310 datë 28.03.1995, i ish KKKP-së Bashkia Tiranë, si dhe duke hequr dorë nga pjesa tjetër.

Ankimuesi z. H.K. ka depozituar Deklaratën Noteriale Nr. 1003 Rep., Nr. 331 Kol., datë 09.06.2020., me anë të së cilës, deklaroi se: "jam plotësisht dakort të aplikoj për kompensim financiar me kërkesë të veçantë për 20% njëzet përqind të vlerës së pronës për tu kompensuar sipas Ligjit 133/2015", në përputhje me pikën 2/a të nenit 17 të Ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" në të cilin përcaktohet se: "kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brënda 1 viti, atëhere ai përfiton 20 përqind të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere".

Me vendimin nr. 153., datë 27.11.2020, ka ekzekutuar kompensimin financiar me kërkesë të veçantë për 20% të vlerësimit financiar të vendimit nr. 1310 datë 28.03.1995, i ish KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar C.A. dhe A.K., në të cilin citohet se vlera financiare që do të përfitojë subjekti me aplikimin për kompensim financiar me kërkesë të veçantë Nr. 89 prot., datë 20.07.2020, do të jetë:

$40.875/378$  (pjesa takuese e cila i takon subjektit përfitues)  $\times$   $25'314'282$  (vlera totale që trajton vendimi) =  $2'737'357,88$  lekë.

Në këto kushte, me aplikimin për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, Nr. 89 prot., datë 20.07.2020 si dhe Me Urdhrin nr. 184, datë 27.11.2020, vlera totale që ka përfituar subjekti aplikues është:  $2'737'357,88$  lekë  $\times$   $20\% = 547'471,58$  lekë.

#### **Konkluzioni i grupit të auditimit të KLSH**

Në konkluzion të sa më sipër, duke u ndodhur në të tilla kushte, ATP e ka përfunduar procesin e kompensimit të vendimit nr. 1310 datë 28.03.1995, të ish KKKP-së Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar C.A dhe A.K., për pjesën takuese të z. H.K., sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 133/ 2015 si dhe në përputhje me nenet 207, 353, 354 dhe 355 të ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Përsa i takon vendimit të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg për kompensimin 100% vetëm në formën e kompensimit financiar, kjo është çështje që i takon Kuvendit të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIMET**

**1. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), në pasqyrat financiare për vitet 2020-2022, nuk ka paraqitur saktë llogaritë e amortizimit, duke mos paraqitur shumat e amortizimit të akumuluar 219, për Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre si dhe llogaria 681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit" nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, nga faqe 15-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), të marrë masa për të ardhmen, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në

llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria nr. 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), nuk ka plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë: Rubrika 1: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të ATP Tiranë.

Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr. e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare. Sa sipër bie në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, nga faqe 15-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave, (Sektori i Buxhetit, Financë dhe fondeve Speciale për kompensim), të marrë masa për të ardhmen lidhur me pasqyrat financiare (Pasqyra F5) duke plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat 1 dhe 2.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** ATK (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) ka kryer kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogaritë e klasës 6, shpenzime të shfrytëzimit, në një kohë që duhej marrë në fund të vitit 2020 në llogarinë e provizioneve, meqenëse vendimet kanë marrë formë të prerë, ku është angazhuar edhe përmbaruesi, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 34. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, nga faqe 15-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim) të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë kontabilizimin e vendimeve gjyqësore në llogarinë e provizioneve, në rastet kur vendimet kanë marrë formë të prerë edhe pse mund të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

### **Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim), në 7 raste, për urdhër-Shpenzimet nr. 169, 165, datë 21.10.2020, Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave Mirëmbajtja e Web GISS, Periudha Korrik-Gusht-shtator 2020; nr. 165, datë 14.10.2020, Shpenzime për mirëmbajtjen e Mjeteve të Transportit TR 8016 U; nr. 170, datë 28.10.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e Mjeteve të Transportit TR 3225 L, 254,028 lekë; likuiduar A. M.S. shpk; nr. 186, datë 17.11.2020, Shpenzime –Sigurim Roje 2020, likuiduar Shoqëria “I.G.” sha; nr. 187, datë 17.11.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e Kondicionerëve, likuiduar D.Xh.“P.K” shpk; nr. 212, datë 17.11.2020, Shpenzime mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës “Riparim fotokopje, likuiduar E.shpk, nuk ka bashkëlidhur kontratat (fotokopje ose pjesë të tyre) edhe në vazhdim në shpenzimet e kryera gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 (përveç shpenzimit të parë). Sa sipër është vepruar në mos zbatim të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenet 34,35,36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, nga faqe 15-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektori i Buxhetit, Financës dhe Fondeve Speciale për Kompensim), për 7 rastet e konstatuara, t’ju bashkëlidhë urdhër-shpenzimeve nr. 169, 165, datë 21.10.2020; nr. 165, datë 14.10.2020; nr. 170, datë 28.10.2020; nr. 186, datë 17.11.2020; nr. 187, datë 17.11.2020; nr. 212, datë 17.11.2020, dokumentet autorizuese dhe justifikuese, si kontratat (fotokopje ose pjesë të tyre), etj, si dhe në vazhdim në shpenzimet e kryera gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 (përveç shpenzimit të parë).



Në të ardhmen çdo urdhër shpenzimi të ketë të bashkëlidhur çdo dokument, fotokopje ose pjesë të kontratave, të cilat bëjnë të mundur justifikimin me lehtësi të veprimeve të kryera.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste nga Sektori i Kërkesave të Veçanta nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me “Kërkesë të Veçantë” edhe pse kërkesi legjitimohet në kërkesën e tij për kompensimin financiar të pronës, por ka kaluar për trajtim në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik, duke mos i kursyer buxhetit të shtetit *një vleftë prej 60,388,502 lekë*, nga fondi i kompensimit të subjekteve të shpronësuar duke hequr dorë nga pjesa tjetër e pronës, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 63-96, të Projekt Raportit të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, që të kenë prioritet shqyrtimi i kërkesave të subjektit të shpronësuar për kompensimin financiar me trajtim me “Kërkesë të Veçantë” në masën 20 për qind të vlerës së kompensimit dhe heqjen dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere prej 80 për qind.

### **Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste nga Sektori i Kompensimit është pranuar kërkesa për aplikim i subjektit kërkuar në cilësinë e blerësit të të drejtave që burojnë nga ish-vendimeve të KKKP, nga një person jo i rrethit trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.03.2016, *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”*, i ndryshuar, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 63-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, duke pranuar kërkesa për aplikim vetëm nga subjekti i shpronësuar, trashëgimtarët e tij ligjorë ose përfaqësuesi i tyre me prokurë, depoziton në ATP, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm.

### **Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 4 raste, sipas vendimeve nr. 142, datë 04.11.2020, nr. 144, datë 04.11.2020, nr. 178, datë 28.12.2020, nr. 143, datë 04.11.2020, nuk ka plotësuar dosjet e arkivuara me dokumentacionin përkatës lidhur me praktikatat që janë ndjekur për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit të publikuara në letinet sipas viteve, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Sektorët e Kompensimit), të marrë masa dhe të plotësoj dosjet e arkivuara sipas vendimeve nr. 142, datë 04.11.2020, nr. 144, datë 04.11.2020, nr. 178, datë 28.12.2020, nr. 143, datë 04.11.2020, me praktikatat për përcaktimin e zërit kadastral dhe caktimin vlerës së kompensimit të publikuara në letinet sipas viteve dhe në të ardhmen të përfshijë në dosjet e arkivuara edhe praktikatat për përcaktimin e zërit kadastral.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 13 raste, sipas vendimeve nr. 142, datë 04.11.2020; nr. 144, datë 04.11.2020; nr. 178, datë 28.12.2020; nr. 143, datë 04.11.2020; nr. 04, datë 29.01.2021; nr. 31, datë 24.02.2020; nr. 168, datë 18.12.2020; nr. 177, datë 18.12.2020; nr. 158, datë 18.12.2020; nr. 138, datë 02.11.2020; nr. 146, datë 27.11.2020; nr. 104, datë 30.06.2020; nr. 74, datë 24.04.2020, nuk ka kryer plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm për vlera që duheshin zbritur nga shuma e përlllogaritur për kompensim dhe/ose vërtetime negative për: vlerën e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfituar më parë.

Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, neni 6, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave të marrë masa për të ardhmen, dhe të plotësojë dosjet e kompensimit me dokumentacionin e nevojshëm, dokumentacion mbi bazën e të cilit, të vërtetohet ligjërisht, vlerat që duhen zbritur nga shuma e përlogaritur për kompensim dhe/ose vërtetime negative për vlerën e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfituar më parë.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtoria e Kompensimit), në 3 raste, sipas vendimeve nr. 144, datë 04.11.2020, nr. 178, datë 28.12.2020, nr. 143, datë 04.11.2020, vendimet përkatëse të vlerësuara të ish-KKKP-ve, E., V. dhe K. të cilat u gjetën në dosjet e arkivuara, nuk plotësonin kushtet për të qenë një akt administrativ, sepse nuk kanë vulën e institucionit, si dhe plan vendosjet ishin të pakonfirmuara nga KKK Pronave.

Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandim:** Në rast se vendimet administrative kanë të meta teknike/hartografike apo gabime materiale të dukshme, me kërkesë të subjektit, ATP-ja para se të bëjë vlerësimin financiar, mund të bëjë plotësimin e të metës apo ndreqjen e gabimit, pa prekur përmbajtjen e vendimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të R.SH.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtori i Përgjithshëm), në 1 rast, ka marrë vendimin nr. 74, datë 24.04.2020, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi relacioni shpjegues (mbi bazën e të cilit është marrë vendimi), nr. 131/5 prot., datë 24.04.2020 “Mbi shqyrtimin e aplikimit Nr.131 prot., datë 25.03.2019, për kompensimin me kërkesë të veçantë të pronës së njohur me vendimin nr. 137, datë 14.02.1996 të ish-KKKP Bashkia Fier dhe nr. 830, datë 30.07.2008 të ish-ZRKKP Fier, në emër të subjektit të shpronësuar H.G.”, nuk është konfirmuar nga ish-Përgjegjësi i Sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta dhe ish-Drejtori i Kompensimit të Pronës.

Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Projekt Raportit të Auditimit).

**10.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtori i Përgjithshëm) të marrë masa për të ardhmen dhe të nxjerrë vendime për kompensimin financiar/fizik, vetëm në kushtet kur relacionet sqaruese të nënshkruhen nga strukturat përkatëse dhe stafi i ATP-së dhe në radhë të drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve të kompensimit.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), kanë zgjatur procedurat ligjore për vendimmarrje për Subjektin e Shpronësuar H.M, herë me justifikime dhe vendimmarrje antiligjore për pezullim procedurash dhe herë pa shkak, ku preteksti ka qenë se për të njëjtin subjekt të shpronësuar kanë aplikuar 2 degë trashëgimtarësh, duke ju hapur 2 dosje dhe vonesa që kanë vazhduar edhe pas vendimmarrjes së formës së prerë të 2 shkallëve të gjykatës procedurë e përfunduar në nëntor 2014 me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 3687, datë 06.11.2014, dhe u nxor urdhri i ekzekutimit nr. 1656U/2014.

Sa më sipër qytetarit ankues z. H.M. (si dhe gjithë trashëgimtarëve) si rezultat i vonesave të gjata prej 8 viteve (2011-2019) nga ana e AKKP, ATP, Tiranë, i është shkëlur e drejta e tyre, duke qenë plotësisht i përligjur për të kërkuar vendimmarrje nga ana e institucionit AKKP, ATP

lidhur me pronën e tyre, detyrim i konfirmuar edhe nga vendimet 2 shkallëve të gjykatës, si rezultat i papërgjegjshmërisë dhe neglizhencës së stafit të institucionit në fjalë.

Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, nga faqe 110-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtori i Përgjithshëm), t'i kërkojë zyrtarisht subjektit të Shpronësuar H.M. (trashëgimtarëve), ri aplikim dhe ri paraqitje të dokumentacionit të nevojshëm për kthimin dhe kompensimin e pronave të tërhequr prej tij pas kalimit të afatit 3 vjeçar të funksionimit të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015.

Të shqyrtohet dosja për kthimin e pronës dhe të kalohet në vendimmarrje për subjektin e shpronësuar H.M., duke u lajmëruar zyrtarisht për vendimmarrjen.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Fondi i tokës i miratuar me VKM për kompensimin fizik, nuk rezulton të jetë e regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme në emër të ATP, mos regjistrimi i këtyre pasurive të miratuar si fond për ATP-në ka bërë që në disa raste të krijohet mbivendosje me pasuri të regjistruar për të tretë, duke e bërë të domosdoshme që ATP-ja të shprehet me një vendim të dytë për të kryer korrigjimin e vendimit në lidhje me pasuritë që kanë krijuar mbivendosje me pasuri të regjistruara për persona të tretë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandim:** ATP-ja të marr masa në lidhje me regjistrimin në kartelën e pasurive të paluajtshme të gjithë pasuritë e miratuara si fond fizik i tokës, që do të shërbejë për kompensimin fizik të ish-pronarëve, që disponojnë një vendim përfundimtar për njohje, me të drejtë për kompensimin e pronës dhe për të cilin ka një vlerësim financiar pozitiv të kryer nga ATP.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e ATK-së nuk janë të publikuara në Buletinin Zyrtar të ATP-së, rivlerësimi financiar me 10% të zërit kadastral aktual, ku rezulton që preken rreth 3843 vendime dhe që do të përfitojnë një vlerë financiare afërsisht 17 Mld lekë.

**13.1. Rekomandim:** ATK-ja të marr masa për të publikuar në Buletinin Zyrtar të ATP-së, rivlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual dhe ku rezultoi që preken rreth 3843 vendime ku do të përfitojnë një vlerë financiare rreth 17 Mld lekë.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Në ATP janë konstatuar pasaktësi në hedhjen e të dhënave në pasqyrat e paraqitura elektronikisht, kolonat janë të paplotësuara me të gjitha modalitetet e duhura, nuk janë dokumentuar dhe nuk janë rakorduar me dosjet fizikisht me regjistra dhe të hedhura në faqen elektronike të ATP-së, nuk janë rakorduar dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore, në kundërshtim me nenin 40 “Dhënia dhe marrja në dorëzim e dokumenteve (Mod. 15)” të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe Rregulloren e Brendshme nr.277, datë 10.10.2016 për “Organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës në Agjencinë e Trajtimit të Pronave” në mbështetje të këtij ligji. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, nga faqe 103-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandim:** ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në përshtatshmëri me ligjet për të gjitha dosjet e marra në dorëzim dhe të arkivuara dhe të rakordojë me të gjitha të dhënat të hedhura elektronikisht për informacion të saktë të çdo qytetari.

**Brenda muajit Qershor 2023**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e ATP Tiranë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 36, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë së ATP-së me

institucionet e tjera, veprimtaria e të cilëve ka lidhje me procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës.

Kështu, në të gjitha rastet (21 raste), në dosjet e audituara sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik në dosjet përkatëse të hapura për këtë qëllim, nuk ndodhet dokumentacion në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të ATP Tiranë me: ALUIZNI, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor (Bashkia, Qarku) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, nga faqe 60-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**15.1. Rekomandimi:** ATP Tiranë të marrë masa për të ardhmen të mos procedoj me vlerësimin dhe marrjen e vendimeve të kompensimit financiar dhe fizik, në kushtet kur në dosjen e kompensimit mungon dokumentacioni në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë së ATP-së me institucionet e tjera, veprimtaria e të cilëve ka lidhje me procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës.

#### Në vijimësi

**16. Gjetje nga auditimi:** ATP nuk ka kryer rakordimin e dosjeve që kanë kaluar për rishqyrtim vendimesh dhe të tërhequra nga arkiva në Drejtorinë e Asistencës Ligjore, nxjerrja e dosjeve nga arshiva dhe shqyrtimi i tyre, hyrjet dhe daljet nuk pasqyrojnë saktësinë e dosjeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor dhe për arkivat” të ndryshuar, si dhe në kundërshtim me (neni 3, 23, 37 dhe 40) dhe Ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe Rregullores për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore e jo shtetërore në mbështetje të këtij ligji.

**16.1. Rekomandimi:** ATP të marrë masa për ndjekjen e procedurat ligjore, të pasqyrojë dhe të regjistrojë të gjitha dosjet që ndodhen për shqyrtim nga specialistët.

#### Brenda muajit Qershor 2023

**17. Gjetje nga auditimi:** Në shqyrtimin e dosjeve për kompensim rezultojnë vonesa në kompensimin deri në 3 vjet në 6 raste rezulton se dosjet kanë filluar të shqyrtohen në vitin 2017 dhe janë kompensuar në vitin 2020 pra me vonesa të pa justifikuara dhe pa pasur dokument justifikues mbi shkaqet e vonesës si dhe selektimi dhe zgjedhja e subjektit për tu marrë në shqyrtim, dosja si psh: Dosja me aplikimin nr. 1222 datë 16.10.2017 e kompensuar në vitin 2020, Dosja me aplikimin nr. 696 datë 13.06.2017 e kompensuar në vitin 2020, Dosja me aplikimin nr. 996 datë 02.08.2018 e kompensuar në vitin 2020, Dosja me aplikimin nr. 200 datë 15.03.2017 e kompensuar në vitin 2020, Dosja me aplikimin nr. 987 datë 09.08.2017 e kompensuar në vitin 2020, Dosja me aplikimin nr. 1030 e kompensuar në vitin 2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6-7, nga faqe 63-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**17.1. Rekomandimi:** ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në kohë sipas kërkesave të ligjit, duke nxjerrë përgjegjësinë për situatën e krijuar.

#### Brenda muajit Qershor 2023

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve dhe ndjekja e procedurave ligjore dhe shqyrtimi i kërkesës, konstatohet se në 7 raste nuk ka as një shkresë për sipërfaqen që do kompensohen ish-pronarit të dërguar ASHK-së, për sipërfaqen që janë shtetërore dhe i disponueshëm për kompensim sipas nenit 36 (Bashkëpunime ndër institucional) të ligjit 133/2015 me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, nga faqe 63-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**18.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së të marrë masa me strukturat përkatëse për marrjen e informacionit për të saktësuar në mënyrë të qartë situatën e pronave të disponueshme për kalimin në fondin e kompensimit fizik për të gjitha rastet e dosjeve që shqyrtohen.

## Në vijimësi

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat sipas viteve të kompensimit për parcelat ndërtimore të ardhura nga ish/Aluizni dhe aktualisht ASHK për vitet 2020-2022 rezulton se janë shqyrtuar gjithsej 2579 dosje dhe janë pa shqyrtuar 1,004 dosje, në vitin 2020 kanë ardhur gjithsej 1479 dosje dhe nga këto janë shqyrtuar 997 dosje, pra 482 dosje pa u shqyrtuar, në vitin 2021 dhe 2022 kanë ardhur nga ASHK 2104 dosje dhe janë shqyrtuar 1582 dosje pra me një diferencë të dosjeve të pa shqyrtuara 522 dosje.

Në dosje nuk kanë dokumente justifikuese për vonesat e tyre në kundërshtim me (Piken 8) të VKM 383, datë 19.05.2010 ku shprehimisht thuhet “Grupi i punës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet.....”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, nga faqe 103-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorja Përgjegjëse të marrin masat përkatëse për ndjekjen e të gjithë subjekteve me të njëjtin standard dhe të lerë gjurme mbi ato dosje ku ka mungesë dokumentacioni të argumentuar ligjërisht.

## Në vijimësi

**20. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave figuron se në të gjitha rastet janë ndjekur të gjitha vendimet e Gjykatës së Apelit në afatet ligjore sipas ligjit dhe ndjekur të gjitha procedurat ligjore për 134 pronare të cilët ju janë marrë vendimet dhe janë pranuar nga Gjykata e Apelit, të sjellë si Gjykatë e Shkallës Parë, dokumentacioni dhe pretendimet e pronarëve për pronat e tyre dhe për të qenë sa me të saktë në veprimet e ATP dhe sipas ligjeve në fuqi, kanë bërë Rekurs në Gjykatën e Lartë sipas nenit 56, nenit 57 (Ligjit nr.49/2012), si dhe nenit 442,442/b,443,444 dhe 485 të (ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001 , neni 72,73,126) të Kodit Civil, por theksojmë se në dosjet e subjekteve të cilët janë në rekurs në Gjykatën e Lartë në dosjet e këtyre subjekteve nuk ka dokument nga zyra juridike për bllokimin e këtyre dosjeve deri në përfundimin e plotë të procedurave ligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 57-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1.Rekomandimi:** ATP të marrë masa duke nxjerrë urdhra dhe përgjegjësinë për të informuar dhe lenë gjurmë për ato dosje që janë në procese gjyqësorë të bllokohen deri në përfundim të procesit.

## Në vijimësi

**21. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nga Autoriteti Kontraktor nuk ka procesverbale që të vërtetojnë të gjitha problematikat e aktiveve që janë përcaktuar në preventiv, përveç rasteve të pjesëve që kanë konsum periodik, gjithashtu rezulton që një pjesë e zërave të preventivit që nuk janë pjesë konsumi janë përfshirë dhe në zërat e preventivit të prokurimit të vitit 2020. Gjithashtu duhej pasur në konsideratë dhe përzgjedhja e subjektit fitues që të jetë sa më afër autoritetit kontraktor për të shmangur kostot e tepërta të transportit, kjo gjë duhet të ishte marrë në konsideratë nga autoriteti kontraktor përpara se të vendosej për subjektin fitues.

**21.1. Rekomandimi:** ATP-ja referuar konstatimeve të grupit të auditit, të mbajë aktet përkatëse dhe të kërkojë dëmshpërblim dëmi në rast të mos realizimit të punës nga ana e palës nënkontraktore sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

## Në vijimësi

**22. Gjetje nga auditimi:** ATP ka trajtuar kërkesën e z. A. O. duke hapur dosjen nr. 3995-A, datë 12.05.2022 trajtim i cili është në proces, duke tejkaluar afatet ligjore dhe pa e kaluar për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm i AKP, me vonesa në dhënien e kompensimit financiar sipas Vendimit të KM nr. 543, datë 29.09.2021 “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara”.

Zgjatja e afateve ligjore ka ardhur si pasoje e mosparaqitjes zyrtare dhe më të dhëna të sakta të Kartelës së Pasurisë, nga DV ASHK Sarandë, megjithëse janë bërë 4 kërkesa dhe për këto kërkesa DV ASHK Sarandë është përgjigjur se kartela e pasurisë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, në emër të A. dhe I.O., është dërguar me shkresë nr.10274, datë 26.10.2022, për të cilën ATP pretendon se nuk ka patur kartelën bashkëlidhur, megjithëse në shkresë cilësohet se bashkëlidhur ndodhet kartela.

Më në fund DV ASHK Sarandë me shkresën nr. 1814/1 datë 10.03.2023 administruar pranë ATP me nr. 3995-A/9 prot., datë 15.03.2023, konfirmon se pasuria nr. 9/27, ZK. 8642, Sarandë figuron në emër të A. dhe I.O duke bashkëlidhur me kartelën. Kjo përgjigje nga ASHK ka ardhur pas auditimit të dosjes nga KLSH, pra 35 ditë me vonesë nga kërkesa e fundit për rikonfirmim. Pra më datë 15.03.2023, shqyrtimi nga Grupi i Punës, konsiderohet i mbyllur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 110-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1. Rekomandim:** Agjencia e Trajtimit të Pronave (Drejtori i Përgjithshëm), të kryejë kompensimin financiar të pronarin A. dhe I.O., për pasurinë nr. 9/27, Zona Kadastrale nr. 8642, Sarandë, mbi të cilën është dhënë leje legalizimi, duke njoftuar zyrtarisht pronarin për vendimmarrjen dhe veprimin financiar.

**Menjëherë**

## **MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste ka dalë urdhër-shpenzime, për shumën *1,495,663 lekë*, për të njëjtin specialist të larguar, si rezultat i dhënies së masës ekstreme disiplinore, zgjidhje e kundërligjshme e kontratave së punonjësit të pabazuar në ligj dhe në Kodin e Punës, ka sjellë kundërpërgjigje nga punonjësi i institucionit i cili ka bërë padi në gjykatë, kundër masës të dhënë nga ish-AKKP, ku ka fituar të drejtën e tij në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë të gjykimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar *1,495,663 lekë*, ku përfshihet edhe pagesa e tarifës të përmbaruesit gjyqësor, për kompensimin e punonjësit të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar një efekt ekonomik negativ në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune.

Sa sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin për Shërbimin Civil në RSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, nga faqja 8 deri në faqen 17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Drejtori i ATKP nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa në të ardhmen për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për likuidimin e vendimeve gjyqësore, duke u udhëhequr nga qëllimi për krijimin e një marrëdhënie punëmarrës-punëdhënës të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

**Në vijimësi**

---